



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
USTAVNI SUD
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 16 janar 2023
Nr.ref.: AGJ 2113/23

AKTGJYKIM

në

rastin nr. KO190/19

Parashtrues

Gjykata Supreme e Republikës së Kosovës

Vlerësim i kushtetutshmërisë së nenit 8, paragrafit 2, të Ligjit nr. 04/L-131 për Skemat Pensionale të Financuara nga Shteti lidhur me nenin 5 dhe 6 të Udhëzimit Administrativ (MPMS) nr. 09/2015 për Kategorizimin e Shfrytëzuesve të Pensionit Kontributpagues sipas Strukturës Kualifikuese dhe Kohëzgjatjes së Pagesës së Kontributeve

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Gresa Caka-Nimani, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është parashtruar nga Kolegjiumi i Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Gjykata referuese) e nënshkruar nga kryetari i saj, Enver Peci.

Ligji i kontestuar

2. Gjykata referuese ngre dyshime për kushtetutshmërinë e paragrafit 2 të nenit 8 (Kushtet dhe kriteret për njohjen e të drejtës në pension kontributpagues të moshës) të Ligjit nr.04/L-131 për Skemat Pensionale të Financuara nga Shteti lidhur me nenet 5 (Kualifikimi i shfrytëzuesve të pensionit kontributpagues) dhe 6 (Dokumentet e nevojshme për njohjen e të drejtës në pension kontributpagues) të Udhëzimit Administrativ nr.09/2015 për Kategorizimin e Shfrytëzuesve të Pensionit Kontributpagues sipas Strukturës Kualifikuese dhe Kohëzgjatjes së Pagesës së Kontributeve-Stazhit Pensional (në tekstin e mëtejme: Ligji i kontestuar).
3. Ligji i kontestuar është miratuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës më 6 maj 2014 dhe ka hyrë në fuqi më 20 qershor 2014, ndërsa, Udhëzimi Administrativ i kontestuar është miratuar nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale (në tekstin e mëtejme: MPMS) më 31 dhjetor 2015 dhe ka hyrë në fuqi më 7 janar 2016.

Objekti i çështjes

4. Objekt i çështjes së kërkesës është vlerësimi i kushtetutshmërisë së paragrafit 2 të nenit 8 të Ligjit të kontestuar lidhur me nenet 5 dhe 6 të Udhëzimit Administrativ të kontestuar, të cilat pretendohet se janë në kundërshtim me nenet 24 [Barazia para Ligjit] dhe 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta) në lidhje me nenin 14 (Ndalimi i diskriminimit) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: KEDNJ) dhe nenin 1 (Mbrojtja e Pronës) të Protokollin nr.1 të KEDNJ-së.

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në paragrafin 8 të nenit 113 [Jurisdiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në nenet 51 (Saktësimi i kërkesës), 52 (Procedura para Gjykatës) dhe 53 (Vendimi) të Ligjit nr.03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Ligji), si dhe në rregullin 77 [Kërkesa në pajtim me nenin 113.8 të Kushtetutës dhe me nenet 51, 52 dhe 53 të Ligjit] të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës Nr. 01/2018 (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

6. Më 22 tetor 2019, Gjykata referuese e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
7. Më 29 tetor 2019, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Nexhmi Rexhepi gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Arta Rama-Hajrizi (kryesuese), Gresa Caka-Nimani dhe Safet Hoxha (anëtarë).
8. Më 6 nëntor 2019, Gjykata njoftoi për regjistrimin e kërkesës Gjykatën referuese, Presidentin e Republikës së Kosovës, Kryeministrin në detyrë të Republikës së Kosovës, Avokatin e Popullit dhe Sekretarin e Përgjithshëm të Kuvendit të Republikës së Kosovës.
9. Të njëjtën ditë, Gjykata njoftoi edhe avokatin e palës së interesuar M.A., të cilit i ofroi mundësinë e paraqitjes së komenteve brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita e pranimit të kësaj shkrese.
10. Më 10 qershor 2020, Gjykata referuese dorëzoi për njoftim në Gjykatë, edhe Aktvendimin [ARJ-UZVP.nr.10/2020] e 14 janarit 2020, përmes të cilit e kishte ndërprerë procedurën e ngjashme të parashtruar nga pala e interesuar Sh.G., kundër MPMS-së.

11. Më 16 qershor 2020, Gjykata referuese dorëzoi për njoftim në Gjykatë, edhe Aktvendimin [ARJ-UZVP.nr.41/2020] e 11 qershorit 2020, përmes të cilit e kishte ndërprerë procedurën e ngjashme të parashtruar nga pala e interesuar K.B., kundër MPMS-së.
12. Më 15 janar 2021, Gjykata njoftoi MPMS-në për regjistrimin e kërkesës KO190/19 dhe nga e njëjta kërkoi, ndër të tjera, që të ofrojë komentet e saj lidhur me pyetjet si në vijim:
 - (1) *Cili është qëllimi i kufizimit të së drejtës së fitimit të pensionit kontributpagues të moshës, vetëm nëse konfirmohet përvoja e punës dhe dhënia e kontributeve për 15 vite deri në 1 janar 1999?*
 - (2) *A ka Republika e Kosovës qasje në kontributet e mbledhura në ish fondin pensional? Nëse jo, mbi çfarë baze është bërë dallimi në trajtim i kategorisë I (personave që kanë 15 vite kontribute para vitit 1999) dhe kategorisë II (personave që nuk i kanë 15 vite para 99-tës, mirëpo në total të përvojës së tyre kanë 15 e më shumë vite përvojë pune, p.sh. 33 vite) në aspektin e ndarjes së periudhës kohore para 1 janarit 1999 dhe pas kësaj date?*
 - (3) *Cilat janë të drejtat e atyre personave që ofrojnë dëshmi për kontribut nën 15 vite përvojë pune para 1 janarit 1999 dhe si mund të realizojnë këtë të drejtë në rrethanat aktuale?*
 - (4) *A konsideroni që punëtorët e të gjithë sektorëve tjerë janë në pozitë më të pafavorshme se punëtorët e arsimit, shëndetësisë dhe të tjerëve që kanë punuar në sistemin e RKS-së (të cilëve iu njihet stazhi për periudhën 1989-1999, sipas nenit 8.6 i Ligjit) e të cilëve u njihet e drejta e pensionit kontributpagues përmes dispozitave të Ligjit?; dhe*
 - (5) *A kanë Institucionet e Kosovës qasje në regjistrin e marrëdhënies së punës të punëtorëve në periudhën 1990-1999? Si është e rregulluar çështja e barrës së provës për ofrimin e dëshmive të tilla me rastin e aplikimit për pension kontributpagues të moshës?*
13. Më 27 janar 2021, MPMS-ja i dorëzoi komentet e saj ku janë dhënë shpjegime për: (i) historikun e sistemit pensional dhe invalidor të Republikës së Kosovës; (ii) përshkrimin e shkurtër të etapave të zhvillimit të sistemit pensional dhe invalidor në Republikën e Kosovës; dhe (iii) sistemin pensional dhe invalidor të reformuar në Republikën e Kosovës duke filluar nga viti 2002 e tutje. Të dhënat relevante të opinionit/përgjigjeve të MPMS-së reflektohen në pjesën arsyetuese të këtij Aktgjykimi.
14. Më 29 janar 2021, Gjykata referuese dorëzoi për njoftim në Gjykatë, edhe Aktvendimin [ARJ-UZVP.nr.45/2020] e 27 korrikut 2020, përmes të cilit e kishte ndërprerë procedurën e ngjashme të parashtruar nga pala e interesuar H.M., kundër MPMS-së.
15. Më 2 mars 2021, Gjykata referuese dorëzoi për njoftim në Gjykatë edhe Aktvendimin [ARJ-UZVP. nr. 51/2020] të 27 gushtit 2020, përmes të cilit e kishte ndërprerë procedurën e ngjashme të parashtruar nga pala e interesuar F.T., kundër MPMS-së.
16. Më 17 maj 2021, bazuar në paragrafin 5 të nenit 114 [Përbërja dhe Mandati i Gjykatës Kushtetuese] të Kushtetutës dhe Rregullit 12 (Zgjedhja e Kryetarit dhe e Zëvendëskryetarit) të Rregullores së punës, gjyqtarja Gresa Caka-Nimani u zgjodh Kryetare e Gjykatës Kushtetuese. Bazuar në paragrafin (4) të Rregullit 12 të Rregullores së punës dhe Vendimit të Gjykatës KK-SP 71-2/21, u përcaktua që gjyqtarja Gresa Caka-Nimani, detyrën e Kryetares së Gjykatës e merr pas përfundimit të mandatit të Kryetares aktuale të Gjykatës Arta Rama-Hajrizi, më 26 qershor 2021.

17. Më 25 maj 2021, bazuar në pikën 1.1 të paragrafit 1 të nenit 9 (Përfundimi i mandatit para kohës) të Ligjit dhe Rregullit 7 (Dorëheqja e gjyqtarëve) të Rregullores së Punës, Gjyqtari Bekim Sejdiu paraqiti dorëheqjen e tij nga pozita e gjyqtarit pranë Gjykatës Kushtetuese.
18. Më 31 maj 2021, Kryetarja e Gjykatës Arta Rama-Hajrizi, përmes Vendimit Nr.KK-160/21, përcaktoi që gjyqtarja Gresa Caka-Nimani të caktohet kryesuese në Kolegje shqyrtuese në rastet ku është caktuar si anëtare e Kolegjit, duke përfshirë rastin aktual.
19. Më 26 qershor 2021, bazuar në paragrafin (4) të Rregullit 12 të Rregullores së punës dhe Vendimit të Gjykatës KK-SP 71-2/21, gjyqtarja Gresa Caka-Nimani mori detyrën e Kryetares së Gjykatës, ndërsa bazuar në pikën 1.1 të paragrafit 1 të nenit 8 (Përfundimi i mandatit) të Ligjit, Kryetarja Arta Rama-Hajrizi përfundoi mandatin e Kryetares dhe të gjyqtarës së Gjykatës Kushtetuese.
20. Më 28 qershor 2021, bazuar në paragrafin (2) të rregullit 11 (Caktimi i kolegjeve shqyrtuese) të Rregullores së punës, Kryetarja e Gjykatës, Gresa Caka-Nimani, përmes Vendimit Nr.KSH-KO190/19, përcaktoi që gjyqtarja Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, të caktohet anëtare e Kolegjit shqyrtues në këtë rast.
21. Më 22 korrik 2021, Gjykata shqyrtoi rastin dhe vendosi që vendimmarrjen ta shtyjë për një seancë tjetër në përputhje me rekomandimet dhe plotësimet e kërkuara.
22. Më 16 qershor 2022, Gjykata kërkoi nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, informata shtesë lidhur me çështjet vijuese: (i) a është ndërmarrë ndonjë iniciativë për përpilimin e Udhëzimit të ri Administrativ lidhur me kategorizimin e shfrytëzuesve të pensionit kontributpagues sipas strukturës kualifikuese dhe kohëzgjatjes së pagesës së kontributeve-stazhit pensional?; dhe (ii) nëse po, cilat janë ndryshimet e përcaktuara në këtë Udhëzim, dhe nëse ka ndonjë afat kohor se kur parashihet miratimi i të njëjtit.
23. Më 29 qershor 2022, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve dorëzoi komentet e saj, ndër të tjera, duke dhënë sqarimet se: *"[...] Plan Programi i Qeverisë së Republikës së Kosovës 2021-2025 ka paraparë një rishikim të kornizës ligjore për skemat sociale dhe pensionale dhe Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-131 për Skemat Pensionale të Financuara (ligji bazik) është në Programin Legjislativ të vitit 2022. Ky projektligj parashihet të procedohet për aprovim në Qeverinë e Republikës së Kosovës deri më 25.11.2022"*.
24. Më 4 korrik 2022, Gjykata dorëzoi në Forumin e Komisionit të Venedikut, pyetje të caktuara lidhur me efektin e vendimeve të Gjykatës në rastet kur një ligj shpallet jokushtetues. Gjykata në Forumin e lartcekur parashit pyetjet vijuese:
 1. Kur për një ligj të kontestuar konstatohet se është jokushtetues, cili është afati kohor që Gjykata Kushtetuese i jep ligjvënësit kombëtar për ta sjellë ligjin përkatës në përputhje me Kushtetutën? Cili është efekti i ligjit të shpallur jokushtetues, gjatë kësaj periudhe, derisa ligjvënësi kombëtar të sjellë një ligj të ri në përputhje me Kushtetutën?;
 2. Duke marrë parasysh që kjo është një procedurë kontrolli incidental, dhe duke supozuar kështu që ligji rezulton jokushtetues, ligji i kontestuar nuk mund të zbatohet në rastet në fjalë (përkatësisht rregulli i rastit në fjalë) a do të përfitonin edhe të gjitha rastet në pritje/të pazgjidhura në gjykatat e rregullta nga ligji i ri, përkatësisht ligji i miratuar nga Kuvendi në bazë të vendimit të Gjykatës Kushtetuese?;
 3. Më konkretisht, a e pezullojnë gjykatat e rregullta vendimmarrjen në të gjitha rastet aktive që në të kundërtën do të kërkonin zbatimin e ligjit jokushtetues, derisa

ligjvënësi kombëtar, brenda afatit të parashikuar, ta ndryshojë dispozitën ligjore jokushtetuese në përputhje me Kushtetutën dhe konkluzionet e Gjykatës Kushtetuese?;

4. *Po në lidhje me rastet që tashmë janë vendosur nga gjykatat e rregullta sipas dispozitës ligjore që u konstatua jokushtetuese nga Gjykata Kushtetuese? A mund të jenë të hapura për një shqyrtim të ri gjyqësor apo mbizotëron parimi i sigurisë juridike?; dhe*
5. *Cila është praktika në vendin tuaj në lidhje me pyetjet e lartpërmendura dhe a keni ndonjë praktikë gjyqësore në lidhje me këtë?.*
25. Më 14 korrik 2022, sindikata e nëpunësve shtetëror të Kosovës të viteve të 90-ta dhe sindikata e ish policëve të Kosovës të viteve të 90-ta, përmes parashtresës përkatëse kërkuan përshpejtimin e marrjes së vendimit në këtë rast.
26. Më 16 dhjetor 2022, gjyqtari Enver Peci dha betimin para Presidentes së Republikës së Kosovës, me ç'rast filloi mandati i tij në Gjykatë.
27. Më 20 dhjetor 2022, gjyqtari Enver Peci, në bazë të nenit 18 (Përfundimi i gjyqarit) të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese, kërkoj përfundimin e tij nga vendimmarrja në rastin KO190/19.
28. Më 20 dhjetor 2022, Kryetarja e Gjykatës, përmes Vendimit [Nr. KK 227/22], miratoi kërkesën për përfundim nga vendimmarrja në rastin KO190/19, të parashtruar nga gjyqtari Enver Peci.
29. Më 30 dhjetor 2022, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës pranueshmërinë e kërkesës.
30. Në të njëjtën ditë, Gjykata votoi njëzëri që: (i) kërkesa është e pranueshme; (ii) paragrafi 2 i nenit 8 të Ligjit nr.04/L-131 për Skemat Pensionale të Financuara nga Shteti në lidhje me nënparagrafin 2.3 të paragrafit 2 të nenit 6 të Udhëzimit Administrativ nr.09/2015 për Kategorizimin e Shfrytëzuesve të Pensionit Kontributpagues sipas Strukturës Kualifikuese dhe Kohëzgjatjes së Pagesës së Kontributeve-Stazhit Pensional, nuk janë në përputhshmëri me nenin 24 [Barazia para Ligjit] të Kushtetutës në lidhje me nenin 14 (Mbrotja nga Diskriminimi) të KEDNJ-së dhe nenin 1 (Ndalimi i përgjithshëm i diskriminimit) të Protokollit nr. 12 të KEDNJ-së.

Përmbledhja e fakteve

31. Parashtruesi i kërkesës, përkatësisht Gjykata referuese, në kërkesën e saj për kontroll incidental të kushtetutshmërisë së paragrafit 2 të nenit 8 të Ligjit të kontestuar në lidhje me nenet 5 dhe 6 të Udhëzimit Administrativ të kontestuar me nenet 24 dhe 46 të Kushtetutës, para Gjykatës paraqiti pesë (5) raste të ndryshme dhe përmes të cilave kishte ngritur dyshimet për jokushtetutshmërinë e normave të kontestuara.
32. Në vijim, Gjykata do të paraqet: (I) esencën e rasteve të parashtruara para Gjykatës përmes mekanizmit të kontrollit incidental, duke theksuar se para Gjykatës për vlerësim të kushtetutshmërisë nuk janë faktet dhe rrethanat e rasteve konkrete, por vetëm vlerësimi i kushtetutshmërisë së dispozitave të kontestuara të Ligjit dhe të Udhëzimit Administrativ përkatës dhe të cilat Gjykata referuese pretendon, përkatësisht nge dyshime se janë në kundërshtim me dispozitat përkatëse kushtetuese; dhe (II) raportin me Rekomandime *ex officio* nr. 235/2018 të Avokatit të Popullit në lidhje me kategorinë e qytetarëve që kanë punuar para vitit 1999 dhe nuk përfitojnë nga pensioni kontributpagues të moshës për shkak se nuk e plotësojnë kriterin e stazhit pensional prej 15 viteve si pasojë e largimit diskriminues nga puna; dhe (III) përmbledhjen e shkurtër e historikut të sistemit

pensional dhe invalidor në Kosovë bazuar në Informatat e dhëna nga MPMS-ja më 29 janar 2021.

I. Përmbledhja e rasteve të referuara nga Gjykata Supreme përmes të cilave pretendohet jokushtetutshmëria e dispozitave përkatëse të Ligjit të kontestuar

(i) Faktet lidhur me palën e interesuar M.A., lidhur me Aktvendimin [UZVP – ARJ nr. 99/2019] e 22 gushtit 2019 të Gjykatës Supreme

33. Nga shkresat e lëndës rezulton që pala e interesuar M.A., e cila ishte gjyqtare në sistemin gjyqësor të Kosovës, arriti moshën e pensionimit më 3 nëntor 2014. E njëjta aplikoi për pension kontributdhënës në Zyrën Rajonale të Pensioneve në Prishtinë, mirëpo asaj iu aprovua vetëm dhënia e pensionit bazik të moshës në shumën prej 75 eurove. M.A., parashtroi ankesë ndaj vendimit të Zyrës së Pensioneve me propozimin që t'i njihet e drejta në pension kontributpagues në shumën prej 150 euro, kërkesë kjo e cila u refuzua nga Departamenti i Administratës Pensionale (në tekstin në vijim: DAP) në kuadër të MPMS-së. Në vijim në procedurën e konfliktit administrativ, fillimisht Gjykata Themelore aprovoi si të bazuar kërkesëpadinë e M.A.-së, si dhe anuloi njoftimin DAP të MPMS-së, dhe çështjen e ktheu tek e njëjta në rivendosje. Në vijim, pala e interesuar iu drejtua MPMS-së me kërkesë që të nxirrte vendimin e ri në përputhje me Aktgjykimin e Gjykatës Themelore, dhe përderisa e njëjta nuk ktheu përgjigje, M.A., përmes padisë kërkoi nga Gjykata Themelore që të vendoste për aprovimin e kërkesëpadisë së saj për njohjen e të drejtës në pension kontributdhënës, përkatësisht t'ia njohë gjithsej 18 vite e 2 muaj e 19 ditë të stazhit të sigurimit pensional, të pensionit kontributpagues dhe të njëjtës t'i bëhet pagesa e të gjitha ndryshimeve të këtij pensioni me përgatitje superiore, në mënyrë retroaktive nga 30 marsi 2015 e tutje. Gjykata Themelore e refuzoi kërkesëpadinë e palës së interesuar M.A., vendim ky që u pasua edhe me Vendimin e Gjykatës së Apelit që vërtetonte të njëjtin. Në vijim, M.A. parashtroi kërkesë për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit dhe Aktgjykimit të Gjykatës Themelore.

34. Më 22 gusht 2019, Gjykata Supreme përmes Aktvendimit [UZVP – ARJ nr. 99/2019] vendosi të ndërpritet procedura sipas padisë së palës së interesuar M.A. kundër të paditurës MPMS. Procedura sipas kësaj çështjeje juridike vazhdoi në Gjykatën Kushtetuese të Kosovës sipas kërkesës së Gjykatës Supreme për vlerësimin e kushtetutshmërisë së paragrafit 2 të nenit 8 Ligjit për Skemat Pensionale të Financuara nga Shteti në lidhje me nenet 5 dhe 6 të Udhëzimit Administrativ nr. 09/2015 për Kategorizimin e Shfrytëzuesve të Pensionit Kontributpagues.

35. Më 22 tetor 2019, Gjykata referuese në pajtim me paragrafin 8 të nenit 113 të Kushtetutës dorëzoi në Gjykatë kërkesën për vlerësimin e përputhshmërisë së paragrafit 2 të nenit 8 të Ligjit të kontestuar në lidhje lidhur me nenin 5 dhe 6 të Udhëzimit Administrativ të kontestuar për të cilat pretendohet se janë në kundërshtim me nenin 24 [Barazia para Ligjit] dhe 46 [Mbrotjtja e Pronës] të Kushtetutës në ndërlidhje me nenin 1 (Mbrotjtja e Pronës) të Protokollin Nr.1 të KEDNJ-së.

(ii) Faktet lidhur me palën e interesuar Sh.G. në lidhje me Aktvendimin [ARJ-UZVP.nr.10/2020] e 14 janarit 2020 të Gjykatës Supreme

36. Nga shkresat e lëndës rezulton që pala e interesuar Sh.G., kishte aplikuar për njohjen e të drejtës në pension kontributpagues në Zyrën e Pensioneve në Komunën e Pejës, e cila e kishte refuzuar këtë kërkesë pasi që nuk ishin paraqitur dëshmi të mjaftueshme në kuptim të Ligjit dhe Udhëzimit Administrativ të kontestuar për pesëmbëdhjetë (15) vite stazh kontributiv. I njëjti, paraqiti ankesë me arsyetimin se për shkak të vendosjes së masave të dhunshme nga regjimi serb në vitet e 90-ta, atij i ishte ndërprerë marrëdhënia e punës dhe nuk kishte të mundur që të udhëtonte nga Peja për në Prishtinë në vendin e tij të punës,

ankesë kjo e cila u refuzua nga Komisioni për ankesa në kuadër të MPMS-së. Në vijim, në procedurën e konfliktit administrativ, Gjykata Themelore dhe e Apelit refuzuan si të pabazuar kërkesëpadinë e tij. Sh.G., parashtroi kërkesë për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit dhe Aktgjykimit të Gjykatës Themelore.

37. Më 1o qershor 2020, Gjykata Supreme përmes Aktvendimit [ARJ-UZVP.nr.10/2020]: (i) ndërpreu procedurën sipas padisë së paditësit Sh.G., e parashtroi kundër të paditurës MPMS-së; dhe sqaroi që (ii) procedura do të vazhdojë pas nxjerrjes së vendimit të Gjykatës Kushtetuese, sipas kërkesës së Gjykatës Supreme lidhur me vlerësimin e kushtetushmërisë së paragrafit 2 të nenit 8 të Ligjit për Skemat Pensionale të Financuara nga Shteti në lidhje me nenet 5 dhe 6 të Udhëzimit Administrativ nr.09/2015 për Kategorizimin e Shfrytëzuesve të Pensionit Kontributpagues.

(iii) Faktet lidhur me palën e interesuar K.B. në lidhje me Aktvendimin [ARJ-UZVP.nr.41/2020] e 11 qershorit 2020 të Gjykatës Supreme

38. Plotësimi i tretë i Gjykatës referuese u bë më 16 qershor 2020, kur Gjykata referuese dorëzoi në Gjykatë Aktvendimin [ARJ-UZVP.nr.41/2020] e 11 qershorit 2020, përmes së cilit: (i) ndërpreu procedurën sipas padisë së paditësit K.B., e parashtroi kundër të paditurës MPMS; dhe sqaroi që (ii) procedura do të vazhdojë pas nxjerrjes së vendimit të Gjykatës Kushtetuese, sipas kërkesës së Gjykatës Supreme lidhur me vlerësimin e kushtetushmërisë së paragrafit 2 të nenit 8 të Ligjit për Skemat Pensionale të Financuara nga Shteti në lidhje me nenet 5 dhe 6 të Udhëzimit Administrativ nr.09/2015 për Kategorizimin e Shfrytëzuesve të Pensionit Kontributpagues.

39. Nga shkresat e lëndës rezulton që pala e interesuar K.B., nën pretendimin e tij se i përmbush kriteret e Ligjit dhe Udhëzimit Administrativ të kontestuar, për t'u kualifikuar si përfitues i pensionit kontributpagues, si dhe nën pretendimin se ka diplomuar në vitin 2005, ka kundërshtuar vendimin e 11 korrikut 2017 të MPMS-së lidhur me refuzimin e kërkesës së tij për t'u kualifikuar si përfitues i pensionit kontributpagues. Në vijim dhe përgjatë procedurës së konfliktit administrativ, Gjykata Themelore dhe e Apelit refuzuan si të pabazuar kërkesëpadinë e K.B.-së. Ky i fundit, parashtroi kërkesë për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit dhe Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjykatën Supreme. Kjo e fundit, më 11 qershor 2020, përmes Aktvendimit [ARJ-UZVP.nr.41/2020], e ndërpreu procedurën sipas padisë së K.B.-së, deri në nxjerrjen e Vendimit nga Gjykata Kushtetuese sipas kërkesës së Gjykatës Supreme lidhur me vlerësimin e kushtetushmërisë së paragrafit 2 të nenit 8 të Ligjit për Skemat Pensionale të Financuara nga Shteti, si dhe neneve 5 dhe 6 të Udhëzimit Administrativ nr.09/2015 për Kategorizimin e Shfrytëzuesve të Pensionit Kontributpagues.

(iv) Faktet lidhur me palën e interesuar H.M., në lidhje me Aktvendimin [ARJ-UZVP.nr. 45/2020] të 27 korrikut 2020 të Gjykatës Supreme;

40. Plotësimi i katërt i Gjykatës referuese u bë më 29 janar 2021, kur Gjykata referuese dorëzoi në Gjykatë Aktvendimin [ARJ-UZVP.nr.45/2020] e 27 korrikut 2020 të Gjykatës Supreme, përmes së cilit: (i) ndërpreu procedurën sipas padisë së paditësit H.M.-së, të parashtroi kundër të paditurës MPMS; dhe sqaroi që (ii) procedura do të vazhdojë pas nxjerrjes së vendimit të Gjykatës Kushtetuese, sipas kërkesës së Gjykatës Supreme lidhur me vlerësimin e kushtetutshmërisë së paragrafit 2 të nenit 8 të Ligjit për Skemat Pensionale të Financuara nga Shteti në lidhje me nenet 5 dhe 6 të Udhëzimit Administrativ nr.09/2015 për Kategorizimin e Shfrytëzuesve të Pensionit Kontributpagues.

41. Nga shkresat e lëndës rezulton që pala e interesuar H.M., kishte aplikuar për njohjen e të drejtës në pension kontributpagues në Zyrën e Pensioneve, e cila e kishte refuzuar këtë

kërkesë. Në vijim dhe përgjatë procedurës së konfliktit administrativ, Gjykata Themelore dhe e Apelit refuzuan si të pabazuar kërkesëpadinë e H.M.-së. Ky i fundit, në vijim, parashtroi kërkesë për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit dhe Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjykatën Supreme. Kjo e fundit, më 27 korrikut 2020, përmes Aktvendimit përkatës e ndërpreu procedurën sipas padisë së H.M.-së, deri në nxjerrjen e Vendimit nga Gjykata Kushtetuese sipas kërkesës së Gjykatës Supreme lidhur me vlerësimin e kushtetutshmërisë së paragrafit 2 të nenit 8 të Ligjit për Skemat Pensionale të Financuara nga Shteti në lidhje me nenet 5 dhe 6 të Udhëzimit Administrativ nr.09/2015 për Kategorizimin e Shfrytëzuesve të Pensionit Kontributpagues.

(v) *faktet lidhur me palën e interesuar F.T., në lidhje me Aktvendimin [ARJ-UZVP. nr. 51/2020] të 27 gushtit 2020, të Gjykatës Supreme.*

42. Përfundimisht, plotësimi i pestë i Gjykatës referuese u bë më 2 mars 2021, kur Gjykata referuese dorëzoi në Gjykatë Aktvendimin [ARJ-UZVP.nr.51/2020] e 27 gushtit 2020 të Gjykatës Supreme, përmes të cilit: (i) ndërpreu procedurën sipas padisë së paditësit F.T.-së, e parashtroi kundër të paditurës MPMS; dhe sqaroi që (ii) procedura do të vazhdojë pas nxjerrjes së vendimit të Gjykatës Kushtetuese, sipas kërkesës së Gjykatës Supreme lidhur me vlerësimin e kushtetutshmërisë së paragrafit 2 të nenit 8 të Ligjit për Skemat Pensionale të Financuara nga Shteti në lidhje me nenet 5 dhe 6 të Udhëzimit Administrativ nr.09/2015 për Kategorizimin e Shfrytëzuesve të Pensionit Kontributpagues.

43. Nga shkresat e lëndës rezulton që pala e interesuar F.T., kishte aplikuar për njohjen e të drejtës në pension kontributpagues në Zyrën e Pensioneve dhe e cila përmes vendimeve të 6 gushtit 2016 dhe 12 janarit 2017, respektivisht e kishte refuzuar këtë kërkesë. Në vijim dhe përgjatë procedurës së konfliktit administrativ, Gjykata Themelore dhe e Apelit refuzuan si të pabazuar kërkesëpadinë e F.T.-së. Ky i fundit, parashtroi kërkesë për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit dhe Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjykatën Supreme. Kjo e fundit, më 27 gusht 2020, përmes Aktvendimit përkatës, e ndërpreu procedurën sipas padisë së F.T.-së, deri në nxjerrjen e Vendimit nga Gjykata Kushtetuese sipas kërkesës së Gjykatës Supreme lidhur me vlerësimin e kushtetutshmërisë së paragrafit 2 të nenit 8 të Ligjit për Skemat Pensionale të Financuara nga Shteti në lidhje me nenet 5 dhe 6 të Udhëzimit Administrativ nr.09/2015 për Kategorizimin e Shfrytëzuesve të Pensionit Kontributpagues.

II. Raport me Rekomandime ex officio nr. 235/2018 i Avokatit të Popullit në lidhje me kategorinë e qytetarëve që kanë punuar para vitit 1999 dhe nuk përfitojnë nga pensioni kontributpagues të moshës për shkak se nuk e plotësojnë kriterin e stazhit pensional prej 15 viteve si pasojë e largimit diskriminues nga puna

44. Gjykata vëren se Institucioni i Avokatit të Popullit, më 6 prill 2018, e kishte publikuar raportin ex officio për: “[...] tërheqjen e vëmendjes mbi nevojën e rregullimit pozitiv të pensionit kontributpagues për kategorinë qytetarëve të Republikës së Kosovës, të cilët kanë punuar para vitit 1999 dhe nuk e kanë arritur kohën e stazhit pensional prej 15 viteve, pa fajin e tyre, për shkak të largimit diskriminues nga puna në kohën e masave të dhunshme të vendosura në Kosovë”.

45. Në paragrafët 7-9 të Raportit përkatës, Avokati i Popullit, ndër të tjera, thekson se: “...në lidhje me të drejtat dhe trajtimin e pensionistëve në Kosovë, Avokati i Popullit rithekson se kategoria e qytetarëve që kanë punuar para vitit 1999 dhe nuk e kanë arritur stazhin pensional prej 15 viteve për shkak të largimit nga puna në kohën e vendosjes së masave të dhunshme në Kosovë, paraqesin sfidën kryesore për trajtim nga shteti i Kosovës.

Në fakt, e drejta e qytetarëve që bëjnë pjesë në këtë kategori për të përfituar pensionin kontributpagues për periudhën e punës para vitit 1999 (dhe që nuk e kanë arritur kohën e stazhit pensional prej 15 viteve) konsiston në një kolizion midis ligjit që ka përcaktuar kriterin e përfitimit të këtij lloji të pensionit (stazhin pensional prej 15 viteve, siç është edhe përcaktimi në legjislacionin aktual) me parimet që lidhen me të drejtat themelore të njeriut (përkatësisht të drejtën e mbrojtjes së dinjitetit njerëzor, të drejtës për të mos u diskriminuar) dhe obligimet pozitive të shtetit në raport me të drejtat e qytetarëve të tij. Si e tillë, e drejta e përfitimit të pensionit kontributpagues për këtë kategori të qytetarëve të Kosovës është një çështje e veçantë (sui generis) dhe komplekse. Kjo ka të bëjë me faktin se me ligjin e asaj kohe (para vitit 1999) si kriter për përfitimin e këtij lloji të pensionit është përcaktuar stazhi pensional prej 15 viteve, por për shkak të rrethanave të jashtëzakonshme, përkatësisht vendosjes së masave të dhunshme në Kosovë, një pjesë e qytetarëve të Kosovës nuk e kanë arritur këtë kriter, pa fajin e tyre, për shkak të largimit diskriminues nga puna. Në anën tjetër, kompleksiteti i kësaj çështje shprehet me nevojën e ndryshimit të legjislacionit në mënyrë afirmative për shkak të rrethanave të reja dhe të jashtëzakonshme, që kanë ndodhur, përkundër kriterit të përcaktuar me ligjin që ka qenë në fuqi në kohën kur këta qytetarë kanë themeluar marrëdhënien punës. Në anën tjetër, edhe legjislacioni aktual i Kosovës, të drejtën e përfitimit të pensionit kontributpagues të moshës e ka rregulluar duke u bazuar në të njëjtin kriter që kanë përcaktuar ligjet e asaj kohe, që të drejtë të përfitimit kanë vetëm punëtorët që kanë arritur stazhin pensional prej 15 viteve.”

46. Në paragrafët vijues të Raportit, Avokati i Popullit, ndër të tjera, kishte theksuar si në vijim:

“12. Konkretisht, e drejta për pension kontributpagues para vitit 1999 është rregulluar me Ligjin për Sigurimin Pensional Invalidor nr.011-24/83, Gazeta Zyrtare e KSAK-së nr.26/83 (në tekstin e mëtejme: Ligji Nr.011-24/83 i KSAK) dhe Ligjin federativ të ish RSFJ-së, ku është përcaktuar kriteri i lartpërmendur prej 15 viteve të stazhit pensional për të fituar të drejtën e pensionit kontributpagues. Si të tilla, këto ligje nuk janë konsideruar se kanë karakter diskriminues, dhe sigurisht për kohën kur janë miratuar nuk ka pasur një përmbajtje të tillë.

13. Megjithatë, Avokati i Popullit rithekson se për një kategori të qytetarëve të Kosovës largimi diskriminues nga puna në kohën e masave të dhunshme ka qenë shkaku kryesor pse nuk e kanë arritur kohën e stazhit pensional prej 15 viteve. Andaj ky fakt përbën rrethanë të re dhe të jashtëzakonshme përtej dispozitës së ligjit, i cili ka qenë në fuqi dhe ka përcaktuar kriteret e përfitimit të së drejtës për pension kontributpagues.

14. Mbi këtë bazë, Avokati i Popullit vlerëson se e drejta për pensionin kontributpagues për qytetarët e kësaj kategorie duhet të përcaktohet jo vetëm në lidhje me kriterin që ka përcaktuar ligji i asaj kohe (stazhin pensional prej 15 viteve), por edhe duke vlerësuar faktin se largimi nga puna është bërë në mënyrë diskriminuese në kohën e masave të dhunshme.

[...]

18. Avokati i Popullit ka analizuar këtë problem në drejtim të sqarimit të rrethanave që kanë ndikuar në mos plotësimin e këtij kriteri nga një pjesë e qytetarëve që kanë punuar para vitit 1999. Ky fakt konsiston në largimin nga puna në mënyrë arbitrare dhe diskriminuese në kohën e instalimit të masave të dhunshme në Kosovë në vitet e 90-ta. Mbi këtë bazë, Avokati i Popullit insiston se ky fakt nuk mund të injorohet nga institucionet e Republikës së Kosovës dhe se duhet të gjendet një zgjidhje e arsyeshme ligjore mbi të drejtën e qytetarëve për të përfituar nga pensioni kontributpagues.

19. Janë analizuar disa raste të largimit nga puna në vitet e 90-ta, në kohën e vendosjes së masave të dhunshme, me qëllim të argumentimit se ky proces ka qenë arbitrar dhe diskriminues. Prandaj, ky fakt përbën arsye të mjaftueshme që të ndryshohet Ligji për Pensione dhe kësaj kategorie t'ju njihet e drejta në pension kontributpagues të moshës edhe pse nuk kanë arritur kriterin prej 15 viteve të stazhit pensional.

[...]

25. [...] Kjo skemë fillimisht është zbatuar në mënyrë lineare ku të gjithë përfituesit kanë marrë pagesë të njëjtë, pavarësisht profesionit që e kanë kryer dhe vitet e stazhit pensional. Mirëpo ky aspekt është rregulluar me Udhëzimin Administrativ Nr.09/2015 të datës 31.12.2015 (në tekstin e mëtejme: Udhëzimi Nr.09/2015) për kategorizimin e shfrytëzuesve të pensionit kontributpagues sipas strukturës kualifikuese dhe kohëzgjatjes së pagesës së kontributeve-stazhit pensional, i cili ka bërë kategorizimin e pensionistëve që përfitojnë nga kjo skemë.

26. Kjo skemë vlen për qytetarët e Kosovës të cilët kanë paguar kontributet në ish Fondin Pensional të Kosovës para datës 01.01.1999 sipas dispozitave të Ligjit Nr.011-24/83 të KSAK-së.

27. Kushtet dhe kriteret për njohjen e të drejtës në pension kontributpagues të moshës janë të përcaktuara në nenin 8 të LSPFSh ku parashihet se të drejtën në pension kontributpagues të moshës e realizojnë të gjithë personat të cilët kanë shtetësi të Kosovës dhe të cilët:

1.1. kanë mbushur moshën gjashtëdhjetë e pesë (65) vjeçare;

1.2. duhet të ketë stazh pensional kontributdhënës, sipas Ligjit për Sigurimin Pensional dhe Invalidor nr. 011-24/83 (Gazeta Zyrtare e KSAK nr.26/83) para datës 01.01.1999; (theks i shtuar)

1.3. ofrojnë dëshmi të vlefshme mbi pagesën e kontributeve sipas dispozitave të Ligjit për Sigurimin Pensional dhe Invalidor nr.011-24/83 (Gazeta Zyrtare e KSAK nr.26/83) para datës 01.01.1999.

28. Nga kjo dispozitë, del se ligji aktual në lidhje me kriterin e stazhit pensional për kategorinë e qytetarëve që kanë punuar para vitit 1999 nuk përcakton kohëzgjatje të stazhit pensional kontributpagues. Ligji aktual i referohet Ligjit Nr.011-24/83 të KSAK-së, i cili në përputhje me ligjin federativ, hollësisht rregullon të drejtat nga sigurimi pensional e invalidor për KSAK, në përputhje me ligjin federativ, përkatësisht Ligjin për të Drejtat Themelore nga Sigurimi Pensional dhe Invalidor (Sl. List SFRJ br, 23/82, 77/82) ku shprehimisht përcaktohen kriteret e tilla (në tekstin e mëtejme: Ligji federativ). Pra është ligji federativ, ai i cili përcakton të drejtat themelore nga sigurimi pensional, e në këtë kuptim përcaktohen edhe kriteret për përfitimin e pensionit kontributpagues ku një ndër to është kohëzgjatja e stazhit pensional.

29. Ligji federativ si akt suprem i zbatueshëm për të gjitha ish-Republikat dhe Krahinat, ka përcaktuar parimet, të drejtat dhe kushtet themelore lidhur me sigurimin pensional dhe invalidor ndërsa Ligji Nr. 011-24/83 i KSAK-së përcakton hollësitë dhe specifikat e sigurimit pensional. Ligji federativ në mënyrë taksative definon kushtet për përfitimin e të drejtës në pension kontributpagues të moshës (Kapitulli III, Pjesa 1, neni 21) si në vijim: "... I siguruari fiton të drejtën e pensionit të pleqërisë kur arrin moshën 65 vjeçare (mashkulli), respektivisht 60 vjet (femra) dhe së paku 15 vite stazh pensional...".

30. Si i tillë ky kriter për “stazh pensional prej së paku 15 viteve” është bartur në legjislacionin e Republikës së Kosovës, përkatësisht LSPFSh (neni 8), siç ju referuam me lartë. Pikërisht ky përcaktim, pamundëson që një pjesë e qytetarëve që kanë punuar para vitit 1999 të përfitojnë nga skema e pensionit kontributpagues të moshës, të cilët nuk kanë arritur të kenë stazh pensional prej 15 viteve për shkak të largimit arbitrar dhe diskriminues nga puna, në kohën e vendosjes së masave të dhunshme në Kosovë. Duhet theksuar se të njëjtit kriter i referohet edhe Udhëzimi Administrativ (UA) Nr.11/2007 për Zbatimin e Vendimit të Qeverisë 13/2007, ku në nenin 3 si kritere për përfitimin e pensionit kontributpagues ka përcaktuar arritjen e moshës 65 vjeçare dhe minimum 15 vjet stazh të sigurimit pensional. Ky udhëzim duket se ka rregulluar këtë fushë deri në hyrjen në fuqi të LSPFSh.

31. Nga kjo që u prezantua me lartë, vërehet se sipas legjislacionit aktual (ex lege) qytetarët e Kosovës që kanë punuar para vitit 1999 por që nuk kanë arritur stazhin pensional prej 15 viteve nuk mund të përfitojnë nga pensioni kontributpagues i moshës. Kështu, pa ndryshimin e legjislacionit në fuqi kjo kategori e qytetarëve nuk mund të përfshihen në këtë skemë pensionale, derisa kemi të bëjmë me një kriter ligjor të pavolitshëm për këtë kategori.

32. Këtë përcaktim të nenit 8 të LSPFSh i cili normon kriterin prej 15 vitesh të stazhit pensional siç ka qenë i përcaktuar në Ligjin e KSAK-së, përkatësisht Ligjin federativ, përkundër faktit se ndjek një logjikë harmonike në kuptimin e hartimit të legjislacionit, Avokati i Popullit e konsideron si të padrejtë në raport me punëtorët të cilët janë larguar në mënyrë arbitrar dhe diskriminuese nga puna në vitet e 90-ta, në kohën e masave të dhunshme.

[...]

33. Avokati i Popullit vlerëson se për një trajtim jo diskriminues, të drejtë dhe në pajtim me respektimin e dinjitetit njerëzor, shteti i Kosovës duhet të afërtojë të drejtat e qytetarëve që të mos dëmtohen nga praktikat diskriminuese që kanë ndodhur në të kaluarën, siç ka qenë praktika e largimit të dhunshëm nga puna, pa fajin e punëtorëve.

[...]

46. Mbi këtë bazë, Avokati i Popullit rikujton se Ligji i Marrëdhënieve të Punës në Rrethana të Veçanta” (Gazeta Zyrtare e Republikës së Serbisë nr. 40/90) ka qenë diskriminues dhe bazuar në këtë akt të miratuar në kohën e vendosjes së masave të dhunshme është bërë largimi i punëtorëve nga puna, kryesisht të përkatësishë etnike shqiptare. Ky fakt vërehet qartësisht edhe në rastin e prezantuar më sipër (shih pika 19). Gjithashtu, Avokati i Popullit rikujton se ky ligj konsiderohet si diskriminues edhe sipas Rregullores së UNMIK-ut 1999/24.

47. Prandaj, derisa ligji i lartpërmendur ka pas karakter diskriminues, nga një interpretim logjik del se të gjitha pasojat që ka prodhuar ky ligj si i tillë, janë diskriminuese. Duke u bazuar në këtë fakt, Avokati i Popullit insiston se ndryshimi i LSPFSh, përkatësisht neni 8 i tij, është i domosdoshëm me qëllim të njohjes së të drejtës për pension kontributpagues të gjithë qytetarëve që kanë punuar para vitit 1999 dhe nuk kanë arritur “stazhin pensional prej 15 viteve” për shkak të largimit nga puna në baza të diskriminimit.

48. Në këtë drejtim, Avokati i Popullit rikujton edhe referencën e DHPGJS në Rezolutën e Asamblesë së Përgjithshme të KB-së nr. 48/153 të datës 20 dhjetor 1993, e cila e njeh (dhe dënon) mes të tjerave “... masat dhe praktikat e diskriminimit dhe

shkeljet e të drejtave të njeriut të shqiptarëve të Kosovës, si dhe represionin e madh të bërë nga autoritetet serbe, duke përfshirë: ... b. Largimin diskriminues të zyrtarëve shqiptarë, veçanërisht nga policia dhe gjyqësori, largimin masiv të shqiptarëve nga pozitat profesionale, administrative dhe pozitat tjera të kualifikuara në ndërmarrjet shoqërore dhe institucionet publike, duke përfshirë mësuesit nga sistemi shkollor i drejtuar nga serbët.”

49. Për më tepër, ligj diskriminues ka qenë edhe “Ligji mbi Masat e Përkohshme për Mbrojtjen Shoqërore të të Drejtave Vetë-Menaxhuese dhe të Pronës Shoqërore” (Gazeta Zyrtare e RSS nr. 49 të datës 28 tetor 1989) që ka mundësuar që përmes të ashtuquajturave “Masa të Përkohshme” të vendosura në Ndërmarrjet Shoqërore (NSH), menaxhmenti shqiptar është larguar nga puna dhe është zëvendësuar me menaxhmentin serb. Edhe këtë kategori të menaxherëve të larguar e përfaqëson në mënyrë tipike rasti i prezantuar i punëtorit me pozitë drejtuese S.J. Po ashtu, edhe ky ligj konsiderohet i shfuqizuar me Rregulloren e UNMIK-ut 1999/24 për shkak të karakterit diskriminues.

50. Nga kjo që u trajtua më lartë, del qartësisht se largimi nga puna në kohën e masave të dhunshme ka qenë një proces diskriminues i bazuar në ligje diskriminuese. Mbi këtë bazë, Avokati i Popullit tërheq vëmendjen se nga këto fakte lind detyrimi kushtetues për Qeverinë e Republikës së Kosovës që të marrë masat për të mënjnuar diskriminimin e kësaj kategorie të qytetarëve duke njohur të drejtën e tyre në pension kontributpagues të moshës për qytetarët që nuk kanë arritur stazhin pensional prej 15 viteve për shkak të largimit të dhunshëm e diskriminues nga puna në vitet e 90-ta.

Detyrimet kushtetuese dhe obligimet pozitive të shtetit të Kosovës në raport me të drejtat e qytetarëve

51. Obligimi i shtetit të Kosovës për të njohur të drejtën në pension kontributpagues për kategorinë e qytetarëve që janë larguar nga puna në baza diskriminuese buron nga një numër i dispozitave të Kushtetutës. Në rend të parë nga dispozitat themelore të Kushtetutës, përkatësisht neni 3 [Barazia para ligjit] ku ndër të tjera përcaktohet se: “Ushtrimi i autoritetit publik në Republikën e Kosovës bazohet në parimet e barazisë para ligjit të të gjithë individëve dhe në respektimin e plotë të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, të pranuar ndërkombëtarisht ...” (paragrafi 2).

52. Në frymën e kësaj dispozite themelore duhet të miratohet edhe legjislacioni që përcakton të drejtat e caktuara të qytetarëve, përfshirë edhe ligjin që përcakton të drejtën në pension. Në këtë drejtim, derisa është fakt i pakontestueshëm se një pjesë e qytetarëve janë larguar në baza diskriminuese nga puna, në kohën e masave të dhunshme, dhe për këtë shkak nuk e kanë arritur “stazhin pensional prej 15 viteve”, atëherë për një barazi para ligjit kjo kategori nuk mund të barazohet me pjesën tjetër të qytetarëve ndaj të cilëve nuk është zbatuar e njëjta praktikë (ndaj të cilëve, rrjedhimisht edhe mund të zbatohet kriteri për stazh pensional prej 15 viteve). Konkretisht, respektimi i këtij parimi do të nënkuptonte ndryshimin e nenit 8 të LSPFSh, dhe për këtë kategori të qytetarëve të njihet e drejta në pension kontributpagues edhe nëse nuk është arritur kriterin për stazh pensional. Në të kundërtën, Avokati i Popullit vlerëson se dispozita e nenit 8 të LSPFSh, siç është aktualisht, e legjitimon praktikën diskriminuese të largimit nga puna në kohën e masave të dhunshme, dhe në frymën e tij e cenon parimin themelor të barazisë së qytetarëve para ligjit.

[...]

58. Për më tepër, Avokati i Popullit thekson se mohimi i të drejtës në pension kontributpagues të moshës për këtë kategori të qytetarëve përveç se përbën cenim të

barazisë para ligjit dhe diskriminim, cenon edhe dinjitetin e tyre, që sipas Kushtetutës duhet të jetë bazë e të gjitha të drejtave të tjera të njeriut. Ky standard përcaktohet në nenin 23 të Kushtetutës ku theksohet se “Dinjiteti i njeriut është i pacenueshëm dhe është bazë e të gjitha të drejtave dhe lirive themelore të njeriut”.

59. Si përfundim, në bazë të fakteve dhe argumenteve të prezantuara në këtë raport, Avokati i Popullit konsideron se Qeveria e Republikës së Kosovës, përkatësisht MPMS në pajtim me Kushtetutën dhe obligimet pozitive të shtetit në raport me avancimet e të drejtave të njeriut, duhet të iniciojnë ndryshimin e LSPFSh me qëllim që të gjithë qytetarëve që në baza diskriminuese janë larguar nga puna në vitet e 90-ta, të përfitojnë nga pensioni kontributpagues i moshës edhe pse nuk e kanë arritur stazhin pensional prej 15 viteve.

60. Sigurisht, në pajtim me natyrën e të drejtës në pension, MPMS ka autoritetin që të bëjë edhe kategorizimin e pensionisteve që kanë punuar para vitit 1999 në varësi të viteve të punës, profesionit, detyrave dhe kriterëve të tjera për këtë qëllim.

66. Nga analiza e fakteve dhe ngjarjeve që ka ndodhur pas vitit 1989, përkatësisht praktikës së largimit nga puna në kohën e masave të dhunshme, Avokati i Popullit konstaton se ky proces ka qenë diskriminues. Nga hulumtimi i IAP del se largimi nga puna në vitet e 90-ta pas vendosjes së masave të dhunshme në Kosovë, është bazuar në praktikë arbitrare, e zbatuar nga “organe të përkohshme” (p.sh. “organi i përkohshëm punëdrejtues” siç është paraqitur edhe në këtë raport) dhe sipas ligjeve të veçanta diskriminuese.

67. Për më tepër, këtë praktikë si diskriminuese e kanë cilësuar edhe Rezolutat e OKB-së, Tribunali i Hagës dhe Gjykata Supreme e Kosovës. Mbi këtë bazë, Avokati i Popullit tërheq vëmendjen se një praktikë e tillë diskriminuese nuk duhet që edhe më tutje të prodhojë pasoja për qytetarët e Kosovës, përkatësisht kategorinë e qytetarëve që nuk përfitojnë nga pensioni kontributpagues.

68. Për këto arsye, dhe duke u bazuar në detyrimet kushtetuese dhe obligimet pozitive që shteti ka në raport me qytetarët, Avokati i Popullit konstaton domosdoshmërinë që Qeveria e Republikës së Kosovës të marrë masa që të gjithë qytetarët që kanë punuar para vitit 1999 dhe janë larguar nga puna mbi baza diskriminuese të përfitojnë nga pensioni kontributpagues i moshës. Për këtë qëllim është e nevojshme të ndryshohet LSPFSh, përkatësisht neni 8 i tij.”

III. Përmbledhje e shkurtër e historikut të sistemit pensional dhe invalidor në Kosovë bazuar në Informatat e dhëna nga MPMS-ja më 29 janar 2021

47. Më 29 janar 2021, MPMS dorëzoi në Gjykatë “Informatë lidhur me rastin KO190/90”. Ndër të tjera, MPMS sqaronte që sistemi pensional dhe invalidor në Kosovë, ka kaluar nëpër disa etapa: (i) etapa e parë përfshin periudhën prej vitit 1947 deri në vitin 1983 kur në Kosovë janë aplikuar ligjet e ish-Federatës Jugosllave; (ii) etapa e dytë përfshin periudhën prej vitit 1983 deri në vitin 1992 kur Kosova kishte një sistem pensional dhe invalidor autonom të rregulluar sipas ligjeve të miratuara nga Kuvendi i Kosovës; (iii) etapa e tretë përfshin periudhën prej vitit 1992 deri në vitin 1999 kur sistemi pensional dhe invalidor i Kosovës, me ligje diskriminuese u integrua në sistemin pensional dhe invalidor të Republikës së Serbisë; (iv) etapa e katërt e sistemit pensional dhe invalidor është e viteve 1999-2002 e njohur si “etapa e vakumit institucional dhe ligjor” në Kosovë, sepse për shkak të luftës në këtë interval kohor, fare nuk funksionoi sistemi pensional dhe invalidor i Kosovës, me ç’ rast pjesa dërmuese e pensionistëve kosovarë mbetën pa pensione; dhe (v) etapa e pestë fillon prej datës 01 korrikut 2002 e tutje, si etapë reformuese me koncept të ri të sistemit pensional dhe invalidor i përberë nga tri shtylla, ku dy forma të pensioneve,

ai bazik i moshës dhe i kursimeve individuale janë obligative dhe shtylla e tretë reflekton formën e pensioneve vullnetare.

48. Në vijim, MPMS theksoi se: *“Pas suprimimit të autonomisë së Kosovës në vitin 1989, pason edhe suprimimi i Fondit për Sigurimin Pensional e Invalidor.”* Ndërsa, prej vitit 1992 deri 1999, në Fondin e SPI-së hyjnë masat e dhunshme, dhe i njëjti bartet në kompetencat e Fondit Pensional e Invalidor të Serbisë. Në vijim, MPMS thekson se: *“Si rrjedhojë e luftës gjatë vitit 1999 rezulton shkatërrimi total i sistemit pensional në Kosovë si dhe ndërprerja e pagesës së pensioneve për shqiptarët etnik, sepse mjetet e Fondit Pensional të Kosovës janë bartur në Fondin Pensional të Serbisë.”* MPMS gjithashtu sqaron se *“pas kësaj periudhe, në vitin 2002, Kosova do të shkëputet përfundimisht nga sistemi pensional i zbatuar në ish-Jugosllavi (pay as you go shkurtimisht PAYG)”*.
49. MPMS, për më tepër, sqaroi që sistemi pensional në Kosovë që nga viti 2002 përbëhet nga tri shtylla, ku dy forma të pensioneve, pensioni bazik i moshës dhe ai i kursimeve individuale, respektivisht janë obligative, kurse shtylla e tretë është formë e pensioneve vullnetare.
50. Në bazë të sqarimit të dhënë: *“Shtylla e parë përfshin skemat pensionale të financuara nga buxheti i shtetit, fillimisht përbëhej prej pensioneve publike të paguara për të gjithë kosovarët-pensione bazike, duke përfshirë edhe pensionin për aftësi të kufizuar; kjo shtyllë është plotësuar më vonë vazhdimisht edhe me këto skema pensionale e kompensime: pensione kontributive, pensionet e parakohshme të minatorëve të minierave në Kosovë dhe Kompleksi “Trepça”, pensionet e pjesëtarëve të Trupave Mbrotjtëse të Kosovës (TMK), pensionet e pjesëtarëve të Forcës së Sigurisë së Kosovës, kompensimin për Personat e Verbër, skema për kompensimin e personave Paraplegjik dhe Tetraplegjik, skema për kompensimin e Punëtorëve të Arsimit nga viti shkollor 1990/91 deri në vitin shkollor 1998/99”*.
51. MPMS vazhdoi të sqaroi se: *“...shtylla e dytë përfshin kursimet pensionale në llogaritë individuale të obligueshme për të gjithë të punësuarit që punojnë në Kosovë, të moshës mbi 18 vjeç. Burim kryesor i kursimeve pensionale janë kontributet e obligueshme. Kontributi është caktuar të jetë 10% përqind e shumës së pagës, me pjesëmarrje të kontributeve 5% punëdhënësi dhe 5% i punësuar. Lartësia e pensionit varet nga shuma e kontributeve të paguara, ndërsa të ardhurat fitohen nga investimi i tyre (kapitalizimi i investimeve individuale)”*.
52. Në fund, MPMS thekson se: *“Shtylla e tretë-sistem pensional vullnetar (plotësues). Ky sistem është pension vullnetar privat i organizuar në baza individuale ose nga vet ndërmarrjet. Ky sistem plotëson sistemin e shtyllës së parë dhe të dytë”*.
53. Përfundimisht, MPMS thekson se pensionet kontributpaguese janë kategori të paguara nga buxheti i shtetit, pavarësisht që skema quhet kontributpaguese. Rrjedhimisht, shuma e pensionit dhe kategorizimi nuk ka të bëjë me shumën e kontributit të paguar para vitit 1999, pasi që e njëjta është plotësisht e mbuluar nga buxheti i shtetit.
54. MPMS-ja po ashtu theksoi se aktualisht punëtorët e arsimit janë kategoria e përfituesve më të favorizuar sa i përket të drejtës në pension kontributpagues ngase krahas njohjes së stazhit 1990 deri 1999 e realizojnë edhe një kompensim shtesë i cili varion varësisht sa është punuar gjatë viteve 1989-1990 deri 1998-1999. Ligji i kontestuar nga Gjykata referuese përcakton se: *“Me këtë ligj u njihet stazhi i punës për pension kontributdhënës për vitet 1998-1999 punëtorëve të arsimit, të shëndetësisë dhe të tjerëve që kanë punuar në sistemin e Republikës së Kosovës”*, përmes paragrafit 6 të nenit 8 të Ligjit për Skemat Pensionale të Financuara nga Shteti.

55. Në ndërlidhje me pyetjen Gjykatës drejtuar MPMS-së se: *“Cilat janë të drejtat e atyre personave që ofrojnë dëshmi për kontribut nën 15 vite përvojë pune para 1 janarit 1999 dhe si mund të realizojnë këtë të drejtë në rrethanat aktuale?”*, kjo e fundit deklaroi që: *“Të gjithë parashtuesit e kërkesës për pension kontributpagues që nuk ofrojnë dëshmi për 15 vite stazh pune ata realizojnë të drejtën në pension bazë; në vijim, MPMS gjithashtu thekson se: “Ju përkujtoj që neve kemi hartuar një udhëzim administrative të ri me të cilin parashihen disa ndryshime substanciale në kuptim të realizimit të pensionit kontributiv siç janë; -njohja e periudhës 1990 deri 31.12.1998 si stazh kontributiv për të gjithë të dëbuarit nga puna nga administrata e dhunshme serbe [theksim i shtuar]; - si dhe njohja e diplomave deri në vitin 1998”*.
56. Përfundimisht, në lidhje me pyetjen e 5-të të Gjykatës drejtuar MPMS-së, përkatësisht: *“A kanë Institucionet e Kosovës qasje në regjistrin e marrëdhënies së punës të punëtorëve në periudhën 1990-1999? Si është e rregulluar çështja e barrës së provës për ofrimin e dëshmive të tilla me rastin e aplikimit për pension kontributpagues të moshës?”*, kjo e fundit përgjigjet si në vijim:

“Institucionet e Kosovës përkatësisht MPMS-DP-ve posedojnë disa regjistra, kopje të formularëve për pagesë të kontributeve (disa organizata), aktgjykime të gjykatave para dhe pas luftës, vendime të ndryshme të OP-ve të atëhershme, vendime të pushimeve vjetore dhe prova tjera materiale relevante, dokumente të lëshuara nga AKP (i posedojnë dosjet e OP-ve që janë privatizuar), thënë thjesht çdo dokument që konsiderohet valid për marrëdhënie pune; provat materiale që posedojmë neve si departament i sigurojmë nga databazat tona përkatësisht nga arkivat që i kemi trashëguar, ndërsa për provat eventuale që neve nuk i posedojmë i udhëzojmë palët.”

Pretendimet e Gjykatës referuese

57. Thelbi i kërkesës së Gjykatës referuese konsiston në dyshimet lidhur me kushtetutshmërinë e paragrafit 2 të nenit 8 të Ligjit të kontestuar, si dhe me përputhshmërinë e këtij neni me *“instrumentet ndërkombëtare, që rregullojnë korpusin e të drejtave dhe lirive të njeriut”*. Gjykata referuese pretendon ekzistimin e shkeljes së neneve 24 [Barazia para Ligjit] dhe 46 [Mbrotja e Pronës] të Kushtetutës në ndërlidhje me nenin 1 (Mbrotja e Pronës) të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së.
58. Sipas interpretimit të Gjykatës referuese, neni i lartcekur i Ligjit të kontestuar parasheh që kategorizimi i shfrytëzuesve të pensionimit kontributdhënës, sipas kohëzgjatjes së pagesës së kontributit, sipas strukturës kualifikuese dhe kriterëve të tjera, përcaktohet me akt nënligjor, të cilin e miraton Ministria përkatëse. Në këtë drejtim, Ministria përkatëse, përkatësisht MPMS, përmes Udhëzimit Administrativ të kontestuar, në nenin 6 të tij, si kriter për njohjen e të drejtës në pensionin kontributpagues ka përcaktuar kushtin që shfrytëzuesit duhet të kenë stazh pensional kontributdhënës së paku pesëmbëdhjetë (15) vjet para datës 1 janar 1999, sipas *‘Ligjit të Sigurimit Pensional dhe Invalidor (SPI-së) të Kosovës, nr.26/83’*.
59. Rrjedhimisht, Gjykata referuese thekson se për të përfituar pensionin kontributdhënës, kualifikohet personi që ka së paku pesëmbëdhjetë (15) vite stazh pensional para datës 1 janar 1999. Prandaj, sipas Gjykatës referuese, limitimi i tillë në aspektin kohor, është në kundërshtim me Kushtetutën dhe të gjitha instrumentet ndërkombëtare, nga se si bazë për pension nuk merr *“shekullin e punës së kontributdhënësit”* (apo periudhën e punës së kontributdhënësit), por kontributin e tij në një periudhë të caktuar kohore, e që konsiston në atë se dikush që deri në vitin 1999 dhe ka vetëm 15 vjet stazh pune, të marrë pension të plotë, ndërsa ata që me rastin e aplikimit për pension, i kanë edhe 30 vite kontribut, por nuk i kanë 15 vite deri më 1 janar 1999, të mos marrin pension. Gjykata referuese gjithashtu thekson se është *“botërisht e ditur”*, se komuniteti shqiptar është larguar nga puna në mënyrë masive në periudhën 1990-1999.

60. Përfundimisht, Gjykata referuese thekson se dispozitat e Ligjit të kontestuar dhe Udhëzimit Administrativ të kontestuar janë në kundërshtim me nenin 24 dhe 46 të Kushtetutës dhe nenin 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së. Rrjedhimisht, bazuar në argumentimin e mësipërm, Gjykata referuese propozon: (i) miratimin e kërkesës dhe shpalljen kundërkushtetuese të dispozitave të lartcekura të Ligjit dhe Udhëzimit Administrativ të kontestuar; dhe (ii) të urdhërohet organi ligjdhënës, respektivisht Kuvendi, që në afat sa ma të shkurtër ta harmonizojë ligjin në fjalë me Kushtetutën e Republikës së Kosovës.

Përgjigjet e pranura nga anëtarët e Forumit të Komisionit të Venedikut

61. Në pyetjet e drejtuara nga Gjykata në Forumin e Komisionit të Venedikut, sikurse është shënuar në paragrafin 24 më sipër, Gjykata ka pranuar përgjigje nga: (i) Gjykata Kushtetuese e Republikës Çeke; (ii) Gjykata Kushtetuese e Rumanisë; (iii) Gjykata Kushtetuese e Maqedonisë së Veriut; (iv) Gjykata Kushtetuese e Bosnjës dhe Hercegovinës; (v) Lihtenshtajni; (vi) Gjykata e Holandës; (vii) Gjykata Kushtetuese e Letonisë; (viii) Gjykata Kushtetuese e Bullgarisë; (ix) Tribunali Kushtetues i Polonisë; (x) Gjykata Kushtetuese e Sllovakisë; (xi) Gjykata Kushtetuese e Kroacisë; (xii) Gjykata Supreme Administrative e Suedisë; dhe (xiii) Gjykata Kushtetuese e Afrikës Jugore. Në vijim, Gjykata do të paraqesë përgjigjet e Gjykatave të lartshënuara, në pyetjet e Gjykatës siç janë shtjelluar në paragrafin 24 të këtij Aktgjykimi.

(i) Gjykata Kushtetuese e Republikës Çeke

62. Vendimet e Gjykatës Kushtetuese që anulojnë një statut, dispozita të tjera ose dispozita individuale të tij janë sipas nenin 58 (1) të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të zbatueshme në ditën e publikimit në Përmbledhjen e Ligjeve, përveç rasteve kur Gjykata vendos ndryshe. Neni 70 (1) i Ligjit parasheh se në vendimin e tillë Gjykata Kushtetuese cakton ditën e anulimit.
63. Për të shmangur pasojat e padëshiruara të një anulimi të menjëhershëm të ligjit të kontestuar, ndonjëherë është e nevojshme të shtyhet zbatimi (efektiviteti) i një vendimi. Koha që i jep Gjykata Kushtetuese ligjvënësit për të sjellë ligjin në fjalë në përputhje me rendin kushtetues ndryshon. Edhe pse nuk është përcaktuar një periudhë fikse, në shumicën e rasteve ajo shtrihet diku nga 2 deri në 18 muaj (varet nga rrethanat individuale të rastit). Gjatë kësaj periudhe ligji i shpallur jokushtetues mbetet ndërkohë pjesë e një rendi juridik dhe është ende i detyrueshëm për të gjitha autoritetet dhe personat publikë.
64. Duke folur për rastet në pritje/të pazgjidhura, mosveprimi i gjykatave do të ishte ndoshta skenari më i keq. Sipas teorisë juridike, gjykatat nuk duhet të presin zbatimin e vendimit të Gjykatës Kushtetuese, përkatësisht miratimin e një ligji të ri nga Kuvendi. Ato duhet të vazhdojnë procedurat dhe, nëse është e mundur, të zbatojnë drejtpërdrejt dispozitat përkatëse të ligjeve kushtetuese ose të traktateve ndërkombëtare në vend të ligjit të deroguar nga Gjykata Kushtetuese. Nëse një zbatim i tillë i drejtpërdrejtë i normave kushtetuese nuk është një opsion, gjykatat nuk kanë zgjidhje tjetër veçse të zbatojnë ligjin jokushtetues. Megjithatë, ato do të përpiqen të interpretojnë dhe zbatojnë ligjin në përputhje me Kushtetutën, duke pasur parasysh arsyetimin e vendimit për anulim të Gjykatës Kushtetuese.
65. Në vijim, Gjykata Kushtetuese e Republikës Çeke theksoi që është e rëndësishme të shtohet se fakti i vetëm që një gjykatë e rregullt ka zbatuar një ligj që është shpallur jokushtetues (por një vendim i tillë i Gjykatës Kushtetuese nuk ka qenë ende i zbatueshëm), nuk duhet të përbëjë arsye të mjaftueshme për anulimin e vendimit të gjykatës së rregullt. Gjykata Kushtetuese mund të ndërhyjë vetëm nëse mënyra e zbatimit të ligjit jokushtetues nga gjykata e rregullt ka shkaktuar cenimin e të drejtave themelore të një individi.

66. Anulimi i një ligji ose i dispozitave të tij individuale nga Gjykata Kushtetuese mund të përbëjë bazë për rihapjen e një rasti vetëm në procedurë penale nëse aktgjykimi i një gjykate të rregullt ende nuk është përmbaruar. Vendimet e tjera të nxjerra në bazë të ligjit të anuluar duhet të mbeten të paprekura; megjithatë, të drejtat dhe detyrat që rrjedhin nga këto vendime nuk mund të zbatohen. Në këtë kontekst, shih nenin 71 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese:

Neni 71

(1) Nëse, në bazë të një ligji ose ndonjë akti tjetër të cilin Gjykata e ka anuluar, një gjykatë në një procedurë penale ka marrë një aktgjykim i cili ka fituar efekt juridik, por ende nuk është ekzekutuar, pavlefshmëria e këtij ligji ose akti tjetër përbën arsye për rihapjen e procedurës në përputhje me dispozitat e ligjit për procedurën penale.

(2) Vendimet e tjera juridikisht të plotfuqishme të nxjerra në bazë të një ligji ose ndonjë akti tjetër, i cili është anuluar, mbeten të paprekura; megjithatë, të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga vendime të tilla nuk mund të zbatohen.

(3) Dispozitat e paragrafëve 1 dhe 2 zbatohen edhe në rastet kur një pjesë e një ligji ose ndonjë akti tjetër ose ndonjë dispozitë e tij shfuqizohet.

(4) Përndryshe të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga marrëdhëniet juridike të krijuara para pavlefshmërisë së ligjit ose aktit tjetër, mbeten të paprekura.

67. Me një Aktgjykim të 28 marsit 1995 [Nr. Pl. ÚS 20/94], Gjykata Kushtetuese anuloi disa dispozita ligjore në lidhje me kujdesin institucional për fëmijët. Duke pasur parasysh domosdoshmërinë e mbajtjes së një kornize ligjore për ndjekjen e hapave të ndryshëm ligjor urgjent në interes të një fëmije, Gjykata vendosi ta shtyjë zbatimin (efektivitetin) e vendimit deri më 1 tetor 1995, në mënyrë që t'i japë ligjvënësit një kohë të arsyeshme për futjen e ndryshimeve të nevojshme legjislative.
68. Një qasje e ngjashme u morr në një sërë vendimesh të tjera. Për shembull, në Aktgjykimin [Nr. Pl. ÚS 26/94] e 18 tetorit 1995 (përputhja kushtetuese e dispozitave ligjore për financimin e partive politike), Gjykata Kushtetuese shtyu fuqizimin e vendimit për 14 muaj; ajo vendosi se zbrazëtia ligjore e shkaktuar nga shfuqizimi i menjëhershëm i ligjit të kontestuar do të ishte në kundërshtim me parimin e proporcionalitetit dhe sundimin e ligjit.
69. Në Aktgjykimin [Nr. Pl. ÚS 9/2000] e 17 janarit 2001, efekti i derogimit të ligjit të kontestuar (mungesa e shqyrtimit gjyqësor të vendimeve të veçanta të organeve administrative), u shty për më shumë se një vit (deri më 28 shkurt 2002), sepse derogimi i menjëhershëm do të kishte shkaktuar mbingarkesë të Gjykatës Kushtetuese. Ndërkohë, Parlamenti duhej të vazhdonte punën në legjislacionin e ri për gjyqësorin administrativ dhe të merrte parasysh konkluzionet e Gjykatës.

(ii) Gjykata Kushtetuese e Rumanisë

70. Gjykata Kushtetuese e Rumanisë theksoi se në bazë të fjalisë së parë të nenit 147 (1) të Kushtetutës, dispozitat e ligjeve dhe urdhëresave në fuqi, të cilat konstatohen se janë jokushtetuese, pushojnë efektin e tyre juridik brenda 45 ditëve nga publikimi i vendimit të Gjykatës Kushtetuese, nëse, ndërkohë, Parlamenti apo Qeveria, sipas rastit, nuk kanë arritur të sjellin dispozitat jokushtetuese në harmoni me dispozitat e Kushtetutës. Ligji ose urdhëresa ose dispozitat e tij të konstatuara si jokushtetuese nuk mund të zbatohen më nga asnjë gjykatë në asnjë rast ose nga asnjë autoritet tjetër publik nga data e publikimit në Gazetën Zyrtare të vendimit të Gjykatës Kushtetuese. “Vendimi për konstatimin e jokushtetutshmërisë është pjesë e rendit juridik normativ dhe me hyrjen e tij në fuqi dispozita jokushtetuese pushon së zbatuari për të ardhmen” (shih Vendimin e Gjykatës Kushtetuese të Rumanisë nr. 847, i 8 korrikut 2008, publikuar në Gazetën Zyrtare nr. 605, të 14 gushtit 2008). Ndërhyrja e Kuvendit ose e Qeverisë brenda afatit të pezullimit të dispozitave të konstatuara si jokushtetuese, me qëllim që ato të përputhen me vendimin e

Gjykatës Kushtetuese, është shprehje e natyrës përgjithësisht detyruese dhe përfundimtare të vendimeve të Gjykatës Kushtetuese. Rrjedhimisht, për periudhën e përcaktuar në nenin 147 (1) të Kushtetutës, dispozitat e konstatuara si jokushtetuese pezullohen me të drejtë dhe gjykatat nuk mund t'i zbatojnë ato.

71. As Kushtetuta rumune dhe as Ligji nr.47/1992 për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese nuk parashikojnë një afat kohor brenda të cilit ligjvënësi duhet ta sjellë rregullin e gjetur si jokushtetues në përputhje me Kushtetutën.
72. Prandaj, vendimi për konstatimin e jokushtetutshmërisë zbatohet drejtpërsëdrejti për të gjitha rastet e pazgjidhura në gjykata. Ai do të zbatohet, me anë të rrugës së jashtëzakonshme të ankesës që konsiston në revizion, edhe për një rast që është zgjidhur me vendim të formës së prerë, nëse vendimi i Gjykatës Kushtetuese për pranimin e përjashtimit është shqiptuar pas momentit kur përjashtimi për jokushtetutshmërinë u ngrit në atë rast konkret.
73. Si përmbledhje, vendimi për konstatimin e jokushtetutshmërisë nuk do të zbatohet për rastet e zgjidhura me vendim të formës së prerë para datës së publikimit në Gazetën Zyrtare, pasi gjatë gjithë periudhës së veprimit të rregullit, ky i fundit gëzon një prezumim të kushtetutshmërisë, por do të zbatohet për të gjitha rastet që janë në pritje në gjykata në datën e publikimit të vendimit në Gazetën Zyrtare. Është zbatim i dispozitave të fjalisë përfundimtare të nenit 147 (4) të Kushtetutës, sipas së cilës, nga data e publikimit, vendimet hyjnë në fuqi vetëm për të ardhmen dhe në këtë mënyrë respektohet prezumimi i kushtetutshmërisë së rregullit juridik për periudhën para publikimit të vendimit për jokushtetutshmëri. Megjithatë, vendimi do të zbatohet gjithmonë në rastin në të cilin është ngritur përjashtimi, pavarësisht nëse ai është zgjidhur ose jo me një vendim përfundimtar.
74. Ka situata (të rralla) në të cilat korrigjimi i mangësisë rregullative të konstatuar në vendimin për pranueshmëri të Gjykatës Kushtetuese kryhet nga ligjvënësi brenda periudhës nga data e dorëzimit të zgjidhjes deri në datën e publikimit të vendimit në Gazetën Zyrtare të Rumanisë. Në atë rast, është ndërhyrja e ligjvënësit i cili heq defektin e jokushtetutshmërisë, natyrisht që nga data e hyrjes në fuqi, por vendimi i Gjykatës do të prodhojë efektet e tij për të gjitha marrëdhëniet juridike në pritje në datën e publikimit, në rastet në pritje në gjykata dhe në rastet e zgjidhura me vendim të formës së prerë, por në të cilat është ngritur një përjashtim i jokushtetutshmërisë para datës së publikimit të vendimit në Gazetën Zyrtare.
75. Korniza normative rumune nuk parashikon mundësinë e gjykatave për të pezulluar rastet e pazgjidhura në dosjet e tyre derisa ligjvënësi të miratojë një ligj përmes të cilit ai sjell rregullin e shpallur jokushtetues në përputhje me Kushtetutën.
76. Në praktikën e saj gjyqësore mbi efektet e vendimeve për pranueshmëri që ajo jep, Gjykata ka konstatuar se, për të përcaktuar nevojën për ndërhyrje të mëtejshme nga ligjvënësi, është e nevojshme të shqyrtohet se deri në çfarë mase trupi i legjislacionit në të cilin Vendimi i Gjykatës Kushtetuese bazohet siguron elemente të nevojshme për zbatimin e tij në mënyrë uniforme dhe të parashikueshme, pavarësisht pasivitetit të ligjvënësit.
77. Hipoteza e parë është se deri në miratimin e zgjidhjes së duhur legislative, si pasojë e vendimit që vërteton përjashtimin e jokushtetutshmërisë, gjykatat zbatojnë drejtpërdrejt dispozitat kushtetuese të përcaktuara në vendimin e Gjykatës në lidhje me situatën normative për të cilën është konstatuar se është në kundërshtim me Kushtetutën. Prandaj, gjykatat, në bazë të vendimit për pranueshmëri dhe autorizimit të dhënë në të mund të zbatojnë drejtpërdrejt Kushtetutën.

78. Më pas, ka situata në të cilat, pavarësisht heshtjes së ligjvënësit, organi i legjisllacionit në fuqi siguron të gjitha elementet e nevojshme legjisllative, të cilat mundësojnë që ato rregulla të zbatohen në mënyrë të parashikueshme dhe uniforme nga gjykatat.
79. Nga ana tjetër, mund të ketë situata në të cilat, pavarësisht nga një rregull gjithëpërfshirës i cili, në parim, do të lejonte zbatimin e parashikueshëm të rregullit të sanksionuar nga vendimi i Gjykatës, një zbatim i tillë është i pamundur për aq sa parimi i ligjshmërisë kërkon që çështja në fjalë të rregullohet shprehimisht (për shembull, rregullat për kriminalizimin e veprave penale dhe përcaktimin e dënimeve). Në fund, ka raste kur organi i legjisllacionit në fuqi nuk parashikon të gjithë elementët legjisllativë të nevojshëm për zbatimin e parashikueshëm të rregullave të sanksionuara me vendimet e Gjykatës Kushtetuese për konstatimin e jokushtetutshmërisë së disa zgjidhjeve legjisllative.
80. Nëse në dy hipotezat e para nuk ka nevojë të ndërhyjë ligjvënësi në mënyrë që të sjellë rregullin statutor në përputhje me Kushtetutën, në dy hipotezat e fundit është e nevojshme ndërhyrja e ligjvënësit në mënyrë që të mund të aplikohet koncepti ligjor i konstatuar si jokushtetues. Nëse ligjvënësi refuzon ose nuk e rregullon, gjykata nuk mund ta plotësojë vakumin legjisllativ, gjykatat nuk mund të pezullojnë procedurën dhe janë të detyruara t'i trajtojnë rastet që i kanë para tyre në përputhje me kornizën ekzistuese ligjore.

(iii) Maqedonia e Veriut

81. Kur një ligj i kontestuar rezulton të jetë jokushtetues me vendim të Gjykatës Kushtetuese, dispozitat e shfuqizuara nuk janë më pjesë e rendit juridik dhe nuk mund të zbatohen më. Megjithatë, Gjykata Kushtetuese në vendimin e saj thekson arsyet e jokushtetutshmërisë së ligjit/disa dispozitave të ligjit, por nuk i jep asnjë udhëzim Kuvendit se si të korrigojë situatën në lidhje me ligjin jokushtetues. Gjykata Kushtetuese nuk mund ta ngarkojë Kuvendin e Republikës së Maqedonisë së Veriut si bartës të pushtetit legjisllativ me miratimin e ligjit apo t'i përcaktojë afate për këtë. Kuvendi, duke qenë organ ligjvënës sipas Kushtetutës, është i detyruar të respektojë Kushtetutën, ligjet që ka miratuar, por edhe vendimet e Gjykatës Kushtetuese me të cilat ka shfuqizuar ose zhvlerësuar disa ligje (apo dispozita të një ligji). Edhe në rastet kur krijohet një zbrazëti për shkak të një vendimi të Gjykatës Kushtetuese, Gjykata Kushtetuese nuk mund t'i imponojë drejtpërdrejt organit ligjvënës një detyrim për të miratuar një ligj të ri dhe as t'i tregojë Kuvendit se cila duhet të jetë përmbajtja e ligjit të ri. Prandaj, plotësimi i boshllëkut ligjor që ka ndodhur si pasojë e përfundimit të vlefshmërisë së ligjit jokushtetues është detyrë e ligjvënësit.
82. Në periudhën nga miratimi i një aktvendimi për fillimin e procedurës për vlerësimin e kushtetutshmërisë (e cila është faza e parë e vendimmarrjes kushtetuese) të ligjit që i dërgohet Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut për një mendim (me afat prej 30 ditësh për përgjigje) deri në vendimin përfundimtar për shfuqizimin e tij, Kuvendi mund të ndryshojë ligjin ose të miratojë një ligj të ri, pas të cilit Gjykata e pezullon procedurën.
83. Për të mos lejuar që ligji (për të cilin Gjykata Kushtetuese ka shprehur dyshime për kushtetutshmërinë e tij) të prodhojë pasoja juridike, Gjykata Kushtetuese zakonisht, së bashku me vendimin për fillimin e procedurës për vlerësimin e kushtetutshmërisë së ligjit, merr edhe vendim për të ashtuquajturat masa të përkohshme. Sipas nenit 27 të Rregullores së punës, Gjykata Kushtetuese në çdo fazë të procedurës deri në marrjen e vendimit përfundimtar, mund të vendosë pezullimin e ekzekutimit të akteve ose veprimtarive individuale të cilat ndërmerren në bazë të ligjit, rregullores tjetër ose një akti të përgjithshëm, kushtetutshmëria, përkatësisht ligjshmëria e të cilit është duke u vlerësuar, nëse ekzekutimi i tij mund të shkaktojë pasoja që nuk mund të eliminohen lehtë. Në raste të tilla, Gjykata Kushtetuese është e detyruar të përfundojë procedurën sa më shpejt që të jetë e mundur.

84. Në vijim, rastet e pazgjidhura pranë gjykatave të rregullta do të përfitojnë nga ligji i ri i miratuar nga Kuvendi në bazë të vendimit të Gjykatës Kushtetuese. Megjithatë, neni 18 i Ligjit për Gjykatat (i cili është neni i vetëm për vlerësimin incidental të kushtetutshmërisë) lejon gjithashtu zbatimin e drejtpërdrejtë të dispozitave të Kushtetutës. Sipas nenit 18 par. 2, nëse gjykata vlerëson se ligji që do të zbatohet në një rast të caktuar nuk është në përputhje me Kushtetutën, dhe dispozitat kushtetuese nuk mund të zbatohen drejtpërdrejt, pezullon procedurën derisa Gjykata Kushtetuese të marrë një vendim.
85. Efektet juridike të vendimeve të Gjykatës Kushtetuese në rastet e vendosura tashmë nga gjykatat e rregullta, varen nga lloji i vendimit. Kështu, vendimet për anulim kanë efekte *ex tunc*. Sipas këtij rregulli, vendime të tilla të Gjykatës kanë efekt jo vetëm në të ardhmen, por edhe në mënyrë retroaktive, pra nga momenti i miratimit të ligjit të anuluar apo rregullores tjetër. Pasojat nga zbatimi i ligjit të anuluar ose rregullores tjetër hiqen me kthimin e çështjeve në gjendjen e mëparshme, përkatësisht kushti që ka ekzistuar para miratimit të vetë ligjit, përkatësisht rregullores tjetër.
86. Në përputhje me këtë efekt juridik të vendimeve anuluese të Gjykatës Kushtetuese dhe për heqjen e pasojave nga zbatimi i ligjit apo rregullores tjetër që është anuluar, neni 81 paragrafi 1 i Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese, parashikon se kushdo që i është cenuar e drejta me vendim të formës së prerë ose në fuqi të miratuar në bazë të një ligji, rregulloreje ose akti tjetër të përgjithshëm, i cili është anuluar me vendim të Gjykatës Kushtetuese, ka të drejtë të kërkojë nga organi kompetent që ta anulojë atë akt individual, brenda 6 muajve nga data e publikimit të vendimeve të Gjykatës në Gazetën Zyrtare. Nëse pasojat nga zbatimi i ligjit, rregullores ose aktit të përgjithshëm që është anuluar me vendim të Gjykatës Kushtetuese nuk mund të hiqen me ndryshimin e aktit individual në kuptimin e paragrafit të mësipërm, Gjykata mund të gjykojë se pasojat hiqet me rikthim në gjendjen e mëparshme, me kompensim dëmi ose në ndonjë mënyrë tjetër.
87. Megjithatë, në asnjë ligj procedural të Republikës së Maqedonisë së Veriut nuk ekziston një dispozitë shprehimore se rihapja e procedurës gjyqësore mund të kërkohej edhe në rastet kur ligji në bazë të të cilit është marrë vendimi gjyqësor në fuqi, është anuluar me vendim të Gjykatës Kushtetuese. Por, mungesa e një dispozite të tillë nuk duhet të jetë pengesë që gjykata kompetente të vendosë për një kërkesë konkrete të palës për anulimin ose ndryshimin e një vendimi gjyqësor në fuqi edhe për këtë arsye, pasi vendimi anulues i Gjykatës Kushtetuese e detyron atë për këtë, duke qenë se efekti juridik i tij vlen për të gjithë (*erga omnes*), duke përfshirë edhe gjykatat e tjera. Ndryshe nga vendimet anuluese, efektet juridike të vendimeve të Gjykatës Kushtetuese që shfuqizojnë një ligj, rregullore tjetër ose akt të përgjithshëm i referohen vetëm së ardhmes, që do të thotë se ligji, rregullorja tjetër ose akti i përgjithshëm i shfuqizuar pushon të zbatohet dhe të gjenerojë efekt juridik *ex nunc* (nga shfuqizimi e në vazhdim) dhe pasojat e prodhuara tashmë mbeten.

(iv) *Gjykata Kushtetuese e Bosnjës dhe Hercegovinës*

88. Gjykata Kushtetuese ka juridiksion për çështjet e referuara nga çdo gjykatë në Bosnje dhe Hercegovinë përkitazi me nëse një ligj, nga vlefshmëria e të cilit varet vendimi i saj, është në përputhje me Kushtetutën, me Konventën Evropiane për të Drejtat dhe Liritë Themelore të Njeriut dhe Protokollet e saj, ose me ligjet e Bosnjës dhe Hercegovinës ose në lidhje me ekzistencën ose fushëveprimin e një rregulli të përgjithshëm të së drejtës ndërkombëtare publike në lidhje me vendimin e gjykatës.
89. Për sa i përket efekteve të vendimit në kërkesë, dispozita përkatëse është neni 61 i Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Bosnjës dhe Hercegovinës, që përcakton si në vijim: “(1) *Gjykata Kushtetuese në vendimin për pranimin e kërkesës vendos për efektin juridik të saj (ex tunc, ex nunc).* (2) *Në një vendim që konstaton papajtueshmërinë sipas nenit VI (3)(a) dhe VI (3)(c) të Kushtetutës, Gjykata Kushtetuese mund ta shfuqizojë*

aktin e përgjithshëm ose disa nga dispozitat e tij, plotësisht ose pjesërisht. (3) Akti i përgjithshëm i shfuqizuar ose dispozitat e shfuqizuara të tij do të shpallen të pavlefshëm të nesërmen pas datës së publikimit të vendimit në Gazetën Zyrtare të Bosnjës dhe Hercegovinës. (4) Përrjashtimisht, Gjykata Kushtetuese, me vendimin e saj që konstaton papajtueshmërinë sipas nenit VI(3)(a) dhe VI(3)(c) të Kushtetutës, mund të japë një afat për harmonizimin, i cili nuk mund të kalojë gjashtë muaj. (5) Nëse papajtueshmëria e konstatuar nuk hiqet brenda afatit të përmendur në paragrafin 4 të këtij neni, Gjykata Kushtetuese me vendim të saj do të konstatojë se dispozitat e papajtueshme janë bërë të pavlefshme. (6) Dispozitat e papajtueshme do të shfuqizohen ditën e parë pas datës së publikimit të vendimit të përmendur në paragrafin 4 të këtij neni në Gazetën Zyrtare të Bosnjës dhe Hercegovinës.”

90. Praktika gjyqësore e Gjykatës Kushtetuese të Bosnje dhe Hercegovinës konsiston në atë që vendimet e Gjykatës Kushtetuese nuk kanë fuqi prapavepruese. Gjykata Kushtetuese e vlerëson se është e padiskutueshme që legjislacioni pozitiv e lidh zbatueshmërinë e ligjeve apo akteve nënligjore apo vendimeve të gjykatave kushtetuese me momentin e publikimit të tyre në gazetën zyrtare. Në rastin konkret, nenet 40 dhe 41 të Ligjit për procedurën në Gjykatën Kushtetuese të Federatës përcaktojnë se ligji ose rregullorja tjetër e përcaktuar nga Gjykata Kushtetuese e Federatës si antikushtetuese nuk do të zbatohet nga data e publikimit të aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese në “*Gazetën Zyrtare të Federatës së BiH*”. Nisur nga sa më sipër, Gjykata Kushtetuese vlerëson se qëndrimi i Gjykatës Supreme se vendimi i Gjykatës Kushtetuese të Federatës nuk ka efekt prapaveprues nuk mund të konsiderohet arbitrar.

(v) Lihtenshtajni

91. Kur Gjykata Kushtetuese vlerëson se një ligj është jokushtetues, vendimi publikohet nga Qeveria në Gazetën Zyrtare të Lihtenshtajnit pa vonesë. Shfuqizimi i ligjit hyn ligjërisht në fuqi pas publikimit, përveç rasteve kur Gjykata Kushtetuese cakton një afat kohor maksimumi për një vit; rasti në fjalë do të përjashtohet nga kjo (neni 19(3) i Ligjit për Gjykatën Kushtetuese [StGHG]). Me fjalë të tjera, nëse Gjykata Kushtetuese cakton një afat, ligji mbetet në fuqi derisa ligjvënësi kombëtar të paraqet një ligj të ri në përputhje me Kushtetutën.
92. Rastet në pritje/të pazgjidhura që kërkojnë zbatimin e ligjit jokushtetues, si rregull, nuk pezullohen deri në miratimin e një ligji të ri. Duke qenë se në rast të një afati kohor të caktuar nga Gjykata Kushtetuese, ligji vazhdon të jetë në fuqi, ai zbatohet nga gjykatat e rregullta. Rastet e vendosura tashmë nga gjykatat e rregullta nuk i nënshtrohen një shqyrtimit të ri gjyqësor.

(vi) Holanda

93. Para së gjithash, situata në Holandë është paksa e ndryshme nga ajo në shumicën e vendeve të tjera evropiane. Neni 120 i Kushtetutës i ndalon gjyqtarët (çdo gjyqtar, Holanda nuk ka gjykatë kushtetuese) të vlerësojnë kushtetutshmërinë e një ligji që është miratuar nga parlamenti (akti parlamentar). Një situatë e vlerësimit të kushtetutshmërisë së një akti parlamentar, nuk ndodhë në Holandë.
94. Gjyqtarët në Holandë, nga ana tjetër, mund të vlerësojnë kushtetutshmërinë e llojeve më të ulëta të legjislacionit, siç janë dekretet qeveritare ose ministrore dhe legjislacionin e nivelit lokal. Përveç kësaj, gjyqtarët mund të vlerësojnë përputhshmërinë e të gjitha llojeve të legjislacionit, duke përfshirë ligjet parlamentare, me legjislacionin e BE-së dhe traktatet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut.
95. Megjithatë, edhe në rastet kur një gjyqtar arrin në përfundimin se një ligj shkel legjislacionin e BE-së ose një traktat ndërkombëtar të të drejtave të njeriut, ai nuk lejohet

të urdhërojnë ligjvënësin të ndërmarrë ndonjë veprim ose t'i japë atij një afat kohor brenda të cilit duhet të rregullojë shkeljen (shih rastin: ECLI:NL:HR:2003:AE8462). Gjithçka që një gjyqtar mund të bëjë është të arrijë në përfundimin se një dispozitë ligjore shkel legjislacionin e BE-së ose një traktat ndërkombëtar për të drejtat e njeriut. Ai nuk mund të thotë asgjë se çfarë duhet të bëjë ligjvënësi për këtë. Në një rast të jashtëzakonshëm, gjykata supreme ka paralajmëruar se, nëse ligjvënësi nuk rregullon një papajtueshmëri të njohur '*në kohë*' (gjykata nuk jep një afat kohor të caktuar), një gjyqtar mund të lejohet ta zgjidhë vetë çështjen (shih rastin: ECLI:NL:HR:1999:AA2756).

96. Në përgjithësi, në sistemin holandez supozohet se i takon ligjvënësit të vendosë nëse, kur dhe si do të ndryshojë një ligj jokushtetues. Ligji ekzistues qëndron në fuqi derisa ligjvënësi të bëjë ndryshime dhe ende mund të zbatohet në raste të tjera. Arsyeja pas kësaj është se i takon ligjvënësve të zgjedhur në mënyrë demokratike dhe jo gjyqësorit të bëjë zgjedhjet politike. Ky '*mandat i ligjvënësit*' është mjaft i fortë në Holandë dhe ka pasoja të mëdha për rolin e gjyqtarëve kur bëhet fjalë për vlerësimin e kushtetutshmërisë së akteve parlamentare ose përputhshmërisë së tyre me ligjin më të lartë.
97. Gjykatat në Holandë nuk e pezullojnë vendimmarrjen në rastet aktive derisa ligjvënësi kombëtar të ketë ndryshuar dispozitën jokushtetuese ose në kontekstin holandez, një dispozitë që është deklaruar se shkel legjislacionin e BE-së ose një traktat ndërkombëtar për të drejtat e njeriut. Siç u përmend më lart, gjyqtarët në Holandë nuk mund të urdhërojnë ligjvënësin të ndryshojë legjislacionin, kështu që nuk do të kishte kuptim të presim për rezultatin e kësaj. Gjykatat më të ulëta në përgjithësi do të ndiqnin gjykatat më të larta në aktgjykimet e tyre, që do të thotë se normalisht se do të ndiqeshin precedentët e mundshëm të vendosur në lidhje me papajtueshmërinë e zbatimit të një dispozite ligjore me ligjin më të lartë.

(vii) *Gjykata Kushtetuese e Letonisë*

98. Gjykata Kushtetuese e Letonisë ka theksuar se kur një dispozitë ligjore shpallet jokushtetuese atëherë konsiderohet se e njëjta nuk është në fuqi nga dita e shpalljes së aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese, përveç rasteve ku Gjykata Kushtetuese vendos ndryshe. Gjykata Kushtetuese e Letonisë zakonisht i akordon kohë ligjvënësit për të rregulluar sistemin ligjor, për shembull, duke ndryshuar dispozitën që është shpallur jokushtetuese. Normalisht gjatë kësaj periudhe të ndërmjetme: (i) dispozita jokushtetuese vazhdon të jetë në fuqi dhe e zbatueshme si më parë; ose, (ii) Gjykata përfshin udhëzime specifike në lidhje me zbatimin e dispozitës jokushtetuese, zakonisht duke treguar se në periudhën e ndërmjetme dispozita jokushtetuese duhet të zbatohet në përputhje me vendimin e Gjykatës Kushtetuese.
99. Në parim, të gjitha rastet që janë gjykuar para se Gjykata Kushtetuese ta shpallë dispozitën jokushtetuese, do të mbeten të paprekura pra nuk do të rihapen. Përgjigja në këtë pyetje varet nga efekti kohor i vendimit të Gjykatës Kushtetuese. Mirëpo, nëse aktgjykimi i Gjykatës Kushtetuese ka efekt prapaveprues, atëherë të tri ligjet procedurale (civil, penal dhe administrativ), parashikojnë mundësinë për të kërkuar rihapjen e procedurës duke pasur parasysh se dispozita është shpallur jokushtetuese.
100. Për rastet ku Gjykata Kushtetuese ka dijeni për çështje në pritje, në të cilat do të zbatohet dispozita jokushtetuese, i jep efekt prapaveprues aktgjykimit të pavlefshmërisë së dispozitës jokushtetuese në lidhje me "*ata persona që tashmë kanë filluar mbrojtjen e të drejtave të tyre me mjete të zakonshme juridike dhe ndaj të cilëve është zbatuar norma kontestuese*". Kjo nënkupton se pavlefshmëria shtrihet në rastet e pazgjidhura e që janë në pritje për të cilat Gjykata Kushtetuese ka dijeni, por edhe në rastet për të cilat ajo nuk ka dijeni.

(viii) *Gjykata Kushtetuese e Bullgarisë*

101. Gjykata Kushtetuese e Bullgarisë thekson se dispozita ligjore që shpallet jokushtetuese nuk zbatohet mirëpo Parlamenti është autoriteti i vetëm kompetent që mund ta anulojë apo ndryshojë dispozitën ligjore të shpallur jokushtetuese nga Gjykata Kushtetuese. Të gjitha rastet që janë në pritje dhe akoma të pazgjidhura, pezullohen dhe në fund vendosen në përputhje me vendimin e Gjykatës Kushtetuese çka nënkupton se dispozita ligjore jokushtetuese nuk zbatohet. Në rastet ku Gjykata Kushtetuese e shpallë jokushtetues një dispozitë ligjore, i takon ligjvënësit të nxjerrë një ligj të ri dhe ai nuk kufizohet me një kornizë kohore apo afat. Gjykata Kushtetuese thekson se Gjykata Supreme e Kasacionit se vendimi i Gjykatës Kushtetuese me të cilin një dispozitë ligjore shpallet jokushtetuese nuk mund të konsiderohet si bazë për anulimin e një vendimi të ekzekutueshëm.

(ix) *Tribunali Kushtetues i Polonisë*

102. Tribunali Kushtetues i Polonisë thekson se aktgjykimet e tyre hyjnë në fuqi nga dita e publikimit mirëpo mund të specifikohet ndonjë datë tjetër për shfuqizim të dispozitës ligjore të shpallur jokushtetuese. Periudha që Tribunali Kushtetues e cakton për shfuqizimin e dispozitës ligjore jokushtetuese nuk mund të jetë më e gjatë se 12 ose 18 muaj. Po ashtu në rastet kur shfuqizimi i një dispozite ligjore ka implikime financiare, Tribunali Kushtetues cakton datën e shfuqizimit të dispozitës jokushtetuese pas pranimi të mendimit të Këshillit të Ministrave. Shtyrja e afatit për shfuqizim të dispozitës ligjore jokushtetuese bëhet për t'i dhënë ligjvënësit kohën e nevojshme për nxjerrjen e ligjit të ri dhe për të shmangur '*hendekun legjislativ*'.
103. Bazuar në jurisprudencën e Tribunalit Kushtetues dispozita ligjore jokushtetuese mbetet e detyrueshme derisa ligjvënësi ta nxjerrë ligjin e ri, megjithatë, në disa raste Tribunali Kushtetues sqaron se përderisa dispozita ligjore jokushtetuese mbetet e detyrueshme, gjykatat e rregullta duhet pasur parasysh se dispozitës ligjore të shpallur jokushtetuese i mungon prezumimi i kushtetutshmërisë. Pas përfundimit të procedurës pranë Tribunalit Kushtetues, gjykatat e rregullta mbështeten në arsyetimin e dhënë nga Tribunali Kushtetues sidomos lidhur me efektet e aktgjykimit. Tribunali Kushtetues thekson se në disa raste individët e interesuar mund të paraqesin ankesë për ri-hapje të procedurës për shkak se rasti i tyre është vendosur bazuar në dispozitën ligjore jokushtetuese, mirëpo, në praktikë nuk lejohet ri-hapja e procedurave për shkak se ato dispozita veçse janë zbatuar.

(x) *Gjykata Kushtetuese e Sllovakisë*

104. Gjykata Kushtetuese e Sllovakisë thekson se kur një dispozitë ligjore shpallet jokushtetuese atëherë i takon organit që ka nxjerrë dispozitën jokushtetuese që të njëjtën ta harmonizojë me Kushtetutën brenda gjashtë (6) muajve nga shpallja e aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese. Nëse organit që i takon ta harmonizojë dispozitën jokushtetuese me Kushtetutë nuk e kryen këtë veprim brenda gjashtë muajve atëherë dispozita jokushtetuese e humb vlefshmërinë e saj pas afatit në fjalë.
105. Në praktikë, gjykatat e rregullta zbatojnë dispozitat ligjore që kontestohen dhe që janë në pritje të vlerësimit të kushtetutshmërisë së tyre nga Gjykata Kushtetuese. Efektet e vendimeve të Gjykatës Kushtetuese janë të detyrueshme për të gjithë dhe kryesisht kanë efekt në të ardhmen (*ex nunc*) me përjashtim të rasteve penale kurse procedurat e vendosura nga lëmi civil dhe administrativ nuk ri-hapen.

(xi) *Gjykata Kushtetuese e Kroacisë*

106. Gjykata Kushtetuese e Kroacisë thekson se afati që i akordohet ligjvënësit për ta nxjerrë një ligj të ri në përputhje me Kushtetutën varion nga disa muaj në një vit ose dy duke pasur parasysh kompleksitetin e çështjeve të trajtuara dhe sa dispozita ligjore janë shfuqizuar.

Efektet e vendimeve të Gjykatës Kushtetuese shtrihen në të ardhmen (*ex nunc*). Për sa i përket afatit kohor ligji i shfuqizuar ose një rregullore tjetër (dhe kjo mund të jetë një akt nënligjor në gjuhën kroate “*drugi odnosno podzakonski propis*”), ose dispozita të veçanta të tyre të shfuqizuara, humbë fuqinë ligjore ditën e publikimit të vendimit të Gjykatës Kushtetuese në Gazetën Zyrtare, përveç rasteve kur Gjykata Kushtetuese cakton një afat tjetër. Gjykata Kushtetuese në dispozitivin e vendimit të saj përcakton datën e saktë kur ligji i shfuqizuar skadon.

107. Po ashtu, Gjykata Kushtetuese vendos që me hyrjen në fuqi të një ligji të ri (përkatësisht të atij që duhet ta miratojë Kuvendi në vend të atij të shfuqizuar) ligji i shfuqizuar do të skadojë. Rastet e vendosura nga gjykatat e rregullta bazuar në dispozitën ligjore të shpallur jokushtetuese nga Gjykata Kushtetuese mund të rihapen nëse plotësohen kërkesat e parashikuara me Ligjin për Gjykatën Kushtetuese brenda një afati prej gjashtë muajsh nga dita e publikimit të vendimit të Gjykatës Kushtetuese në Gazetën Zyrtare. Gjykata referuese në procedurën e kontrollit incidental, pezullon procedurën dhe parashton kërkesë në Gjykatën Kushtetuese për të vlerësuar kushtetutshmërinë e ligjit ose të disa dispozitave të tij.

(xii) *Gjykata Supreme Administrative e Suedisë*

108. Në Suedi nuk ka Gjykatë Kushtetuese. Funkcionet e një gjykate të tillë kryhen nga Gjykata Supreme dhe Gjykata Supreme Administrative, por Gjykata Supreme Administrative nuk ka juridiksion që të shpallë ndonjë normë jokushtetuese.
109. Megjithatë, nëse një gjykatë suedeze, në një rast individual, konsideron se një dispozitë bie ndesh me dispozitën e një ligji themelor ose me një dispozitë të ndonjë statuti tjetër superior, ose se procedura e përshkruar është injoruar në ndonjë aspekt të rëndësishëm kur është inauguruar dispozita, atëherë një dispozitë e tillë nuk mund të aplikohet.

(xiii) *Gjykata Kushtetuese e Afrikës Jugore*

110. Për sa i përket pyetjes së parë, Gjykata Kushtetuese e Afrikës Jugore është përgjigjur si në vijim: “*Pika e nisjes është neni 172(2)(a) i Kushtetutës së Republikës së Afrikës së Jugut (Kushtetuta). Në kuptim të kësaj dispozite, kur një Akt i Parlamentit ose një akt krahinor shpallet jokushtetues nga Gjykata Supreme e Apelit, Gjykatat e Larta ose gjykatat me status të ngjashëm (gjykatat e ulëta), urdhri nuk do të ketë fuqi nëse nuk konfirmohet nga Gjykata Kushtetuese e Republikës së Afrikës së Jugut (Gjykata Kushtetuese). Prandaj, është Gjykata Kushtetuese ajo që bën përcaktimin përfundimtar në lidhje me kushtetutshmërinë e një dispozite të kontestuar*”.
111. Gjykata Kushtetuese e Afrikës Jugore në vijim thekson se periudha që i është dhënë legjislativit për të ndryshuar legjislacionin e kontestuar ka lëvizur nga 6 deri në 24 muaj. Megjithatë, kompetenca e Gjykatës për të nxjerrë një urdhër që është i drejtë dhe i paanshëm është mjaft e gjerë dhe përfshin kompetencën për t'i rezervuar vetes kompetencën për të rishqyrtuar periudhën e pezullimit që e ka dhënë më parë dhe madje për të zgatur periudhën e pezullimit (shih, rastin e Gjykatës Kushtetuese të Afrikës së Jugut, *Zondi kundër MEC për Çështjet e Pushtetit Tradicional dhe Lokal* [2005] ZACC 18; 2006 (3) SA 1 (CC); 2006 (3) BCLR 423 (CC) paragrafi 51).
112. Prandaj, sipas Gjykatës Kushtetuese të Afrikës së Jugut ka një sërë konsideratash që Gjykata merr parasysh kur përcakton periudhën e pezullimit. Të gjitha konsideratat i nënshtrohen diskrecionit që ushtrohet në një mënyrë të drejtë dhe të barabartë.
113. Në rastin *SAMWU*, Gjykata në lidhje me nenin 172(1)(b) të Kushtetutës vendosi sa vijon: “*Formulimi i nenit 172(1)(b) bën të qarta dy pika të rëndësishme. E para është se në kuadrin e një urdhri të pavlefshmërisë kushtetuese, pezullimi i urdhrit nuk zbatohet*

automatikusht. Deklarata e pavlefshmërisë e bën legjislacionin e kontestuar menjëherë të pavlefshëm me efekt retrospektiv. Kjo për shkak se është e padëshirueshme që një dispozitë e pavlefshme kushtetuese të mbetet në fuqi pasi një gjykatë ka konstatuar se nuk është në përputhje me Kushtetutën. E dyta është se, pasi një Akt është konstatuar se është i pavlefshëm nga pikëpamja kushtetuese, pavlefshmëria e tij funksionon në mënyrë retrospektive, përveç rastit kur gjykata konstaton se do të ishte e drejtë dhe e paanshme të kufizohet efekti i tij retrospektiv.” (shih rastin e Gjykatës Kushtetuese të Afrikës Jugore: *SAMWU*, cituar më lartë).

114. Në kontekst të sqarimeve të dhëna, Gjykata Kushtetuese e Afrikës Jugore, në ndërlidhje të nenit 172(1)(b), efekti retrospektiv i një ligji që është shpallur jokushtetues mund të kufizohet nga Gjykata. Në rastin *Zuma* (shih rastin e Gjykatës Kushtetuese të Afrikës Jugore: *S kundër Zuma* [1995] ZACC 1; 1995 (1) SACR 568 (CC); 1995 (4) BCLR 401 (CC)) Gjykata shpalli jokushtetues nenin 217(1)(b)(ii) të Ligjit të Procedurës Penale, dispozitat e të cilave supozojnë, përveçse kur vërtetohet e kundërta, se një rrëfim i bërë nga i akuzuari është bërë lirisht dhe vullnetarisht.
115. Në këtë rast, Gjykata konstatoi se megjithëse zbatimi i dispozitës së kontestuar që nga 27 prilli 1994 mund të kishte shkaktuar padrejtësi ndaj personave të akuzuar, ajo nuk mund të riparonte të gjithë padrejtësitë e kaluara. Efekti i urdhrit ishte se në ato gjykime që filluan më 27 prill 1994 ose pas dhe që nuk përfunduan deri në datën e urdhrit, kërkohej një rishqyrtim i pranueshmërisë së rrëfimeve të pranuara tashmë, duke përfshirë shqyrtimin e provave të mëtejshme (shih rastin e Gjykatës Kushtetuese të Afrikës Jugore: *Zuma*, cituar më lartë, paragrafi 44). Prandaj, Gjykata kufizoi efektin retrospektiv të urdhrit të pavlefshmërisë, por në lidhje me çështjet në pritje përpara Gjykatave të Larta (në varësi të kushteve të urdhrit), pranimet e bëra nga një person i akuzuar duhej të rishqyrtoheshin, në përputhje me atë urdhër.
116. Në rastin *Cross-Border* (shih rastin e Gjykatës Kushtetuese të Afrikës Jugore, *Agjencia e Transportit Rrugor Ndërkufitar kundër Shërbimeve Rrugore të Afrikës Qendrore* (Pty) Ltd[2015] ZACC 12; 2015 (5) SA 370 (CC); 2015 (7) BCLR 761 (CC) më 31 mars 2011, Ministri i Transportit shpalli rregulloret e amendamentuara në kuptim të nenit 51 të Ligjit për Transportin Rrugor Ndërkufitar. Këto rregullore rritën me një shumë të konsiderueshme tarifat e lejeve që paguheshin nga operatorët e transportit rrugor ndërkufitar. Pas një aplikimi në Gjykatën e Lartë, më 15 shkurt 2013, rregulloret u shpallën jokushtetuese. Shpallja e pavlefshmërisë kushtetuese u pezullua për një periudhë gjashtëmujore për t'i mundësuar ministrit ripublikimin e rregulloreve.
117. Ministri nuk arriti të shpallte rregullore të vlefshme brenda periudhës së pezullimit, dhe gjithashtu nuk bëri një kërkesë për zgjatjen e periudhës gjashtëmujore. Ishte arsye e zakonshme që urdhri i pavlefshmërisë hyri në veprim në mesnatën e 14 gushtit 2013, pas skadimit të periudhës gjashtëmujore, por palët kundërshtuan nëse urdhri funksiononte në mënyrë retrospektive që nga data e shpalljes së rregulloreve, 31 mars 2011, ose në mënyrë perspektive nga 15 gushti 2013 (shih rastin e Gjykatës Kushtetuese të Afrikës Jugore *Cross Border*, cituar më lartë, paragrafi 5).
118. Në këtë rast, Gjykata përsëriti parimet e mëposhtme:
 - (a) Një ligj që është konstatuar se nuk është në përputhje me Kushtetutën, pushon të ketë pasoja juridike (paragrafi 13).
 - (b) Nëse korrigjohet jokushtetutshmëria, deklarimi bie dhe ajo që është bërë në kuptim të ligjit i jepet vlefshmëri. Nëse jo, shpallja e pavlefshmërisë bëhet në skadimin e afatit të caktuar dhe rrjedhin pasojat normale që i bashkëngjiten një deklarate të tillë. Kjo do të thotë se ligji i kontestuar dhe gjithçka e bërë sipas tij do të shfuqizohet (paragrafi 17). (Theks i shtuar.)

- (c) Kur Kushtetuta hyri në fuqi kishte shumë ligje të vjetra në librin e statutit të cilat nuk ishin në përputhje me Kushtetutën. Nëse të gjitha ato do të ishin hedhur poshtë dhe të gjitha veprimet e ndërmarra sipas tyre do të shpalleshin të pavlefshme, do të kishte pasur një vakum legjislativ dhe kushte kaotike (paragrafi 19).
- (d) Pasojat që rrjedhin zakonisht nga një shpallje e pavlefshmërisë kushtetuese përfshijnë që ligji do të jetë i pavlefshëm që nga momenti i shpalljes së tij. Kjo do të thotë, urdhri do të ketë efekt të menjëhershëm retrospektiv. Ky është pozicioni i paracaktuar (paragrafi 20). Megjithatë, ky pozicion i paracaktuar mund të ndryshohet me një urdhër gjykatë, duke ushtruar kompetencën e shprehur sipas nenit 172(1)(b)(i) të Kushtetutës. Vetëm një urdhër i gjykatës mund të ndryshojë pasojat që rrjedhin nga doktrina e pavlefshmërisë kushtetuese. (Theks i shtuar.)
119. Pas shqyrtimit të parimeve të sipërpërmendura, Gjykata Kushtetuese konstatoi se për shkak se urdhri dhe vendimi i Gjykatës së Lartë që shpalli të pavlefshme rregulloret heshti lidhur çështjen e kufizimit të efektit retrospektiv të deklaratës, deklarimi i pavlefshmërisë kushtetuese ishte retrospektivisht i pavlefshëm nga datën e shpalljes së rregulloreve.
120. Kur një urdhër i pavlefshmërisë kushtetuese është pezulluar, shpallja e pavlefshmërisë do të hyjë në fuqi në momentin e skadimit të pezullimit (shih rastin e Gjykatës Kushtetuese të Afrikës Jugore: *Ex parte Ministër i Zhvillimit Social* [2006] ZACC 3; 2006 (4) SA 309 (CC); 2006 (5) BCLR 604 (CC). Kjo do të thotë se deri në skadimin e periudhës së pezullimit, ose derisa të korrigohet mangësia kushtetuese, ligji i kontestuar do të vazhdojë të zbatohet gjatë periudhës së pezullimit, përveç rasteve kur në urdhër parashikohet ndryshe.
121. Në vijim, Gjykata Kushtetuese e Afrikës Jugore theksoi që çështjet e pazgjidhura para gjykatave do të përfitojnë nga legjislacioni i ndryshuar vetëm nëse urdhri i pavlefshmërisë kushtetuese ose legjislacioni i ri parashikon që çështje të tilla të vendosen në përputhje me legjislacionin e ri, edhe nëse çështja ka qenë para gjykatave para miratimit të legjislacionit të ndryshuar.
122. Në rastin *Dykema*, (shih rastin e Gjykatës Kushtetuese të Afrikës Jugore: *Dykema kundër Malebane* [2019] ZACC 33; [2019] JOL 45686 (CC); 2019 (11) BCLR 1299 (CC), Gjykata Kushtetuese kishte shpallur më parë kapitujt V dhe VI të Ligjit për Lehtësimin e Zhvillimit (DFA) si jokushtetuese. Shpallja e pavlefshmërisë u pezullua për 24 muaj për t'i lënë Parlamentit kohë për të korrigjuar mangësitë. Deklarata e pavlefshmërisë do të skadonte më 17 qershor 2012. Deri atëherë, Tribunalet e Zhvillimit Provincial të krijuara nën DFA mund të vazhdonin të pranonin kërkesa të reja dhe të vendosnin për kërkesat në pritje (shih rastin e Gjykatës Kushtetuese të Afrikës Jugore: *Dykema kundër Malebane*, cituar më lartë, paragrafët 7 dhe 8).
123. Në rrethanat e rastit konkret, deri më 17 qershor 2012, Parlamenti nuk kishte miratuar asnjë legjislacion përmirësues. Një projektligj, i cili në fund u miratua si Ligj për Planifikimin Hapësinor dhe Menaxhimin e Përdorimit të Tokës (SPLUMA), ishte në zhvillim e sipër. SPLUMA hyri në fuqi më 1 korrik 2015, kështu që midis 17 qershorit 2012 dhe 1 korrikut 2015 ekzistonte një vakum ligjor (shih rastin e Gjykatës Kushtetuese të Afrikës Jugore: *Dykema kundër Malebane*, cituar më lartë, paragrafët 12, 15 dhe 17).
124. Në shkurt 2012, parashtruesi parashitroi një kërkesë në një Tribunal për leje planifikimi sipas Kapitullit V të DFA. Gjykata nxori vendimin e saj për miratimin e kërkesës së tij më 1 nëntor 2012. Komuna refuzoi të zbatonte vendimin, me arsyetimin se vendimi i Tribunalit ishte i pavlefshëm sepse pas datës 17 qershor 2012 (kur i erdhi fundi pezullimit të shpalljes së pavlefshmërisë) ai nuk kishte fuqi të mëtejshme vendimmarrëse (shih rastin e Gjykatës Kushtetuese të Afrikës Jugore: *Dykema kundër Malebane*, cituar më lartë, paragrafi 22).

125. Gjykata Kushtetuese konstatoi se arsyetimi i ruajtjes së të drejtave të pezullimit dhe imperativi kushtetues i legjislacionit përmirësues mbështesin pikëpamjen se kërkesat e paraqitura, por të pa përfunduara, para datës 17 qershor 2012 mbetën të vlefshme si kërkesa në pritje kur mbaroi periudha e pezullimit. Ajo konstatoi se nuk kishte asnjë pengesë që kërkesa e parashtresit të ishte ajo që ishte “*në pritje*” për t’u vazhduar dhe në dispozicion në kuptim të SPLUMA para një autoriteti tjetër kompetent që nuk ishte Tribunali (shih rastin e Gjykatës Kushtetuese të Afrikës Jugore: *Dykema kundër Malebane*, cituar më lartë, paragrafi 49).
126. Arsyetimi për pezullimin e shpalljes së pavlefshmërisë është shmangia e ndërprerjeve apo zhvendosjeve serioze në administratën shtetërore që do të pasonin nëse urdhri i pavlefshmërisë do të hynte në fuqi menjëherë dhe për të parandaluar paragjykimet. Prandaj, me ndryshimin e legjislacionit të kontestuar dhe miratimin e legjislacionit të ri, rrjedh që, në varësi të urdhrit të Gjykatës, ata me raste në pritje duhet të përfitojnë nga legjislacioni i ri.
127. Gjykata Kushtetuese e Afrikës Jugore deklaroi që Gjykatat më të ulëta nuk i pezullojnë kompetencat e tyre vendimmarrëse për rastet që presin para tyre, pas një deklarimi të një urdhri të pavlefshmërisë kushtetuese.
128. Kur urdhri ofron masë të përkohshme ndërkohë që ligji i kontestuar ndryshohet nga Parlamenti, siç ishte rasti në *Ramahovhi*, çështjet që janë në pritje përpara gjykatave më të ulëta do të vendosen në përputhje me mjetin e përkohshëm të parashikuar në urdhër.
129. Kur shpallja e pavlefshmërisë kushtetuese pezullohet, por nuk parashikohet një mjet i përkohshëm, ligji i pavlefshëm vazhdon të veprojë me fuqi dhe efekt të plotë siç ishte rasti në *Dykema*. Megjithatë, është e rëndësishme të theksohet se neni 172(1)(b) autorizon një gjykatë të vendosë çfarëdo kushti që e konsideron të nevojshëm për të rregulluar marrëveshjen e përkohshme që të lejojë një ligj të pavlefshëm të vazhdojë të zbatohet ndërkohë që autoriteti kompetent korrigjon mangësitë.
130. Si rregull i përgjithshëm, në kuptim të nenit 172(1)(b) të Kushtetutës, një shpallje e pavlefshmërisë e bën legjislacionin e kontestuar të pavlefshëm menjëherë me efekt retrospektiv. Megjithatë, një gjykatë ka kompetencën të kufizojë efektin retrospektiv të urdhrit nëse konstaton se është e drejtë dhe e paanshme që ta bëjë këtë, dhe të pezullojë shpalljen e pavlefshmërisë për ndonjë periudhë dhe me çfarëdo kushti, për t’ia mundësuar autoritetit kompetent korrigjimin e mangësisë.
131. Në fund, Gjykata vë theks në atë se Gjykata Kushtetuese e Afrikës Jugore thekson që ligji i kontestuar është diskriminues sepse nuk merr parasysh se sipas ligjeve diskriminuese të ish-Jugosllavisë gjatë viteve 1990, shumica e punonjësve shqipfolës u “përfjashtuan” nga punësimi në shërbimin publik.

Dispozitat përkatëse Kushtetuese dhe Ligjore

Kushtetuta e Republikës së Kosovës

Neni 24 [Barazia para Ligjit]

1. Të gjithë janë të barabartë para ligjit. Çdokush gëzon të drejtën e mbrojtjes së barabartë ligjore, pa diskriminim.

Neni 46 [Mbrojtja e Pronës]

*1. E drejta e pronës është e garantuar.
2. Shfrytëzimi i pronës rregullohet me ligj, në pajtim me interesin publik.*

3. Askush nuk do të privohet në mënyrë arbitrare nga prona. Republika e Kosovës ose autoriteti publik i Republikës së Kosovës mund të bëjë ekspropriimin e pronës nëse ky ekspropriim është i autorizuar me ligj, është i nevojshëm ose i përshtatshëm për arritjen e qëllimit publik ose përkrahjen e interesit publik, dhe pasohet me sigurimin e kompensimit të menjëhershëm dhe adekuat për personin ose personat prona e të cilave ekspropriohehet.

4. Kontestet që lindin nga akti i Republikës së Kosovës ose autoritetit publik të Republikës së Kosovës për të cilat pretendohet se përbëjnë ekspropriimin, do të zgjidhen nga gjykata kompetente.

5. Prona intelektuale mbrohet me ligj.

Protokolli Nr. 1 i KEDNJ-së Neni 1 Mbrojtja e Pronës

Çdo person fizik ose juridik ka të drejtën e gëzimit paqësor të pasurisë së tij. Askush nuk mund të privohet nga prona e tij, përveçse për arsye të interesit publik dhe në kushtet e parashikuara nga ligji dhe nga parimet e përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare.

Ligji për Sigurimin Pensional dhe Invalidor nr. 011-34/83 (Gazeta Zyrtare e KSAK nr.26/83)

Neni 1 [Pa titull]

Me këtë ligj më hollësisht rregullohen të drejtat themelore nga sigurimi pensional e invalidor në përputhje me Ligjin mbi të drejtat themelore nga sigurimi pensional e invalidor ("Gazeta zyrtare e RSFJ-së" nr. 23/82 dhe 77/82, në tekstin e mëtejshëm: Ligji mbi të drejtat themelore) dhe rregullohen edhe të drejtat tjera themelore nga sigurimi pensional e invalidor.

Ligji për të drejtat themelore të sigurimit pensional dhe invalidor (Shpallur në "Gazetën Zyrtare të RSFJ-së", nr. 23/82, 77/82, 75/85, 8/87, 65/87, 87/89, 44/90, 41/94)

III. FITIMI DHE KRIJIMI I TË DREJTAVE Pensioni i pleqërisë Neni 21

Punonjësi nga neni 18 deri 20 të këtij Ligji (në tekstin e mëtejshëm: i siguruari) fiton të drejtën për pensionin e pleqërisë kur mbush 60 vjet (mashkull), respektivisht 55 vjet (femër) të jetës dhe 20 vjet të stazhit të pensionit.

I siguruari i cili nuk ka arritur stazhin e pensionit prej 20 vitesh e fiton të drejtën në pensionin e pleqërisë kur mbush 65 vjet (mashkull), respektivisht 60 vjet (femër) të jetës **dhe së paku 15 vjet të stazhit të sigurimit.**

I siguruari e fiton të drejtën për pensionin e pleqërisë kur mbush 40 vjet (mashkull), respektivisht 35 vjet të stazhit të pensionit (femër), pavarësisht nga vitet e jetës.

Dispozitat e Ligjit të Kontestuar (Ligjit Nr. 04/L-131 për Skemat Pensionale të Financuara nga shteti)

Neni 8 Kushtet dhe kriteret për njohjen e të drejtës në pension kontributpagues të moshës

1. Të drejtën në pension kontributpagues të moshës e realizojnë të gjithë personat të cilët kanë shtetësi të Kosovës dhe të cilët:

1.1. kanë mbushur moshën gjashtëdhjetë e pesë (65) vjeçare;

1.2. duhet të ketë stazh pensional kontributdhënës, sipas Ligjit për Sigurimin Pensional dhe Invalidor nr. 011-24/83 (Gazeta Zyrtare e KSAK nr.26/83) para datës 01.01.1999;

1.3. ofrojnë dëshmi të vlefshme mbi pagesën e kontributeve sipas dispozitave të Ligjit për Sigurimin Pensional dhe Invalidor nr.011-24/83 (Gazeta Zyrtare e KSAK nr.26/83) para datës 01.01.1999.

2. Kategorizimi i shfrytëzuesve të pensionit kontributdhënës, sipas kohëzgjatjes së pagesës së kontributit sipas strukturës kualifikuese dhe kritereve tjera, përcaktohet me akt nënligjor, të cilin do ta miratoj ministria përkatëse.

[...]

6. Me këtë ligj u njihet stazhi i punës për pension kontributdhënës për vitet 1989-1999 punëtorëve të arsimit, të shëndetësisë dhe të tjerëve që kanë punuar në sistemin e Republikës së Kosovës.

Dispozitat e Udhëzimit Administrativ të kontestuar (Udhëzimi Administrativ (MPMS) Nr. 09/2015 për Kategorizimin e Shfrytëzuesve të Pensionit Kontributpagues sipas strukturës kualifikuese dhe kohëzgjatjes së pagesës së Kontributeve – Stazhit Pensional)

Neni 5

Kualifikimi i shfrytëzuesve të pensionit kontributpagues

1. Shfrytëzuesi i pensionit kontributpagues me përgatitje shkollore të ultë, konsiderohet i siguruari ose pensionisti kontributpagues, pa ose me përgatitje shkollore të ultë.
2. Shfrytëzuesi i pensionit kontributpagues me përgatitje shkollore të mesme, konsiderohet pensionisti, përkatësisht i siguruari i cili ka të kryer shkollën e mesme.
3. Shfrytëzuesi i pensionit kontributpagues me përgatitje shkollore të lartë, konsiderohet pensionisti përkatësisht i siguruari i cili e ka të kryer shkollimin e lartë.
4. Shfrytëzuesi i pensionit kontributpagues me përgatitje shkollore superiore, konsiderohet pensionisti, përkatësisht i siguruari i cili e ka të kryer fakultetin apo studimet pasuniversitare.
5. Të gjitha dëshmitë për kualifikim, të përcaktuara nga paragrafët 2, 3 dhe 4 të këtij neni, duhet të jenë para vitit 01.01.1991.

Neni 6

Dokumentet e nevojshme për njohjen e të drejtës në pension kontributpagues

1. Të gjithë shfrytëzuesit e pensionit kontributpagues, përkatësisht të sigruarit me rastin e parashtrimi të kërkesës për pension kontributpagues, bazuar në kategorizimin sipas strukturës kualifikuese, duhet të sjellin dëshmitë relevante të përcaktuara në nenin 4 dhe 5 të këtij Udhëzimi, varësisht se për cilën kategori aplikojnë.

2. Përveç kushteve të përgjithshme të përcaktuara në dispozitat e Ligjit në fuqi për Skemat Pensionale të Financuara nga Shteti, shfrytëzuesit aktual dhe ata që aplikojnë në të ardhmen, duhet të paraqesin dokumentet e nevojshme, si:

2.1 Letërnjoftimin e Republikës së Kosovës;

2.2 Ekstraktin e Lindjes;

2.3 **Të kenë stazh pensional kontributdhënës së paku pesëmbëdhjetë (15) vjet para datës 01.01.1999, sipas Ligjit të SPI-së të Kosovës, nr.26/83, i cili vërtetohet me ndonjë nga këto dokumente, si:**

2.3.1 vendimin se ka qenë shfrytëzues i pensionit kontributpagues sipas dispozitave të Ligjit të SPI-së Nr. 26/83, para datës 01.01.1999;

2.3.2 çekun për pagesën e pensionit kontributiv sipas dispozitave të Ligjit të SPI-së të Kosovës;

2.3.3 librezën e punës me numrin amëz të të siguruarit;

2.3.4 dëshminë se i ka paguar kontributet vet ose punëdhënësi ku ka punuar;

2.3.5 ekstraktin nga M-4, nëse i posedojnë zyrat pensionale, të cilat nxirren, verifikohen dhe plotësohen nga zyrtari për verifikim i stazhit pensional në formularin përkatës;

2.3.6 dëshmi se nuk është përfitues i pensionit nga ndonjë prej shteteve për të cilat Kosova nuk ka marrëveshje;

LIGJI NR. 06/L-073 PËR STATUSIN E PUNËTORËVE TË ARSIMIT SHQIP TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS NGA VITI SHKOLLOR 1990/91 DERI NË VITIN SHKOLLOR 1998/99

Neni 1 [Qëllimi]

Qëllimi i këtij Ligji është njohja e përvojës së punës dhe përcaktimi i të drejtave në kompensim shtesë mbi pensionin që realizon të përfituesit, për punëtorët e arsimit shqip të Republikës së Kosovës që punuan nga viti shkollor 1990/91 deri në vitin shkollor 1998/99.

Neni 2 [Fushëveprimi]

1. Fushëveprimi i këtij Ligji është përcaktimi i të drejtave në kompensim shtesë për punëtorët e arsimit shqip të Republikës së Kosovës që punuan nga viti shkollor 1990/91 deri në vitin shkollor 1998/99.

2. Ky ligj nuk zbatohet ndaj të gjithë punonjësve që kanë kontribuar gjatë kësaj periudhe dhe janë financuar jashtë sistemit të Republikës së Kosovës.

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

132. Gjykata së pari do të shqyrtojë nëse kërkesa i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe me Rregullore të punës.

133. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 8 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, që përcaktojnë:

1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

(...)

8. Gjykatat kanë të drejtë t'i referojnë Gjykatës Kushtetuese çështje përkitazi me përputhshmërinë kushtetuese të një ligji, nëse ajo përputhshmëri është ngritur gjatë

procedurës gjyqësore dhe gjykata referuese nuk është e sigurt për përputhshmërinë e ligjit të kontestuar me Kushtetutën dhe nëse vendimi i gjykatës referuese për rastin e caktuar, varet nga përputhshmëria e ligjit në fjalë.

134. Gjykata i referohet neneve 51, 52 dhe 53 të Ligjit, që përcaktojnë:

Neni 51
Saktësimi i kërkesës

1. Kërkesat e ngritura në pajtim me nenin 113, paragrafi 8 të Kushtetutës do të parashtrahet nga gjykata vetëm nëse ligji i kontestuar duhet zbatohet drejtpërsëdrejti në çështjen që është pjesë e lëndës në shqyrtim dhe vetëm nëse ligjshmëria e ligjit të kontestuar është parakusht për marrjen e vendimit nga ana e gjykatës.

2. Kërkesa do të specifikoj cilat dispozita të ligjit konsiderohen në kundërshtim me Kushtetutën.

Neni 52
Procedura para Gjykatës

Pas ngritjes së kërkesës në pajtim me nenin 113, paragrafi 8 të Kushtetutës, procedura para gjykatës referuese do të suspendohet deri në nxjerrjen e një vendimi nga ana e Gjykatës Kushtetuese.

Neni 53
Vendimi

Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për pajtueshmërinë e dispozitës ligjore me Kushtetutën dhe nuk vendos për çështje të tjera faktike ose juridike që kanë të bëjnë me kontestin para gjykatës referuese.

135. Gjykata, po ashtu, merr parasysh rregullin 77 të Rregullores së punës, që specifikon:

Rregulli 77 [Kërkesa në pajtim me nenin 113.8 të Kushtetutës
dhe me nenet 51, 52 dhe 53 të Ligjit]

(1) Kërkesa e ngritur sipas këtij rregulli duhet të përmbushë kriteret e përcaktuara me nenin 113.8 të Kushtetutës dhe me nenet 51, 52 dhe 53 të Ligjit.

(2) Çdo gjykatë e Republikës së Kosovës mund të parashtrojë një kërkesë sipas këtij rregulli, me kusht që:

- (a) ligji i kontestuar duhet të zbatohet drejtpërdrejt nga gjykata në lidhje me çështjen në pritje; dhe*
- (b) ligjshmëria e ligjit të kontestuar është parakusht për vendimin lidhur me rastin në pritje të gjykatës.*

(3) Kërkesa e parashtruar sipas këtij rregulli duhet të specifikojë se cilat dispozita të ligjit të kontestuar konsiderohen të papajtueshme me Kushtetutën. Dokumenti i shqyrtuar nga Gjykata i bashkëngjitet kërkesës.

(4) Gjykata referuese mund të parashtrojë kërkesë ex officio ose me kërkesën e njëres prej palëve në rast dhe pavarësisht nëse një palë në rast ka kontestuar kushtetutshmërinë e dispozitës përkatëse ligjore.

(5) Pas parashtrimit të kërkesës, Gjykata urdhëron gjykatën referuese që të pezullojë procedurën lidhur me rastin në fjalë derisa të merret vendimi i Gjykatës Kushtetuese.

136. Në dritën e kornizës së mësipërme normative, rezulton se çdo kërkesë e dorëzuar sipas paragrafit 8 të nenit 113 të Kushtetutës, që të jetë e pranueshme, duhet t'i plotësojë kriteret në vijim:
- a) Kërkesa të jetë dorëzuar nga një “gjykatë”;
 - b) Gjykata (referuese) duhet të mos jetë e sigurt për përputhshmërinë e ligjit të kontestuar me Kushtetutën;
 - c) Gjykata referuese duhet të specifikojë se cilat dispozitat të ligjit të kontestuar konsiderohen të papajtueshme me Kushtetutën;
 - d) Ligji i kontestuar duhet të zbatohet drejtpërdrejt nga gjykata referuese në rastin në shqyrtim para saj; dhe
 - e) Ligjshmëria e ligjit të kontestuar është parakusht për të marrë vendim në rastin në shqyrtim.
137. Gjykata sjellë në vëmendje praktikën e saj gjyqësore e cila konfirmon kriteret e lartpërmendura, përkritazi me pranueshmërinë e kërkesave të paraqitura në bazë të nenit 113.8 të Kushtetutës (shih, *mutatis mutandis*, rastet e Gjykatës Kushtetuese, [KO157/18](#), parashtrues, *Gjykata Supreme e Kosovës për çështjen Vlerësim i kushtetutshmërisë së nenit 14, paragrafit 1.7 të Ligjit nr. 03/L- 179 për Kryqin e Kuq të Republikës së Kosovës*, Aktgjykim i 28 marsit 2019, paragrafi 45; [KO126/16](#), parashtrues, *Kolegji i Specializuar i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit*, Aktvendim për papranueshmëri, i 27 marsit 2017, paragrafi 62; [KO142/16](#), parashtrues, *Kolegji i Specializuar i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit*, Aktgjykim i 9 majit 2017, paragrafi 58).
138. Rrjedhimisht, Gjykata fillimisht vlerëson nëse Gjykata referuese është palë e autorizuar për të parashtruar një kërkesë të tillë. Në lidhje me këtë, Gjykata rikujton se kërkesa është dorëzuar nga Gjykata Supreme dhe është nënshkruar nga kryetari i saj, në kuadër të autorizimeve që lidhen me funksionin e tij. Kërkesa theksohet qartë se ajo paraqitet nga Kolegjiumi i Gjykatës Supreme e cila duhet të vendosë për kërkesën për rishqyrtimin e jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor. Prandaj, Gjykata konsideron se kërkesa e tanishme është dorëzuar nga një “gjykatë” në kuptim të nenit 113.8 të Kushtetutës (shih, rastet e Gjykatës Kushtetuese, [KO157/18](#), parashtrues, *Gjykata Supreme e Kosovës*, cituar më lart, paragrafi 48; [KO126/16](#), parashtrues, *Kolegji i Specializuar i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit*, cituar më lart, paragrafët 55-60).
139. Gjykata po ashtu vëren se Gjykata referuese ka ngritur dyshime për sa i përket kushtetutshmërisë së Ligjit të kontestuar. Për më tepër, Gjykata referuese ka specifikuar në mënyrë të veçantë paragrafin 2 të nenit 8 të Ligjit të kontestuar lidhur me nenet 5 dhe 6 të Udhëzimit Administrativ të kontestuar, si dispozita të cilat i konsideron se mund të jenë në kundërshtim me Kushtetutën.
140. Në vijim, Gjykata gjithashtu vlerëson nëse Ligji i kontestuar duhet të zbatohet drejtpërsëdrejti nga Gjykata referuese në lëndën në shqyrtim e sipër para saj dhe nëse kushtetutshmëria e Ligjit të kontestuar është parakusht për marrjen e vendimit nga Gjykata referuese.
141. Gjykata konsideron se “zbatimi i drejtpërdrejtë” i normës konkrete nënkupton se nga zbatimi apo moszbatimi i drejtpërdrejtë i saj varet rezultati i vendimit nga Gjykata referuese. Përkatësisht, si pasojë e zbatimit apo moszbatimit të drejtpërdrejtë të normës

konkrete, gjykatat e rregullta do të mund të merrnin vendime me rezultate të ndryshme (shih, rastin e Gjykatës Kushtetuese, [KO157/18](#), cituar më lart, paragrafi 52).

142. Së këndejmi, në mënyrë që të ekzistojë lidhje e drejtpërdrejtë, duhet të ketë një raport të domosdoshëm ndërmjet vendimit të Gjykatës Kushtetuese (zgjidhjes së çështjes së kushtetutshmërisë së ligjit nga kjo Gjykatë) dhe zgjidhjes së çështjes kryesore nga Gjykata referuese, në kuptimin që gjykimi nga Gjykata referuese nuk mund të përfundojë në mënyrë të pavarur nga gjykimi në Gjykatën Kushtetuese (shih, *mutatis mutandis*, rastet e Gjykatës Kushtetuese, [KO157/18](#), cituar më lart, paragrafi 53; dhe [KO142/16](#), cituar më lart, paragrafi 62).
143. Në dritën e fakteve të rastit dhe shqyrtimeve të mësipërme, Gjykata konsideron se kërkesa ngre dyshime serioze që kanë të bëjnë me kushtetutshmërinë e paragrafit 2 të nenit 8 të Ligjit të kontestuar lidhur me nenet 5 dhe 6 të Udhëzimit Administrativ të kontestuar. Gjithashtu, Gjykata referuese ka argumentuar se nenet specifike të Ligjit ndërlidhur me Udhëzimin Administrativ të kontestuar duhet të zbatohen drejtpërdrejtë në lëndën para saj.
144. Rrjedhimisht, për sa i përket përmbushjes së kriterëve të pranueshmërisë, Gjykata konstaton se Gjykata referuese: (i) është palë e autorizuar; (ii) ngre dyshime të arsyeshme për Ligjin e kontestuar; dhe (iii) ka dëshmuar se ai ligj duhet të zbatohet drejtpërdrejt nga gjykata referuese në rastin nën shqyrtim para saj. Po ashtu, Gjykata referuese ka arsyetuar se vlerësimi i kushtetutshmërisë së Ligjit të kontestuar është parakusht për të marrë vendim në rastin nën shqyrtim dhe ka qartësuar se cilat dispozitat e Ligjit të kontestuar konsiderohen të papajtueshme me dispozita konkrete të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.
145. Prandaj, Gjykata konstaton që kërkesa është e pranueshme për shqyrtim në merita.

Meritat e kërkesës

146. Gjykata rikujton se Gjykata referuese gjatë shqyrtimit të rasteve konkrete ka ngritur dyshime për papajtueshmërinë e nenit 8 të Ligjit të kontestuar lidhur me nenin 5 dhe 6 të Udhëzimit Administrativ të kontestuar, me nenet 24 [Barazia para Ligjit] dhe 46 [Mbrotjtja e Pronës] të Kushtetutës në lidhje me nenin 1 (Mbrotjtja e Pronës) të Protokollin nr.1 të KEDNJ-së.
147. Gjykata vlerëson se për vlerësimin e kushtetutshmërinë së dispozitave përkatëse të Ligjit dhe Udhëzimit Administrativ të kontestuar, së pari duhet sqaruar bazën ligjore lidhur me kategoritë që përfitojnë dhe ato që nuk përfitojnë nga pensioni kontributpagues si dhe ndërlidhjen e Ligjit dhe Udhëzimit Administrativ të kontestuar me Ligjet e ish KSAK-së dhe të ish RSFJ-së, veçanërisht lidhur me kriterin pesëmbëdhjetë (15) vjeçar të stazhit kontributpagues, i cili përbën pretendimin kryesorë të Gjykatës referuese përkitazi me kundërkushtetutshmërinë e akteve të kontestuara me dispozitat e lartcekura kushtetuese.
148. Në këtë kontekst, Gjykata fillimisht vëren se Ligji për Skemat Pensionale të Financuara nga Shteti, ndër të tjera, përcakton: (i) llojet e pensioneve; dhe (ii) kriteret dhe procedurat administrative të domosdoshme për njohjen e të drejtës në kategorinë e pensionit përkatës. Përkitazi me llojet e pensioneve, në nenin 4 (Të drejtat e përcaktuara me këtë ligj) të Ligjit të kontestuar, përcaktohen llojet e pensioneve, si në vijim: (i) e drejta në pension bazik të moshës; (ii) e drejta në pension kontributpagues të moshës; (iii) e drejta në pension të aftësisë së kufizuar; (iv) e drejta në pension të parakohshëm; (v) e drejta në pension invalidor të punës; dhe (vi) e drejta në pension familjar. Nenet vijuese të Ligjit të kontestuar, përcaktojnë kushtet dhe kriteret për njohjen e secilës prej kategorive të pensioneve të lartcekura, ndërsa, neni 19 (Procedurat Administrative) i Ligjit të kontestuar, përcakton procedurën e nevojshme që duhet të ndiqet nga parashtruesit

përkatës të kërkesave për njohje të së drejtës në pension, duke saktësuar afatet për parashtrimin e kërkesave dhe të ankesave lidhur me njohjen/përkatësisht mosnjohjen e të drejtës në kategoritë e pensioneve përkatëse.

149. Gjykata më tej vëren se çështje shqyrtimi para Gjykatës në rrethanat e rastit konkret, është vetëm kategoria e dytë e pensioneve siç është përcaktuar në nenin 4 të Ligjit për Skemat Pensionale të Financuara nga Shteti, përkatësisht e drejta në pension kontributpagues të moshës. Më saktësisht, kjo kategori në bazë të Ligjit të kontestuar është e definuar si *“pension i rregullt mujor për qytetarët e Republikës së Kosovës, të cilët i kanë paguar kontributet, në ish-Fondin Pensional të Kosovës para datës 01.01.1999 sipas dispozitave të Ligjit për Sigurimin Pensional dhe Invalidor nr.011-24/83 (Gazeta Zyrtare e KSAK-së nr. 26/83) e të cilët i plotësojnë kriteret e paraparë me këtë ligj”*.
150. Përkitazi me këtë kategori të pensionit, Gjykata gjithashtu vëren se kushtet dhe kriteret për njohjen e të drejtës në pension kontributpagues të moshës, janë të përcaktuara në nenin 8 të Ligjit të kontestuar, dhe i cili në këtë aspekt, përcakton tri kryesore, përkatësisht që personat të cilat kanë shtetësi të Kosovës: (i) të kenë mbushur moshën gjashtëdhjetë e pesë (65) vjeçare; (ii) të kenë stazh pensional kontributdhënës, sipas Ligjit për Sigurimin Pensional dhe Invalidor nr. 011-24/83 të publikuar në Gazetën Zyrtare e KSAK nr.26/83 (në tekstin e mëtejshëm: Ligji i ish KSAK-së) para 1 janarit 1999; dhe (iii) të ofrojnë dëshmi të vlefshme mbi pagesën e kontributeve sipas dispozitave të Ligjit të lartcekur të ish KSAK-së, para 1 janarit 1999.
151. Përtej këtyre tri kryesoreve ligjore, paragrafi 2 i nenit 8 të Ligjit të kontestuar, përcakton se kategorizimi i shfrytëzuesve të këtij lloji të pensionit, duhet të përcaktohet me akt nënligjor, *“sipas kohëzgjatjes së pagesës së kontributit sipas strukturës kualifikuese dhe kriterëve tjerë”*. Ky akt nënligjor, është Udhëzimi Administrativ nr. 09/2015 për Kategorizimin e Shfrytëzuesve të Pensionit Kontributpagues sipas Strukturës Kualifikuese dhe Kohëzgjatjes së Pagesës së Kontributeve i nxjerrë nga MPMS në vitin 2015, përkatësisht Udhëzimi Administrativ i kontestuar në rrethanat e rastit konkret.
152. Gjykata më tej thekson se bazuar në këtë Udhëzim Administrativ, ndër të tjera, janë të përcaktuara: (i) kategorizimi, kualifikimi dhe dokumentet e nevojshme për njohjen e të drejtës në pension kontributpagues në nenet 4 (Kategorizimi sipas strukturës kualifikuese dhe kohëzgjatjes së pagesave të kontributeve), 5 (Kualifikimi i shfrytëzuesve të pensionit kontributpagues), 6 (Dokumentet e nevojshme për njohjen e të drejtës në pension kontributpagues) dhe 7 (Dëshmitë e tjera plotësuese), respektivisht; dhe (ii) procedurat administrative për njohjen dhe realizimin e pensionit kontributpagues në nenet 10 (Procedurat administrative për njohjen dhe realizimin e pensionit kontributpagues), 11 (Pranimi i kërkesës), 12 (Shqyrtimi dhe vendosja e kërkesës) dhe 13 (E drejta e ankesës), respektivisht.
153. Përkitazi me kategorizimin, kualifikimin dhe dokumentet e nevojshme, nenet e lartcekura të Udhëzimit Administrativ, ndër të tjera, përcaktojnë që: (i) të gjitha dëshmitë për kualifikimin përkatës duhet të jenë para datës 1 janar 1991; dhe (ii) që parashtruesit përkatës të kërkesave për njohjen e të drejtës në pension kontributpagues duhet të kenë stazh pensional kontributdhënës së paku pesëmbëdhjetë (15) vjet para datës 1 janar 1999, sipas Ligjit të ish KSAK-së, duke saktësuar gjithashtu dokumentet e nevojshme përmes të cilave do të mund të vërtetohej stazhi përkatës.
154. Përkitazi me kriterin pesëmbëdhjetë (15) vjeçar, Gjykata vëren se i njëjti është dhënë në mënyrë të nënkuptuar/jo të drejtpërdrejtë përmes nënparagrafit 1.2 të nenit 8 të Ligjit të kontestuar. Në këtë drejtim, Gjykata vlerëson se nënparagrafi 1.2 dhe 1.3 të paragrafit 1 dhe 2 të nenit 8 të Ligjit të kontestuar dhe nënparagrafi 2.3 të paragrafi 2 të nenit 6 të Udhëzimit Administrativ të kontestuar, i cili shprehimisht përcakton kriterin pesëmbëdhjetë (15) vjeçar, duhet të lexohen së bashku dhe në harmoni me njëra tjetrën

sepse këto dispozita përcaktojnë: (i) se e drejta në pension kontributpagues realizohet nga personat që kanë stazh pensional kontributpagues së paku pesëmbëdhjetë (15) vjet, sipas Ligjit të ish KSAK-së para 1 janarit 1999; si dhe (ii) duhet të ofrojnë dëshmi të vlefshme mbi pagesën e kontributeve sipas dispozitave të Ligjit të lartcekur të ish KSAK-së para 1 janarit 1999.

155. Gjykata po ashtu vëren se paragrafi 2 i nenit 8 të Ligjit të kontestuar përcakton se kategorizimi dhe kriteret tjera për kualifikimin e pensionistëve kontributpagues duhet të përcaktohet me akt nënligjor, pa specifikuar se çfarë duhet të jetë përmbajtja e aktit nënligjor, por duke saktësuar se kategorizimi i shfrytëzuesve të pensionit kontributpagues duhet të bëhet *“sipas kohëzgjatjes së kontributit sipas strukturës kualifikuese dhe kriterëve tjera”*. Mirëpo, siç u shtjellua më lart, paragrafi 2 i nenit 8 duhet të lexohet së bashku me nënparagrafët 1.2 dhe 1.3 të paragrafit 1 të nenit 8 të Ligjit të kontestuar që përcaktojnë përdorimin e standardit të përcaktuar me Ligjin e ish KSAK-së. Mbi këtë premisë edhe akti nënligjor, përkatësisht Udhëzimi Administrativ i kontestuar, përcakton kriterin e stazhit pesëmbëdhjetë (15) vjeçar para 1 janarit 1999.
156. Gjykata, në këtë aspekt, rikujton që përmes nenit 1 të Ligjit të ish KSAK-së përcaktohet se me këtë ligj rregullohen të drejtat themelore nga sigurimi pensional e invalidor në përputhje me Ligjin mbi të Drejtat Themelore nga Sigurimi Pensional e Invalidor i ish RSFJ-së, ndërsa neni 21 i Ligjit të ish RSFJ-së, parashikon që punonjësi, përkatësisht i siguruari, fiton të drejtën në *“pensionin e pleqërisë”* me pesëmbëdhjetë (15) vjet të stazhit të sigurimit.
157. Gjykata, në këtë aspekt, sqaron që referenca në ligjet e lartcekura të ish KSAK-së dhe ish RSFJ-së, buron nga vet Ligji i miratuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, përkatësisht Ligjit për Skemat Pensionale të Financuara nga Shteti, përkitazi me kategorinë e pensionit kontributpagues. Megjithatë, kriteri që kjo kategori pensionesh të ndërpritet në vitin 1999, përkatësisht të vlejë vetëm për qytetarët e Republikës së Kosovës të cilët mund të kenë kontribuar deri në vitin 1999, është i saktësuar vetëm përmes Ligjit të kontestuar. Pra, Ligji i kontestuar merr parasysh rrethanat politike të të njëjtit vit, përkatësisht vendosjen e Kosovës nën administrim ndërkombëtar siç parashihej përmes Rezolutës së Këshillit të Sigurimit të OKB-së 1244 (1999), si pasojë e të cilës, rezultoi, ndër të tjera, edhe ndërprerja e sistemit paraprak kontributdhënës nga i cili buron kjo kategori pensionesh. Ndërsa, kriteri për stazhin kontributdhënës pesëmbëdhjetë (15) vjeçar, është përcaktuar vetëm përmes aktit përkatës nënligjor, përkatësisht Udhëzimit të kontestuar Administrativ, bazuar në ligjet e lartcekura të ish KSAK-së dhe ish RSFJ-së, përkundër faktit që formulimi i ligjit përkatës që e delegon këtë kompetencë në Ministrinë përkatëse, kërkon që kategorizimi i shfrytëzuesve të pensionit kontributdhënës, të bëhet sipas *“kohëzgjatjes së pagesës së kontributit”* (për më shumë lidhur me ndërlidhjen e Ligjit të ish KSAK dhe Ligjit të ish RSFJ-së përkitazi me kriterin pesëmbëdhjetë (15) vjeçar të stazhit të punës, shih raportin e Institucionit të Avokatit të Popullit të 6 prillit 2018, me theks në paragrafin 12).
158. Në kontekstin e përmbajtjes së dispozitave të lartcekura, Gjykata rithekson se paragrafi 2 i nenit 8 të Ligjit të kontestuar dhe nënparagrafi 2.3 paragrafi 2 i nenit 6 të Udhëzimit Administrativ të kontestuar, lexuar së bashku dhe në harmoni me njëra tjetrën, ndër të tjera, saktësojnë se: (i) të drejtë në pension kontributpagues gëzojnë personat me shtetësi të Kosovës që kanë stazh pensional kontributdhënës sipas Ligjit të ish KSAK-së deri më 1 janar 1999; (ii) duhet të ofrojnë dëshmi të vlefshme për pagesën e këtyre kontributeve sipas Ligjit përkatës të ish KSAK-së deri më 1 janar 1999; dhe (iii) kategorizimi i shfrytëzuesve të pensionit kontributdhënës *“sipas kohëzgjatjes së pagesës së kontributit”* përkatës do të përcaktohet me akt nënligjor. Ky i fundit, përkatësisht, Udhëzimi Administrativ i kontestuar, përcakton kriteret shtesë dhe sipas të cilave: (i) e drejta në pension kontributpagues realizohet nga personat që kanë stazh pensional kontributpagues së paku pesëmbëdhjetë (15) vjet sipas Ligjit të ish KSAK-së para 1 janarit 1999; si dhe (ii) duhet të

ofrojnë dëshmi të vlefshme mbi pagesën e kontributeve sipas dispozitave të Ligjit të lartcekur të ish KSAK-së, para 1 janarit 1999.

159. Gjykata vëren se pavarësisht kriterëve të lartcekura, Ligji i kontesuar përmes paragrafit 6 të nenit 8, ka përcaktuar se stazhi i punës për pension kontributdhënës për vitet 1989-1999 u njihet *“punëtorëve të arsimit, të shëndetësisë dhe të tjerëve që kanë punuar në sistemin e Republikës së Kosovës”*, edhe pse të njëjtin nuk kanë paguar kontributet sipas Ligjit përkatës të ish-KSAK-së deri më 1 janar 1999, por kanë punuar *“në sistemin e Republikës së Kosovës”*.
160. Andaj, Gjykata vëren se çështja kryesore kushtetuese që ngrit kjo kërkesë është nëse qytetarët që nuk kanë provuar/dëshmuar stazhin prej pesëmbëdhjetë (15) vitesh pension kontributpagues, para 1 janarit 1999, janë diskriminuar: (i) në krahasim me *“punëtorët e arsimit, shëndetësisë dhe të tjerëve që kanë punuar në sistemin paralel të Republikës së Kosovës”*, të cilëve u njihet stazhi në fjalë në vitet 1989-1999; dhe, (ii) nëse duke pasur parasysh situatën e Kosovës gjatë viteve të 90-ta, standardi pesëmbëdhjetë (15) vjeçar i stazhit të punës për pension kontributdhënës para 1 janarit 1999, është kriter joproporcional për të dëshmuar stazhin përkatës gjatë asaj periudhe.
161. Në përcaktimin e kategorive të këtyre punëtorëve, Gjykata e vlerëson të nevojshme të sqarojë sfondin historik, ku vendin kryesor e zë kategoria e punëtorëve që kanë punuar para vitit 1999 dhe nuk e kanë arritur stazhin pensional kontributpagues prej pesëmbëdhjetë (15) viteve për shkak të largimit nga puna në kohën e vendosjes së masave të dhunshme në Kosovë, përmes ligjeve diskriminuese të Serbisë, përfshirë por duke mos u kufizuar në: (i) Ligjin e Marrëdhënieve të Punës në Rrethana të Veçanta publikuar në Gazetën Zyrtare të RSS-së nr.40/90; (ii) Ligjin mbi Masat e Përkohshme për Mbrojtjen Shoqërore të të Drejtave Vetë-Menaxhuese dhe të Pronës Shoqërore, të publikuar në Gazetën Zyrtare të RSS-së nr. 49 të datës 28 tetor 1989; dhe (iii) Ligjin për Veprimet e Autoriteteve Republikane në Gjendje të Jashtëzakonshme të publikuar në Gazetën Zyrtare të RSS-së nr. 30/1990, të datës 26 qershor 1990 (shih, për më tepër, raportin *ex officio* të Avokatit të Popullit nr. 235/2018, në lidhje me kategorinë e qytetarëve që kanë punuar para vitit 1999 dhe nuk përfitojnë nga pensioni kontributpagues të moshës për shkak se nuk e plotësojnë kriterin e stazhit pensional prej 15 viteve si pasojë e largimit diskriminues nga puna, 6 prill 2018, paragrafët 38-50; shih, gjithashtu, komentet me shkrim të Republikës së Sllovenisë të 17 korrikut 2009, drejtuar Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë lidhur me kërkesën për Mendim Këshillëdhënës për Pajtueshmërinë me të Drejtën Ndërkombëtare të Deklaratës së njëanshme të Pavarësisë nga ana e Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes në Kosovë).
162. Në këtë kontekst, Gjykata gjithashtu vë në pah edhe një herë që Ligji i kontestuar përmes paragrafit 6 të nenit 8 të Ligjit të kontestuar, specifikisht përjashton një kategori të caktuar të qytetarëve të Kosovës, duke u njohur në mënyrë të drejtpërdrejtë stazhin e punës përgjatë viteve 1989-1999, respektivisht, *“punëtorëve të arsimit, të shëndetësisë dhe të tjerëve që kanë punuar në sistemin e Republikës së Kosovës”*. Për më tepër, Gjykata vëren që për grupin e parë të kësaj kategorie, përkatësisht punëtorët e arsimit, në vitin 2019 është miratuar edhe Ligji nr. 06/L-073 për Statusin e Punëtorëve të Arsimit Shqip të Republikës së Kosovës nga Viti Shkollor 1990/91 deri në Vitin Shkollor 1998/99, dhe mbi bazën e të cilit, përcaktohet edhe kompenzim shtesë për punëtorët e arsimit për punën e bërë gjatë periudhës së lartcekur.
163. Gjykata thekson se *“kategoritë e tjera”* të cilat nuk kanë punuar në *“sistemin e Republikës së Kosovës”* gjatë periudhës 1989-1999, dhe të cilat janë të përjashtuara në paragrafin 6 të nenit 8 të Ligjit të kontestuar dhe të cilat i nënshtrohen kriterëve të paragrafit 2 të nenit 8 të Ligjit të kontestuar në ndërlidhje me nenin 6 të Udhëzimit Administrativ të kontestuar, përfshin, ndër të tjera, pozitat e kategorisë së punëtorëve të ndërmarrjeve shoqërore, pozitat profesioniste dhe të zanatit dhe punëtorët administrativ, të policisë dhe të

gjyqësorit, si dhe pozitat e tjera vepruese në sistemin e ekonomisë së asaj periudhe dhe të cilëve për dallim nga *“punëtorët e arsimit, shëndetësisë dhe të tjerëve që kanë punuar në sistemin e Republikës së Kosovës”*, nuk u njihet stazhi i punës përgjatë viteve 1989-1999 dhe u kërkohet që të ofrojnë dëshmi konkrete të stazhit të punës në tejzgjatje prej së paku pesëmbëdhjetë (15) vjeçare para 1 janarit 1999. Megjithatë, nuk është kontestuese që shumica dërmuese e qytetarëve, ishin larguar nga vendet e tyre të punës si rezultat i masave të dhunshme dhe diskriminuese ndaj komunitetit shqiptar, me ç’ rast edhe iu është pamundësuar pagesa e kontributeve në periudhën 89-99 (shih, në këtë aspekt: *Rezolutën e Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara nr. 48/153*, të 20 dhjetorit 1993, pika 18.b.; dhe shih për më tepër edhe nënpiakat e tjera të pikës 18 të kësaj Rezolute, të cilat përshkruajnë praktikën diskriminuese dhe shkeljen e të drejtave të njeriut të shqiptarëve etnik të Kosovës nga autoritetet serbe përgjatë viteve të lartcekura).

164. Gjykata gjithashtu vëren se përkundër faktit që kategorisë së *“punëtorëve të arsimit, shëndetësisë dhe të tjerëve që kanë punuar në sistemin e Republikës së Kosovës”* u është njohur stazhi i punës në periudhën 1989-1999, pa i paguar kontributet në sistemin e atëhershëm pensional, Ligji i kontestuar, në nenin 5 (Sigurimi i mjeteve financiare për pagesat e pensione) të tij, saktësisht përcakton që të gjitha kategoritë e pensione të saktësuar në nenin 4 të të njëjtit ligj, duke përfshirë edhe ato kontributpaguese, sigurohen nga Buxheti i Republikës së Kosovës. Rrjedhimisht, përkundër asaj që skema quhet kontributdhënëse/kontributpaguese, shumën e pensionit si dhe kategorizimi përkatës, nuk kanë të bëjnë me shumën e kontributit të paguar para 1 janarit 1999, sepse kjo skemë mbulohet në tërësi nga buxheti i Republikës së Kosovës. Pra, është fakt që fondi për Sigurimin Pensional dhe Invalidor të ish KSAK-së, ishte përvetësuar nga Serbia dhe për pasojë, ishte ndërprerë marrja e pensioneve kontributdhënëse bazuar në kontributet e paguara në këtë fond.
165. Marrë parasysh sfondin e lartcekur dhe pretendimet e Gjykatës referuese lidhur me kundërkushtetushmërinë e dispozitave përkatëse të Ligjit të kontestuar dhe Udhëzimit përkatës Administrativ, me theks në pretendimet përkitazi me të drejtën kushtetuese për barazi para ligjit të garantuar përmes nenit 24 të Kushtetutës në lidhje me nenin 14 të KEDNJ-së dhe nenit 1 të Protokollit nr. 12 të saj, Gjykata me qëllim të vlerësimit të kushtetutshmërisë së akteve të kontestuara, në vijim do t’i paraqes: (i) parimet e përgjithshme të ndalimit të diskriminimit siç janë zhvilluar nga praktika gjyqësore e GJEDNJ-së; dhe (ii) do t’i aplikojë ato parime në raport me dispozitave e akteve të kontestuara nga Gjykata referuese. Në këtë kontekst, është me rëndësi të ritheksohet, që në kontekst të një kontrolli incidental, të referuar në Gjykatë bazuar në paragrafin 8 të nenit 113 të Kushtetutës, Gjykata vendos vetëm përkitazi pajtueshmërinë ose jo të dispozitave ligjore të kontestuara me Kushtetutën dhe nuk vendos për çështje të tjera faktike ose juridike që kanë të bëjnë me kontestin konkret gjyqësor para Gjykatës referuese.
166. Gjykata rikujton se parashtruesit e kërkesave pretendojnë se neni 8 i Ligjit të kontestuar në ndërlidhje me nenin 5 dhe 6 të Udhëzimit të kontestuar Administrativ është në kundërshtim me nenin 24 të Kushtetutës sepse të njëjtit trajtojnë në mënyrë të ndryshme qytetarët e Republikës së Kosovës në raport me të drejtën për përfitimin e pensionit kontributdhënës të përcaktuar me Ligjin e kontestuar. Më konkretisht neni 8 i Ligjit të kontestuar në ndërlidhje me Udhëzimin përkatës Administrativ trajton ndryshe: (i) të gjitha ata që kanë stazh pensional por që nuk e kanë arritur kushtin prej pesëmbëdhjetë (15) viteve stazh kontributpagues para vitit 1999 për shkak të largimit nga puna në kohën e vendosjes së masave të dhunshme e diskriminuese; dhe (ii) *“punëtorët e arsimit, shëndetësisë dhe të tjerëve që kanë punuar në sistemin e Republikës së Kosovës”* të cilëve në bazë të paragrafit 6 të nenit 8 të Ligjit të kontestuar u njihet stazhi i punës për pension kontributpagues për vitet 1989-1999, pavarësisht faktit që të njëjtit po ashtu nuk kanë kontribuar në fondin pensional sipas Ligjit të ish KSAK-ut, por që kanë punuar dhe kontribuar në *“sistemin e Republikës së Kosovës”*. Gjykata rikujton që pa marrë parasysh

kohëzgjatjen e kontributit në ish-fondin pensional, të gjitha kategoritë e pensioneve të përcaktuara përmes Ligjit për Skemat Pensionale të Financuara në Shtetit, mbulohen nga buxheti i Republikës së Kosovës.

167. Gjykata gjithashtu thekson se përkundër pretendimeve të Gjykatës referuese lidhur me “*shekullin e punës*”, bazuar në të cilin pretendon edhe diskriminim lidhur me vitet përvojë pune pas vitit 1999, Gjykata thekson se: (i) Ligji për Skemat Pensionale të Financuara nga Shteti, saktësisht përcakton disa kategori pensionesh dhe të cilat nuk mund të ndërlidhet me njëra tjetrën; (ii) që kriteri prej pesëmbëdhjetë (15) vitesh stazh kontributpagues, ndërlidhet ekskluzivisht vetëm me kategorinë e pensionit kontributpagues të moshës të përcaktuar përmes pikës 1.2 të paragrafit 1 të nenit 8 të Ligjit të kontestuar; dhe se rrjedhimisht (iii) në rrethanat e rastit konkret, Gjykata do të vlerësojë pretendimet për barazi para ligjit dhe/ose diskriminim, vetëm brenda kategorisë së personave që mund të kenë të drejtë për pensionin kontributpagues bazuar në dispozitat e lartcekura të Ligjit të kontestuar.

168. Në vijim dhe në këtë kontekst të dispozitave përkatëse të akteve të kontestuara, Gjykata fillimisht i referohet nenit 24 [Barazia para Ligjit] të Kushtetutës, i cili përcakton që:

1. Të gjithë janë të barabartë para ligjit. Çdokush gëzon të drejtën e mbrojtjes së barabartë ligjore, pa diskriminim.

2. Askush nuk mund të diskriminohet në bazë të racës, ngjyrës, gjinisë, gjuhës, fesë, mendimeve politike ose të tjera, prejardhjes kombëtare a shoqërore, lidhjes me ndonjë komunitet, pronës, gjendjes ekonomike, sociale, orientimit seksual, lindjes, aftësisë së kufizuar ose ndonjë statusi tjetër personal.

3. Parimet e mbrojtjes së barabartë ligjore nuk parandalojnë vënien e masave të nevojshme për mbrojtjen dhe përparimin e të drejtave të individëve dhe grupeve që janë në pozitë të pabarabartë. Masat e tilla do të zbatohen vetëm derisa të arrihet qëllimi për të cilin janë vënë ato.

169. Gjykata gjithashtu rikujton nenet respektive të KEDNJ-së, përkatësisht nenin 14 (Ndalimi i Diskriminimit) të KEDNJ-së, i cili përcakton që:

“Gëzimi i të drejtave dhe i lirive të përcaktuara në këtë Konventë duhet të sigurohet, pa asnjë dallim të bazuar në shkaqe të tilla si seksi, raca, ngjyra, gjuha, feja, mendimet politike ose çdo mendim tjetër, origjina kombëtare ose shoqërore, përkatësia në një minoritet kombëtar, pasuria, lindja ose çdo status tjetër.”

170. Në fund, Gjykata i referohet edhe nenit 1 (Ndalimi i Përgjithshëm i Diskriminimit) të Protokollit nr. 12 të KEDNJ-së, i cili përcakton që:

1. Gëzimi i çdo të drejte të parashikuar me ligj duhet të sigurohet pa asnjë diskriminim të bazuar në shkaqe të tilla si seksi, raca, ngjyra, gjuha, feja, mendimet politike ose çdo mendim tjetër, origjina kombëtare ose shoqërore, përkatësia në një minoritet kombëtar, pasuria, lindja ose çdo situatë tjetër.

2. Askush nuk duhet të diskriminohet nga një autoritet publik për ndonjë nga arsytet e parashikuara në paragrafin 1.

171. Në kontekst të dispozitave të lartcekura, Gjykata fillimisht rikujton se neni 14 i KEDNJ-së garanton mbrojtjen ndaj diskriminimit në gëzimin e të drejtave të garantuara me KEDNJ. Sipas praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, parimi i ndalimit të diskriminimit është i natyrës “*fundamentale*” dhe ndërlidh Konventën me sundimin e ligjit dhe vlerat e tolerancës dhe paqes sociale (shih, ndër të tjera, rastin e GJEDNJ-së [S.A.S. kundër Francës](#), nr. 43835/11,

Aktgjykim i 1 korrikut 2014, paragrafi 149). Mbrojta kundër diskriminimit e përcaktuar në nenin 14 të KEDNJ-së, më tej është kompletuar dhe përforcuar edhe përmes nenit 1 të Protokollit nr. 12 të KEDNJ-së, i cili ndalon diskriminimin në mënyrë më të përgjithësuar, përtej të drejtave të garantuara me KEDNJ, pra edhe në gëzimin e çdo të drejte të përcaktuar me ligj (shih, gjithashtu dhe ndër të tjera, Aktgjykimin e Gjykatës në rastin [KO93/21](#), parashtres, *Blerta Deliu-Kodra dhe 12 Deputetë të Tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës*, Aktgjykim i 28 dhjetorit 2021, paragrafi 287).

172. Gjykata, duke u bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, vëren se kjo e fundit, në parim, ka konstatuar se neni 14 i KEDNJ-së, nuk ka ekzistencë autonome, por në mënyrë që ky nen të jetë i aplikueshëm duhet që të ndërlihet edhe me pretendimin e një shkeljeje të një të drejte apo lirie tjetër të garantuar me dispozitat e KEDNJ-së. Megjithatë, në praktikën e saj gjyqësore GJEDNJ ka theksuar se ndalimi i diskriminimit aplikohet edhe përkitazi me të drejtat e tjera shtesë, të cilat bien në fushëveprimin e përgjithshëm të njërit nga nenet e KEDNJ-së, për të cilat të drejta, shtetet në mënyrë vullnetare kanë vendosur që të garantojnë mbrojtjen e tyre (shih, në këtë kontekst, rastet e GJEDNJ-së, [Fábián kundër Hungarisë](#), nr. 78117/13, Aktgjykim i 5 shtatorit 2017, paragrafi 112; [Biao kundër Danimarkës](#), nr. 38590/10, Aktgjykim i 24 majit 2016, paragrafi 88; [İzzettin Doğan dhe të tjerët kundër Turqisë](#), nr. 62649/10, Aktgjykim i 26 prillit 2016, paragrafi 158; dhe [Carson dhe të tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar](#), nr. 42184/05, Aktgjykim i 10 marsit 2010, paragrafi 63).
173. Thënë këtë, neni 1 i Protokollit nr. 12 të KEDNJ-së ka zgjeruar fushëveprimin e mbrojtjes nga diskriminimi në nivel të GJEDNJ-së, duke përcaktuar një ndalim të përgjithshëm të diskriminimit, dhe rrjedhimisht duke përfshirë edhe të drejtat e përcaktuara me ligj.
174. Më saktësisht, neni 1 i Protokollit nr. 12 i KEDNJ-së zgjeron shtrirjen e mbrojtjes kundër diskriminimit të “*çdo të drejte të përcaktuar me ligj*” (shih, ndër të tjera, rastet e GJEDNJ-së; [Savez crkava “Riječ života” dhe të tjerët kundër Kroacisë](#), nr. 7798/08, Aktgjykim i 9 dhjetorit 2010, paragrafi 103; dhe [Sejdić dhe Finci kundër Bosnje dhe Hercegovinës](#), nr. 27996/06 dhe nr. 34836/06, Aktgjykim i 22 dhjetorit 2009, paragrafi 53). Sipas GJEDNJ-së, ky nen përfshin ndalimin e përgjithshëm të diskriminimit. GJEDNJ, për më tepër, përmes praktikës përkatëse gjyqësore, theksoi se ky ndalim i përgjithshëm i diskriminimit buron edhe nga paragrafi 2 i këtij neni, i cili përcakton që askush nuk mund të diskriminohet nga një autoritet publik. Sipas paragrafit 22 të Raportit Shpjegues të Protokollit nr. 12 të KEDNJ-së, i miratuar nga Këshilli i Evropës më 4 nëntor 2000, fushëveprimi i nenit 1 të këtij Protokollit përfshin katër kategori rrethanash kur “*një individ është i diskriminuar*”, si në vijim: (i) gëzimin e çdo të drejte të garantuar në mënyrë specifike për një individ sipas ligjit vendor; (ii) gëzimin e të drejtave, të cilat burojnë nga një obligim i qartë i autoritetit publik sipas ligjit vendor, ku autoriteti publik është i obliguar që të sillet në një mënyrë të caktuar; (iii) nga autoriteti publik në ushtrimin e pushtetit diskrecional; dhe (iv) në bazë të një veprimi ose mosveprimi të një autoriteti publik (shih, gjithashtu dhe ndër të tjera, Aktgjykimin e Gjykatës në rastin [KO93/21](#), parashtres, *Blerta Deliu-Kodra dhe 12 Deputetë të Tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës*, cituar më lart, paragrafi 290).
175. Në kuptim të nenit 24 të Kushtetutës, Gjykata gjithashtu vë në pah se fushëveprimi i këtij neni është i gjerë dhe shtrihet edhe në garantimin e ndalimit të diskriminimit, jo vetëm sa i përket të drejtave të garantuara me Kushtetutë, por edhe atyre të përcaktuara me ligj. Rrjedhimisht, vlerësimi i pretendimeve për cenimin e këtij neni duhet të bëhet përtej garancive të nenit 14 të KEDNJ-së, dhe të përfshijë edhe garancitë e përcaktuara përmes nenit 1 të Protokollit nr. 12 të KEDNJ-së (shih, gjithashtu dhe ndër të tjera, Aktgjykimin e Gjykatës në rastin [KO93/21](#), parashtres, *Blerta Deliu-Kodra dhe 12 Deputetë të Tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës*, cituar më lart, paragrafi 292).

176. Në vijim të kësaj, në kuptim të nenit 24 të Kushtetutës dhe duke aplikuar edhe qëndrimin e GJEDNJ-së të artikuluar përmes praktikës së saj gjyqësore përkitazi me nenin 1 të Protokollit nr. 12 të KEDNJ-së, Gjykata i referohet sërish dispozitave ligjore të cilat përcaktojnë të drejtat përkitazi me pensionin kontributpagues.

177. Gjykata rikujton gjuhën e nenit 8 (Kushtet dhe kriteret për njohjen e të drejtës në pension kontributpagues të moshës) të Ligjit për Skemat Pensionale të Financuara nga Shteti, i cili përcakton që:

1. Të drejtën në pension kontributpagues të moshës e realizojnë të gjithë personat të cilët kanë shtetësi të Kosovës dhe të cilët:

1.1. kanë mbushur moshën gjashtëdhjetë e pesë (65) vjeçare;

1.2. duhet të ketë stazh pensional kontributdhënës, sipas Ligjit për Sigurimin Pensional dhe Invalidor nr. 011-24/83 (Gazeta Zyrtare e KSAK nr.26/83) para datës 01.01.1999;

1.3. ofrojnë dëshmi të vlefshme mbi pagesën e kontributeve sipas dispozitave të Ligjit për Sigurimin Pensional dhe Invalidor nr.011-24/83 (Gazeta Zyrtare e KSAK nr.26/83) para datës 01.01.1999.

2. Kategorizimi i shfrytëzuesve të pensionit kontributdhënës, sipas kohëzgjatjes së pagesës së kontributit sipas strukturës kualifikuese dhe kriterëve tjerë, përcaktohet me akt nënligjor, të cilin do ta miratojë ministria përkatëse.

[...]

6. Me këtë ligj u njihet stazhi i punës për pension kontributdhënës për vitet 1989-1999 punëtorëve të arsimit, të shëndetësisë dhe të tjerëve që kanë punuar në sistemin e Republikës së Kosovës.

178. Më tej, Gjykata i referohet, nenit 5 (Kualifikimi i shfrytëzuesve të pensionit kontributpagues) të Udhëzimit të kontestuar Administrativ, i cili, ndër të tjera, përcakton që:

5. [...] Të gjitha dëshmitë për kualifikim, të përcaktuara nga paragrafët 2, 3 dhe 4 të këtij neni, duhet të jenë para vitit 01.01.1991.

179. Po ashtu, Gjykata i referohet nenit 6 (Dokumentet e nevojshme për njohjen e të drejtës në pension kontributpagues) të Udhëzimit të kontestuar Administrativ, i cili, ndër të tjera, përcakton që:

1. Të gjithë shfrytëzuesit e pensionit kontributpagues, përkatësisht të siguruarit me rastin e parashtrimit të kërkesës për pension kontributpagues, bazuar në kategorizimin sipas strukturës kualifikuese, duhet të sjellin dëshmitë relevante të përcaktuara në nenin 4 dhe 5 të këtij Udhëzimi, varësisht se për cilën kategori aplikojnë.

2. Përveç kushteve të përgjithshme të përcaktuara në dispozitat e Ligjit në fuqi për Skemat Pensionale të Financuara nga Shteti, shfrytëzuesit aktual dhe ata që aplikojnë në të ardhmen, duhet të paraqesin dokumentet e nevojshme, si:

[...]

2.3 Të kenë stazh pensional kontributdhënës së paku pesëmbëdhjetë (15) vjet para datës 01.01.1999, sipas Ligjit të SPI-së të Kosovës, nr.26/83, i cili vërtetohet me ndonjë nga këto dokumente, si:

[...]

180. Në vijim, bazuar në dispozitat e lartcekura, Gjykata do të vlerësojë dhe konstatojë nëse aktet e kontestuara nga Gjykata referuese, përkatësisht Ligji i kontestuar në lidhje me Udhëzimin Administrativ përkatës, është në kundërshtim me nenin 24 të Kushtetutës dhe nenin 1 të Protokollit nr. 12 të KEDNJ-së. Në këtë kontekst, dhe në kuptim të testit që aplikohet për të konstatuar nëse një akt i nxjerrë i autoritetit publik është në kundërshtim me nenin 14 të KEDNJ-së dhe nenin 1 të Protokollit nr.12 të KEDNJ-së, GJEDNJ në praktikën gjyqësore të saj, ka përcaktuar kriteret si në vijim:
- (i) Nëse ka pasur dallim në trajtim të personave në situata analoge ose situata relativisht të ngjashme – ose dështimi për të trajtuar persona ndryshe në situata relativisht të ndryshme;
 - (ii) Nëse ky është rasti, atëherë vlerësohet nëse një dallim i tillë – ose mungesë e dallimit – është e justifikuar në mënyrë objektive, përkatësisht:
 - (a) Nëse kufizimi ka ndjekur një qëllim legjitim;
 - (b) Masa e ndërmarrë ka qenë proporcionale me qëllimin që është synuar të realizohet.
181. Ndërsa, bazuar në praktikën gjyqësore të Gjykatës, testi kushtetues për të konstatuar nëse akti apo veprimi përbën diskriminim, përmban kriteret si në vijim (shih, ndër të tjera, rastet e Gjykatës [KO01/17](#), parashtrues *Aida Dërguti dhe 23 deputetë të tjerë të Kuvendit*, Aktgjykim i 28 marsit 2017; dhe [KO157/18](#), parashtrues *Gjykata Supreme*, cituar më lart, Aktgjykim i 13 marsit 2019 dhe [KO93/21](#), parashtrues, *Blerta Deliu-Kodra dhe 12 Deputetë të Tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës*, cituar më lart, paragrafi 298):
- (i) Të konstatohet nëse ka dallim në trajtim; dhe
 - (ii) Nëse ky është rasti, të vlerësojë:
 - (a) Nëse dallimi në trajtim është i përcaktuar me ligj;
 - (b) Nëse dallimi në trajtim ka ndjekur një qëllim legjitim; dhe
 - (c) Nëse ekziston një marrëdhënie e proporcionalitetit ndërmjet dallimit në trajtim dhe qëllimit që synohet të arrihet.
182. Bazuar në atë si më lart, dhe marrë për bazë praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së dhe atë të Gjykatës, në rastet kur kjo e fundit ka vlerësuar nëse e drejta për barazi para ligjit e garantuar me nenin 24 të Kushtetutës, është kufizuar, Gjykata duke aplikuar edhe nenin 1 të Protokollit nr. 12 të KEDNJ-së dhe duke marrë për bazë të drejtat dhe detyrimet e qytetarëve përkitazi me kategorinë e pensionit kontributpagues, do të vlerësojë nëse ka pasur “*dallim në trajtim*” të qytetarëve të Kosovës përkitazi me kriteret që duhet të plotësohen për të përfituar nga kjo e drejtë, dhe nëse ky është rasti, në vijim do të aplikojë testin e lartcekur që buron nga praktika gjyqësore e Gjykatës dhe e GJEDNJ-së, duke vlerësuar nëse dallimi në trajtim ka qenë: (a) i përcaktuar me ligj; (b) ka ndjekur një qëllim legjitim; dhe (c) nëse ekziston një marrëdhënie e proporcionalitetit ndërmjet kufizimit të së drejtës dhe qëllimit që synohet të arrihet (shih, gjithashtu dhe ndër të tjera, rastet e Gjykatës [KI45/20 dhe KI46/20](#), parashtrues, *Tinka Kurti dhe Drita Millaku*, Aktgjykim i 26 marsit 2021, paragrafi 85; shih, gjithashtu rastin [KO93/21](#), parashtrues, *Blerta Deliu-Kodra dhe 12 Deputetë të Tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës*, cituar më lart, paragrafi 300).
- (i) *nëse ka pasur dallim në trajtim*
183. Në kontekst të vlerësimit nëse dispozitat përkatëse të Ligjit të kontestuar në lidhje me Udhëzimin Administrativ përkatës janë diskriminuese, Gjykata fillimisht rithekson se bazuar në nenin 24 të Kushtetutës dhe në nenet e lartcekura të KEDNJ-së, dhe siç është sqaruar më tej përmes praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së por edhe të Gjykatës, jo çdo “*dallim në trajtim*” përbën diskriminim. Dallimi në trajtim rezulton në diskriminim nëse i

njëti nuk ka “një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm”. Prandaj, në vlerësimin nëse, rrethanat e një rasti, kanë rezultuar në diskriminim, praktika gjyqësore e GJEDNJ-së dhe e Gjykatës, fillimisht përcakton që duhet të vlerësohet nëse ka “dallim në trajtim” të personave në “situata analoge ose relativisht të ngjashme” (shih, ndër të tjera, rastin e Gjykatës [KO01/17](#), parashtrues, *Aida Dërguti dhe 23 deputetë të tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës*, cituar më lart, paragrafi 74).

184. Për pasojë, Gjykata në vlerësimin e pretendimeve të parashtruesve të kërkesave, fillimisht duhet të vlerësojë nëse, në rrethanat e rastit konkret, ka “dallim në trajtim” të personave në “situata analoge ose relativisht të ngjashme”, dhe nëse ky është rasti, të vazhdojë më tej me aplikimin e testit të GJEDNJ-së dhe të Gjykatës, për të konstatuar nëse një dallim i tillë në trajtim ka një “një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm” ose jo (shih, gjithashtu dhe ndër të tjera, Aktgjykimin e Gjykatës në rastin [KO93/21](#), parashtrues, *Blerta Deliu-Kodra dhe 12 Deputetë të Tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës*, cituar më lart, paragrafi 302).
185. Bazuar në paragrafët 1 dhe 2 të nenit 8 të Ligjit të kontestuar në lidhje me nenin 6 të Udhëzimit Administrativ të kontestuar, rezulton që: (i) të drejtë në pension kontribupagues kanë të gjithë qytetarët e Kosovës të cilët kanë arritur moshën gjashtëdhjetë e pesë (65) vjeçare dhe kanë stazh pensional kontributdhënës sipas Ligjit të ish KSAK-së para 1 janarit 1999 dhe kanë dëshmi të vlefshme për pagesën e kontributeve sipas të njëjtit ligj; (ii) që këtë të drejtë e kanë të gjithë ata qytetarë që kualifikimin, përkatësisht përgatitjen shkollore të ulët, të mesme, të lartë apo superiore, siç është përcaktuar në paragrafin 5 të nenit 5 të Udhëzimit të kontestuar e kanë të përmbyllur para 1 janarit 1991; dhe (iii) që kanë stazh të dëshmuar pensional kontributpagues së paku pesëmbëdhjetë (15) vjet deri më 1 janar 1999. Për dallim nga këto kriteret, “punëtorëve të arsimit, shëndetësisë dhe të tjerët që kanë punuar në sistemin e Republikës së Kosovës”, u “nënjhet stazhi i punës për pension kontributdhënës për vitet 1989-1999”, pavarësisht nëse janë paguar ose jo kontributet në ish-fondin e atëhershëm pensional, duke ua njohur stazhin kontributiv gjatë periudhës 1989-1999. Përfundimisht, duhet të rikujtohet edhe një herë fakti që shteti, përkatësisht Republika e Kosovës, përmes buxhetit të saj, financon që të dy kategoritë.
186. Në këtë kontekst, Gjykata vlerëson se nuk është kontestuese që: (i) në kuptim të dispozitave ligjore përkitazi me kategorinë e pensionit kontributpagues të gjithë qytetarët që kanë dëshmi për kualifikimet respektive siç janë të përcaktuara me Ligjin dhe Udhëzimin Administrativ të kontestuar para 1 janarit 1991 dhe kanë stazh kontributdhënës, janë në “situata analoge ose relativisht të ngjashme”; dhe (ii) që ka “dallim në trajtim” në mes të të njëjtëve përkitazi me plotësimin e kriterit për stazh kontributpagues për një periudhë kohore prej pesëmbëdhjetë (15) vitesh, periudhë kohore kjo e përcaktuar përmes nenit 6 të Udhëzimit Administrativ të kontestuar bazuar në Ligjin e ish KSAK-së. Kjo, sepse stazhi pensional për periudhën 1989-1999 u njohet një kategorie qytetarësh, përkatësisht kategorisë së qytetarëve të përcaktuar përmes paragrafit 6 të nenit 8 të Ligjit të kontestuar, përkatësisht “punëtorëve të arsimit, të shëndetësisë dhe të tjerë që kanë punuar në sistemin e Republikës së Kosovës”, por stazhi pensional për periudhën 1989-1999, nuk iu njohet atyre që janë larguar nga puna në vitet e 90-ta bazuar në ligje diskriminuese. Në këtë kontekst, këto dy kategori janë “në situatë analoge ose relativisht të ngjashme” pasi të dy kategoritë: (i) kanë stazh kontributdhënës para vitit 1989; dhe (ii) as njëra kategori nuk kanë kontribuar në fond pensional sipas Ligjit të ish KSAK-ut gjatë periudhës 1989-1999 për shkak të rrethanave historike dhe politike të asaj kohe. Megjithatë, siç është sqaruar më lart, për të përcaktuar nëse ky “dallim në trajtim” rezulton në diskriminim në kundërshtim me nenin 24 të Kushtetutës dhe nenet respektive të KEDNJ-së, Gjykata, bazuar në praktikën e saj gjyqësore dhe asaj të GJEDNJ-së, duhet të vlerësojë nëse ky dallim në trajtim ka “një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm”.

187. Në dritën e këtij konstatimi, Gjykata në vijim duhet të shqyrtojë nëse dispozitat përkatëse të kontestuara të Ligjit në lidhje me Udhëzimin Administrativ janë në kundërshtim me nenin 24 të Kushtetutës në lidhje me nenin 1 të Protokollit nr. 12 të KEDNJ-së, dhe në këtë kontekst duhet të vlerësojë dhe aplikojë kriteret që burojnë nga praktika gjyqësore e GJEDNJ-së dhe e Gjykatës, përkatësisht nëse *“dallimi përkatës në trajtim”*: (a) është i përcaktuar me ligj; (b) ka ndjekur një qëllim legjitim; dhe (c) nëse ekziston një marrëdhënie e proporcionalitetit ndërmjet kufizimit të së drejtës dhe qëllimit që synohet të arrihet. Për secilën nga këto kritere, Gjykata fillimisht do të paraqet parimet e përgjithshme dhe më pas, do t'i aplikojë të njëjtat në rrethanat e rastit konkret (shih, gjithashtu dhe ndër të tjera, Aktgjykimin e Gjykatës në rastin KO93/21, me parashtrues, *Blerta Deliu-Kodra dhe 12 Deputetë të Tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës*, lidhur me Vlerësimin e kushtetutshmërisë së Rekomandimeve të Kuvendit të Republikës së Kosovës, Nr. 08-R-01, të majit 2021, paragrafi 311).

(a) *Nëse dallimi në trajtim është i “përcaktuar me ligj”*

188. Bazuar në paragrafin 1 të nenit 55 të Kushtetutës por edhe parimet që burojnë nga praktika gjyqësore e GJEDNJ-së dhe e Gjykatës, kufizimi i të drejtave të garantuara me Kushtetutë është i mundshëm, por ky kufizim duhet të bëhet *“vetëm me ligj”*, që nënkupton, ndër të tjera, që autoritetet e thirrura për të zbatuar një ligj ku parashihen kufizime, mund të zbatojnë kufizimet vetëm deri në masën sa është *“përcaktuar me ligj”*. Ky paragraf rrjedhimisht paraqet kushtin e parë dhe esencial i cili duhet të plotësohet për të përcaktuar se a është kushtetues një *“kufizim”* i të drejtave dhe lirive themelore apo jo (shih, në mënyrë specifike, qëndrimin e Gjykatës në rastin [KO54/20](#), parashtrues, *Presidenti i Republikës së Kosovës*, Aktgjykim i 31 marsit 2020, paragrafi 192). Siç është sqaruar më lart, në vijim, Gjykata do të paraqesë parimet e përgjithshme përkitazi me këtë kriter dhe do t'i aplikojë të njëjtat në rrethanat e rastit (shih, gjithashtu dhe ndër të tjera, rastin e Gjykatës [KO93/21](#), parashtrues, *Blerta Deliu-Kodra dhe 12 Deputetë të Tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës*, cituar më lart, paragrafi 312).

(i) *Parimet e përgjithshme*

189. Sa i përket parimit të *“përcaktueshmërisë me ligj”*, Gjykata e sheh të nevojshme të sqarojë, fillimisht kuptimin e termit *“ligj”* nga pikëpamja e kufizimit të të drejtave të njeriut. Në këtë kuptim, Gjykata rikujton se sipas praktikës së GJEDNJ-së, kjo e fundit gjithmonë e ka kuptuar termin *“ligj”* në kuptimin *“përmbajtësor”*, dhe jo në atë *“formal”*. Në këtë kontekst, termi *“ligj”* përfshin ligjet dhe aktet më të ulëta se ligjet, apo aktet nënligjore, si dhe masat e ndërmarra nga autoritetet rregullatore profesionale bazuar në kompetencat e tyre të deleguara nga Kuvendi. Për më tepër, sipas GJEDNJ-së, *“ligji”* duhet kuptuar që të përfshijë ligjet *“statutore”*, por gjithashtu edhe *“aktet nënligjore”* dhe *“precedentet gjyqësore”*. Si përmbledhje, termi *“ligj”* janë dispozitat në fuqi ashtu si i kanë interpretuar gjykatat (shih, *mutatis mutandis*, rastet e GJEDNJ-së [Gulcu kundër Turqisë](#), nr. 17526/10, Aktgjykim i 19 janarit 2016, paragrafi 104; dhe [Leyla Şahin kundër Turqisë](#), nr. 44774/98, Aktgjykim i 10 nëntorit 2005, paragrafi 84; shih gjithashtu rastin e Gjykatës [K127/20](#), parashtrues *Lëvizja Vetëvendosje!*, Aktgjykim i 22 korrikut 2020, paragrafi 68).
190. Gjykata në vijim do të paraqesë rastet e GJEDNJ-së, ku përmes praktikës gjyqësore është shtjelluar kriteri *“i përcaktuar me ligj”*, dhe mënyrën se si GJEDNJ e analizon se a është një kufizim ose *“ndërrhyrje”* e ndërmarrë e përcaktuar me/në ligj apo jo. Ndonëse çështjet faktike të atyre rasteve dallojnë nga rrethanat e rastit konkret, i rëndësishëm ngelet interpretimi i përgjithshëm i kriterit *“i përcaktuar me ligj”*, që GJEDNJ i referohet në praktikën e saj gjyqësore. Ky interpretim i GJEDNJ-së është afirmuar edhe në praktikën gjyqësore të vetë Gjykatës (shih, ndër të tjera, rastet e Gjykatës [KO131/12](#), parashtrues, *Shaip Muja dhe 11 deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës*, Aktgjykim i 15 marsit 2013; [KO108/13](#), parashtrues, *Albulena Haxhiu dhe 12 deputetë të tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës*, Aktgjykim i 3 shtatorit 2013; [KO01/17](#), parashtrues, *Aida Dërguti*

dhe 23 deputetë të tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës, cituar më lart; [KO157/18](#), parashtres, parashtres Gjykata Supreme, cituar më lart; [KO54/20](#), parashtres, Presidenti i Republikës së Kosovës, cituar më lart; dhe, [KO93/21](#), parashtres, Blerta Deliu-Kodra dhe 12 Deputetë të Tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës, cituar më lart).

191. GJEDNJ ka theksuar se: “shprehja “në pajtim me ligjin” jo vetëm që kërkon që masa e kontestuar duhet të ketë një bazë në të drejtën e brendshme, por gjithashtu i referohet cilësisë së ligjit në fjalë, duke kërkuar që ai duhet të jetë i arritshëm për personat në fjalë dhe i parashikueshëm sa i përket efekteve të tij.” Më tutje, GJEDNJ, kishte theksuar se: “një rregull është “i parashikueshëm” kur siguron një masë të mbrojtjes kundër ndërhyrjeve arbitrare nga autoritetet publike” dhe se një ligj “i cili jep një diskrecion duhet të tregojë fushën e këtij diskrecioni, megjithëse procedurat dhe kushtet e hollësishme që duhen respektuar jo domosdoshmërisht duhet të përfshihen në rregullat e së drejtës materiale.” (shih, ndër të tjera, rastin e GJEDNJ-së [Tommaso kundër Italisë](#), nr. 43395/09, Aktgjykim i 23 shkurtit 2017, paragrafët 106-109 dhe referencat e cituara aty).
192. Gjykata në kontekst të vlerësimit të “përcaktueshmërisë me ligj”, duke iu referuar praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, vëren se ky kriter duhet të përmbajë të paktën elementet në vijim: (i) ekzistimi i një baze të qartë ligjore; (ii) parashikueshmërinë e kufizimit përkatës (shih rastin e GJEDNJ-së [Kudrevičius dhe të tjerët kundër Lituanisë](#), nr. 3753/05, Aktgjykim i 15 tetorit 2015, paragrafi 109); (iii) ekzistencën e masave mbrojtëse nga ndërhyrja, përkatësisht kufizimi i të drejtave nga autoritetet publike; dhe (iv) qartësinë e mjaftueshme në ligj përkitazi me diskrecionin e autoritetit publik lidhur me mundësinë e kufizimit dhe mënyrën e ushtrimit të këtij diskrecioni (shih rastin e GJEDNJ-së, [Navalnyy kundër Rusisë](#), nr. 29580/12, 36847/12, 11252/13, 12317/13, 43746/14, Aktgjykim i 15 nëntorit 2018, paragrafët 115-119).
193. Në rastin KO01/17 të Gjykatës, në paragrafin 90, përkitazi me kushtin që kufizimi duhet të jetë i përcaktuar me ligj, Gjykata kishte theksuar se: “Kufizimi i pretenduar i të drejtës së veteranëve të UÇK-së për pension është paraparë me nenin 3 (2) të ligjit të kontestuar të miratuar nga Kuvendi, i cili është institucioni shtetëror të cilin Kushtetuta e ka veshur me ushtrimin e pushtetit legjislativ. Rrjedhimisht, Gjykata vlerësoi se kufizimi i tillë është në përputhje me kërkesat e përfshira në nenin 55.1 të Kushtetutës, dhe për pasojë përfundoi se kufizimi i të drejtës së veteranëve të UÇK-së për pension është paraparë me ligj.” (shih [KO01/17](#), parashtres Aida Dërguti dhe 23 deputetë të tjerë të Kuvendit, cituar më lart, paragrafi 90).
194. Në rastin e Gjykatës KO157/18, në paragrafët 93-96, përkitazi me kushtin që kufizimi duhet të jetë i përcaktuar me ligj, Gjykata kishte theksuar se: “Kushtetuta në kapitullin II të saj iu ka dhënë rëndësi të posaçme të drejtave dhe lirive të njeriut dhe gjithashtu ka paraparë edhe rastet kur këto të drejta mund të kufizohen me ligj, nëse këtë e kërkon interesi i përgjithshëm i shoqërisë dhe i Shtetit”. Ndërkaq, në paragrafët vijues ku edhe e kishte bërë analizën se për rrethanat e atij rasti a ishte kufizimi i përcaktuar me ligj, Gjykata kishte theksuar se: “Sa i përket kufizimit të paraparë me ligj, Gjykata vëren se kufizimi i të drejtave në rastin konkret ishte paraparë me nenin 14, paragrafi 1.7 të Ligjit të kontestuar, i cili ishte miratuar nga Kuvendi, më 10 qershor 2010, institucion të cilin Kushtetuta e ka veshur me ushtrimin e pushtetit legjislativ. Prandaj, nisur nga fakti se një e drejtë e garantuar me kapitullin II të Kushtetutës mund të kufizohet me ligj, kur këtë e kërkon interesi i përgjithshëm, Gjykata konsideron se kufizimi i të drejtave është në pajtueshmëri me kërkesat e paragrafit 1, të nenit 55 të Kushtetutës. Gjykata konstaton se obligimi i kompanive të sigurimit për të pagur një përqind (1%) të primit nga sigurimet e automjeteve, në rastin konkret, ka qenë i paraparë me ligj.” (shih rastin [KO157/18](#), parashtres, Gjykata Supreme e Republikës së Kosovës, cituar më lart, paragrafët 95-96).

195. Në rastin KO108/13, në paragrafët 133-134, përkitazi me kushtin që kufizimi duhet të jetë i përcaktuar me ligj, Gjykata i ishte referuar rastit të GJEDNJ-së, [Centro Europa 7 S.R.L. dhe di Stefano kundër Italisë](#) (Aktgjykim i GJEDNJ-së, i 7 qershorit 2012), dhe kishte theksuar se: “[...] një normë nuk mund të konsiderohet si një ‘ligj’ përveç nëse është formuluar me përpikëri të mjaftueshme për t’i mundësuar qytetarit të rregullojë sjelljen e tij: ai duhet të jetë në gjendje, nëse ka nevojë me këshillimin e duhur – që të parashikojë, deri në një shkallë që është e arsyeshme sipas rrethanave, pasojat që mund të sjell një veprim i caktuar. [...]” (shih rastin e Gjykatës [KO108/13](#), parashtrues Albulena Haxhiu dhe 12 deputetë të tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës, cituar më lart).
196. Në rastin KO131/12, në paragrafin 130, përkitazi me kushtin që kufizimi duhet të jetë i përcaktuar me ligj, Gjykata kishte theksuar: “Kufizimi i pretenduar për të drejtën për punë është përfshirë në një ligj të miratuar nga Kuvendi i Kosovës, i cili është institucion shtetëror i veshur me pushtet legjislativ nga Kushtetuta. Si i tillë, kufizimi përputhet me kërkesën që kufizimi është dhënë nga ligji, siç përshkruhet në paragrafin 1 të nenit 55.” (shih rastin e Gjykatës [KO131/12](#), parashtrues Shaip Muja dhe 11 deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës, cituar më lart).
197. Në rastin KO131/12, në paragrafin 130, përkitazi me kushtin që kufizimi duhet të jetë i përcaktuar me ligj, Gjykata kishte theksuar: “Kufizimi i pretenduar për të drejtën për punë është përfshirë në një ligj të miratuar nga Kuvendi i Kosovës, i cili është institucion shtetëror i veshur me pushtet legjislativ nga Kushtetuta. Si i tillë, kufizimi përputhet me kërkesën që kufizimi është dhënë nga ligji, siç përshkruhet në paragrafin 1 të nenit 55.” (shih rastin e Gjykatës [KO131/12](#), parashtrues Shaip Muja dhe 11 deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës, cituar më lart).
198. Në rastin KO93/21, në paragrafin 312, përkitazi me kushtin që kufizimi duhet të jetë i përcaktuar me ligj, Gjykata kishte theksuar: “Bazuar në paragrafin 1 të nenit 55 të Kushtetutës, kufizimi i të drejtave të garantuara me Kushtetutë është i mundshëm, por ky kufizim duhet të bëhet ‘vetëm me ligj’, që nënkupton, ndër të tjera, që autoritetet e thirrura për të zbatuar një ligj ku parashihi kufizime, mund të zbatojnë kufizimet vetëm deri në masën sa është ‘përcaktuar me ligj’. Ky paragraf rrjedhimisht paraqet kushtin e parë dhe esencial i cili duhet të plotësohet për të përcaktuar se a është kushtetues një ‘kufizim’ i të drejtave dhe lirive themelore apo jo” (shih rastin e Gjykatës KO93/21 parashtrues, Blerta Deliu-Kodra dhe 12 Deputetë të Tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës, cituar më lart, paragrafi 312).

(ii) Aplikimi i parimeve të lartcekura në rastin konkret

199. Gjykata fillimisht rikujton që kategoria e pensioneve kontributpaguese është e përcaktuar përmes nenit 4 të Ligjit për Skemat Pensionale të Financuara nga Shteti. Kushtet dhe kriteret për njohjen e kësaj kategorie të pensionit janë të përcaktuar në nenit 8 të Ligjit të lartcekur, përkatësisht Ligjit të kontestuar. Ky i fundit, përcakton dy kategori kriteresh për përfitim të mundshëm të pensionit kontributpagues, përkatësisht kategorinë e përcaktuar përmes paragrafit 2 të nenit 8 të Ligjit të kontestuar dhe atë të përcaktuar përmes paragrafit 6 të nenit 8 të Ligjit të kontestuar. Më saktësisht, kategoria e parë janë të gjithë qytetarët e Kosovës dhe të cilët kanë stazh pensional kontributdhënës dhe dëshmi të vlefshme mbi pagesën e kontributeve bazuar në ligjin përkatës të ish KSAK-së para 1 janarit 1999 dhe të cilët i nënshtrohet kriterit të stazhit kontributdhënës prej pesëmbëdhjetë (15) vitesh, siç është përcaktuar përmes Udhëzimit të kontestuar Administrativ. Ndërsa, kategoria e dytë janë qytetarët e Kosovës të cilët kanë punuar në “sistemin e Republikës së Kosovës”, përkatësisht “punëtorët e arsimit, shëndetësisë dhe të tjerët”, të cilëve u njihet stazhi i punës për pension kontributpagues për periudhën 1989-1999.
200. Gjykata rikujton që neni 6 i Udhëzimit Administrativ të kontestuar, përcaktimin e kriterit për të provuar se janë paguar kontributet për një periudhë prej pesëmbëdhjetë (15) vitesh

e ka përvetësuar nga Ligji i ish KSAK-së, ku është përcaktuar kriteri i lartpërmendur prej pesëmbëdhjetë (15) viteve të stazhit pensional për të fituar të drejtën e pensionit kontributpagues.

201. Në kontekst të sqarimeve të dhëna më lart, Gjykata thekson se dallimi në trajtim në mes dy kategorive të lartcekura të qytetarëve të Kosovës, është “*i përcaktuar me ligj*”, përkatësisht në Ligjin për Skemat Pensionale të Financuara nga Shteti në lidhje me Udhëzimin Administrativ përkatës të kontestuar nga gjykata referuese. Si rrjedhojë, Gjykata konstaton se ekziston një “*dallim në trajtimin*” të punëtorëve që kanë punuar para vitit 1999 dhe nuk e kanë arritur stazhin pensional kontributpagues prej pesëmbëdhjetë (15) viteve për shkak të largimit nga puna në kohën e vendosjes së masave të dhunshme në Kosovë. Më saktësisht, përmes të njëjtit Ligj, përderisa kategorisë së përcaktuar përmes paragrafit 6 të nenit 8 të Ligjit të kontestuar i njihet stazhi i punës për pension kontributdhënës për vitet 1989-1999, për kategorinë e dytë, përkatësisht atë të përcaktuar përmes paragrafit 2 të nenit 8 të Ligjit të kontestuar, ky nuk është rasti.
202. Në vijim të këtij konstatimi, Gjykata duhet të vazhdojë me vlerësimin nëse “*dallimi në trajtim*” i lartcekur dhe i “*përcaktuar me ligj*”, ka ndjekur një “*qëllim legjitim*”, dhe nëse ky është rasti, duhet të vazhdojë me vlerësimin nëse masat e ndërmarra kanë qenë proporcionale me synimin për të arritur qëllimin.

(b) Nëse ekziston një qëllim legjitim

203. Bazuar në paragrafin 3 të nenit 55 të Kushtetutës por edhe parimet që burojnë nga praktika gjyqësore e GJEDNJ-së dhe e Gjykatës, përcaktohet që kufizimet e të drejtave dhe lirive të garantuara me Kushtetutë “*nuk mund të bëhen për qëllime të tjera, përveç atyre për të cilat janë përcaktuar.*” Sipas këtij paragrafi rezulton që, në parim, qëllimet e një kufizimi duhet të jenë qartësisht të përcaktuara dhe asnjë autoritet publik nuk mund të kufizojë ndonjë të drejtë apo liri mbi bazën e një qëllimi tjetër përtej atij që veçse është përcaktuar në ligjin në të cilin është lejuar kufizimi në pajtim me nenin 55 të Kushtetutës (shih, në këtë kuptim, rastin e Gjykatës [KO54/20](#), cituar më lart, paragrafi 193). Siç është sqaruar më lart, në vijim, Gjykata do të paraqes parimet e përgjithshme përkitazi me këtë kriter dhe do t'i aplikojë të njëjtat në rrethanat e rastit konkret (shih, gjithashtu dhe ndër të tjera, Aktgjykimin e Gjykatës në rastin [KO93/21](#), me parashtrues, *Blerta Deliu-Kodra dhe 12 Deputetë të Tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës*, cituar më lart, paragrafi 333).

(i) Parimet e përgjithshme

204. Gjykata thekson se në mënyrë që të arsyetohet dallimi në trajtim, sipas GJEDNJ-së kufizimi apo dallimi në trajtim, duhet të ketë një “*justifikim objektiv dhe të arsyeshëm*”, përkatësisht të jetë i bazuar në një qëllim legjitim (shih, ndër të tjera, rastet e GJEDNJ-së, [Molla Sali kundër Greqisë](#), nr. 20452/14, Aktgjykim i 18 qershorit 2020, paragrafi 135; dhe [Fabris kundër Francës](#), nr. 16574/08, Aktgjykim, i 7 shkurtit 2013, paragrafi 56). Për më tepër, sipas GJEDNJ-së shtetet duhet që të dëshmojnë që ekziston një marrëdhënie në mes të qëllimit legjitim të synuar dhe dallimit në trajtim të pretenduar nga parashtruesit përkatës (shih rastin e GJEDNJ-së, [Ünal Tekeli kundër Turqisë](#), nr. 29865/96, Aktgjykim i 16 nëntorit 2004, paragrafi 66).
205. GJEDNJ ka identifikuar se qëllimi legjitim, ndër të tjera, mund të përfshijë por nuk është i kufizuar në: (i) rivendosjen e paqes (shih, rastin e GJEDNJ-së, [Sejdić dhe Finci kundër Bosnje dhe Hercegovinës](#), cituar më lart, paragrafi 45); (ii) mbrojtjen e sigurisë kombëtare (shih, rastin e GJEDNJ-së [Konstatin Markin kundër Rusisë](#), nr. 30078/06, Aktgjykim i 22 marsit 2012, paragrafi 137); (iii) ruajtjen e stabilitetit ekonomik dhe ristrukturimin e borxhit në kontekst të krizës serioze politike, ekonomike dhe sociale (shih rastin e GJEDNJ-së, [Mamatas dhe të tjerët kundër Greqisë](#), nr. 63066/14, 64297/14, 66106/14, Aktgjykim i 21 korrikut 2016, paragrafi 103); apo (iv) mbrojtjen e të drejtave të të tjerëve

(shih rastin e GJEDNJ-së *Napotnik kundër Rumanisë*, nr. 33139/13, Aktgjykimi i 10 janarit 2021, paragrafët 79 dhe 86).

(ii) *Aplikimi i parimeve të lartcekura në rastin konkret*

206. Gjykata fillimisht thekson se në bazë të praktikës së Gjykatës dhe të GJEDNJ-së, për sa i përket barrës së provës në lidhje me pretendimin për diskriminim, Gjykata është shprehur se pasi kërkuesi ka treguar një *“dallim në trajtim”*, në rastin konkret Gjykata Supreme në cilësinë e gjykatës referuese, i takon Qeverisë të tregojë se ai dallim ishte i justifikuar (shih, ndër të tjera, rastin e GJEDNJ-së, [*D.H dhe të tjerët kundër Republikës Çeke*](#), nr. 57325/00, Aktgjykim i 13 nëntorit 2007, paragrafi 177).
207. Për këtë qëllim, në rrethanat e rastit konkret, Gjykata rikujton se njërën prej pyetjeve që ia kishte drejtuar MPMS-së kishte të bënte me shpjegimin e *“qëllimit legjitim”* lidhur me kriterin për stazh kontributpagues në periudhën pesëmbëdhjetë (15) vjeçare para 1 janarit 1999, siç përcakton Ligji i kontestuar në lidhje me Udhëzimin Administrativ të kontestuar.
208. Përgjigja e MPMS-së përkthet me *“qëllimin legjitim”* të përcaktimit të kriterit për stazh kontributpagues në periudhën prej pesëmbëdhjetë (15) viteve para 1 janarit 1999, mund të përmbledhet, ndër të tjera, si vijon: (i) fakti që Kosova ishte pjesë e sigurimit pensional dhe invalidor të ish-Jugosllavisë dhe sipas të njëjtit kërkohej që përfituesi të ketë së paku pesëmbëdhjetë (15) vite stazh kontributiv për realizimin e kësaj të drejte bazuar në Ligjin e ish KSAK-së; (ii) në vitin 2007, Qeveria e Kosovës, aprovoi Udhëzimin Administrativ nr. 11/2007 për njohjen e të drejtës në pension kontributpagues që po ashtu kërkonte sigurimin e provave materiale se janë paguar kontributet për së paku pesëmbëdhjetë (15) vite stazh kontributdhënës; dhe (iii) në vitin 2014, Kuvendi i Kosovës miratoi Ligjin për Skemat Pensionale të Financuara nga Shteti, me ç’ rast ishte konsoliduar mundësia për realizimin e së drejtës në pension kontributpagues, përkundër kriterëve shtesë të cilat ishin vendosur përmes Udhëzimit të kontestuar Administrativ.
209. Ndërsa, Gjykata vëren se qëllimi i *“dallimit në trajtim”* të dy kategorive të krahasueshme lidhur me njohjen e stazhit të punës gjatë viteve të 90-ta kishte të bënte me njohjen e kontributit të punëtorëve që kishin punuar në *“sistemin e Republikës së Kosovës”* gjatë viteve 1989-1999, duke iu llogaritur atë si stazh pune për qëllim të llogaritjes së stazhit pesëmbëdhjetë (15) vjeçar sipas Ligjit të kontestuar edhe pse të njëjtit, ashtu si edhe kategoritë e tjera, nuk kishin kontribuar në fondin pensional sipas Ligjit të ish KSAK, gjithnjë duke ruajtur stabilitetin ekonomik, qëllim ky që bazuar në praktikën e GJEDNJ-së dhe siç është sqaruar më lart, përbën një *“qëllim legjitim”* për trajtim të mundshëm ndryshe, përkatësisht kufizim të të drejtave dhe lirive themelore. Andaj, Gjykata pranon se *“dallimi në trajtim”* të cilin e ka aplikuar Kuvendi dhe MPMS-ja ndjek të paktën një *“qëllimin legjitim”* që është gjerësisht i pajtueshëm me objektivat e përgjithshme, përkatësisht mbrojtjen e sistemit ekonomik të vendit. Kjo sepse, është e padiskutueshme që pas vendosjes së Kosovës nën administrim ndërkombëtar, administrata ndërkombëtare së bashku me autoritetet e Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes në Kosovë, u përballën me një tërësi sfidash të lidhura me nevojën për të ngritur një sistem të qëndrueshëm të sigurimeve shoqërore, i kushtëzuar po ashtu edhe me kapacitetin e reduktuar buxhetor të vendit. Gjykata rikujton se pensioni kontributpagues nuk u prezantua deri në vitin 2007, përmes miratimit të UA-11/2007 për njohjen e të drejtës në pension kontributpagues, dhe më pas u kategorizua më tej në vitin 2014 përmes miratimit të Ligjit të kontestuar nga Kuvendi, përkatësisht gjashtë (6) vite pas shpalljes së pavarësisë së Republikës së Kosovës. Gjykata vlerëson se në kontekst të një pushteti legjislativ të sapokrijuar demokratik, mund të kishte nevojë për kohë për reflektim në një periudhë të tranzicionit demokratik për t’i mundësuar atij të shqyrtojë se çfarë masash kërkoheshin për të siguruar mirëqenien ekonomike të vendit (shih, *mutatis mutandis* rastet e GJEDNJ-

së, [Ždanoka kundër Letonisë](#), nr.58278/00, Aktgjykim i 16 marsit 2006, paragrafi 131; dhe [Andrejeva kundër Letonisë](#), nr. 55707/00, Aktgjykim i 18 shkurtit 2009, paragrafi 86).

210. Në këtë kontekst, Gjykata vëren që “*dallimi në trajtimin*” të cilin e ka aplikuar Kuvendi i Republikës së Kosovës përmes Ligjit të kontestuar dhe më pas, MPMS-ja përmes Udhëzimit Administrativ të kontestuar, ndjek të paktën një “*qëllim legjitim*” që është gjerësisht i pajtueshëm me objektivat e përgjithshme, përkatësisht mbrojtjen e sistemit ekonomik të vendit.

211. Rrjedhimisht, bazuar në të lartcekurat, dhe duke marrë parasysh që tashmë Gjykata konstatoi që: (i) “*dallimi në trajtim*” në mes dy kategorive të qytetarëve të Kosovës, përkatësisht atyre të përcaktuara përmes paragrafit 2 të nenit 8 të Ligjit të kontestuar dhe atyre të përcaktuara përmes paragrafit 6 të nenit 8 të Ligjit të kontestuar, është i “*përcaktuar me ligj*”; dhe (ii) ndjek të paktën një “*qëllim legjitim*”, përkatësisht dhe ndër të tjera, edhe atë të ruajtjes së stabilitetit ekonomik të vendit, në vijim, bazuar në praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së dhe atë të Gjykatës, mbetet për t'u përcaktuar nëse ka pasur një marrëdhënie të arsyeshme proporcionaliteti midis qëllimit legjitim të lartpërmendur dhe mjeteve të përdorura në rastin konkret.

(c) *Nëse ekziston një marrëdhënie e proporcionalitetit ndërmjet kufizimit të së drejtës dhe qëllimit që synohet të arrihet*

212. Bazuar në paragrafin 4 të nenit 55 të Kushtetutës por edhe parimet që burojnë nga praktika gjyqësore e GJEDNJ-së dhe e Gjykatës, është përcaktuar që me rastin e kufizimit të të drejtave dhe lirive themelore, krijohet përgjegjësi kushtetuese për autoritet publike që gjatë interpretimit dhe vendosjes në rastet para tyre, t'i kushtojnë kujdes esencës së të drejtës e cila është kufizuar, rëndësisë së qëllimit të kufizimit, natyrës dhe vëllimit të kufizimit, raportit midis kufizimit dhe qëllimit që synohet të arrihet, si dhe të shqyrtojnë mundësinë e realizimit të atij qëllimi me kufizim më të vogël (shih, ndër të tjera, rastin e Gjykatës, KO157/18, me parashtrues *Gjykata Supreme e Republikës së Kosovës*, të cituar më lart, paragrafi 102). Siç është sqaruar më lart, në vijim, Gjykata do të paraqesë parimet e përgjithshme përkitazi me këtë kriter dhe do t'i aplikojë të njëjtat në rrethanat e rastit (shih, gjithashtu dhe ndër të tjera, rastin e Gjykatës [KO93/21](#), parashtrues, *Blerta Deliu-Kodra dhe 12 Deputetë të Tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës*, cituar më lart, paragrafi 346).

(i) *Parimet e përgjithshme*

213. Gjykata vendos theksin në rëndësinë e qëllimit të kufizimit dhe marrëdhënien e proporcionalitetit ndërmjet kufizimit dhe qëllimit që synohet të arrihet. Në dritën e këtij kriteri, Gjykata po ashtu i referohet praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, përmes të cilës ka theksuar se dallimi në trajtim kërkon një ekuilibër të drejtë midis mbrojtjes së interesave të komunitetit dhe respektimit të të drejtave të individëve. Rrjedhimisht, GJEDNJ ka specifikuar se dallimi në trajtim kërkon një marrëdhënie të arsyeshme të proporcionalitetit midis masës së ndërmarrë dhe qëllimit që synohet që të arrihet (shih rastet e GJEDNJ-së, [Molla Sali kundër Greqisë](#), cituar më lart, paragrafi 135; [Fabris kundër Francës](#), nr. 16574/08, Aktgjykim i 7 shkurtit 2013, paragrafi 56; [Mazurek kundër Francës](#), nr. 34406/97, Aktgjykim i 1 shkurtit 2000, paragrafët 46 dhe 48; dhe [Larkos kundër Qipros](#), nr. 29515/95, Aktgjykim i 18 shkurtit 1999, paragrafi 29). Përgjatë kësaj vije argumentuese, GJEDNJ në rastin *Sejdić dhe Finci kundër Bosnje dhe Hercegovinës* kishte theksuar se: “[...] diskriminim do të thotë trajtim i pabarabartë, pa një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm, i personave në rrethana të ngjashme. Mungesa e justifikimit objektiv dhe të arsyeshëm, nënkupton që dallimi nuk ndjekë një qëllim legjitim, ose që nuk ka marrëdhënie të arsyeshme proporcionaliteti në mes të mjeteve të përdorura dhe qëllimeve që dëshirohet të arrihen” (shih rastin e GJEDNJ-së, [Sejdić dhe Finci kundër Bosnje dhe Hercegovinës](#), cituar më lart, paragrafi 42).

214. Gjykata gjithashtu rikujton që GJEDNJ ka vënë gjithashtu në pah se nuk është roli i saj që të zëvendësojë autoritetet kompetente vendore në vlerësimin se deri në cilën masë dallimet në situata të ngjashme kanë justifikuar një dallim në trajtim dhe se në raste të tilla shtetet gëzojnë një hapësirë të vlerësimit (*margin of appreciation*). Fushëveprimi i kësaj hapësire të vlerësimit, sipas GJEDNJ-së do të jetë në varësi të rrethanave, objektit të vlerësimit dhe specifikave të rastit (shih rastet e GJEDNJ-së: [Molla Sali kundër Gregisë](#), cituar më lart, paragrafi 136; dhe [Carson dhe të tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar](#), cituar më lart, paragrafi 61).
215. Në njërën anë, GJEDNJ ka specifikuar disa fusha ku hapësira e vlerësimit vazhdon të jetë e gjerë. Për shembull, GJEDNJ ka theksuar se për shkak të njohurisë së shoqërisë dhe nevojave të saja, autoritetet vendore në parim janë në pozicion më të mirë se gjyqtarët ndërkombëtarë të vlerësojnë se çka është në interes publik në aspektin ekonomik dhe social, dhe GJEDNJ do të respektojë zgjedhjen e ligjvënësit përveç nëse është qartazi pa bazë të arsyeshme (shih rastet e GJEDNJ-së, [Belli and Arquier-Martinez kundër Zvicrës](#), nr. 65550/13, Aktgjykim i 11 dhjetorit 2018, paragrafi 94; [Burden dhe Burden kundër Mbretërisë së Bashkuar](#), nr. 13378/05, Aktgjykim i 12 dhjetorit 2006, paragrafi 60; dhe, [Carson dhe të tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar](#), cituar më lart, paragrafi 61).
216. Rrjedhimisht, sipas GJEDNJ-së, një margjinë apo hapësirë e gjerë zakonisht lejohet kur është fjala për masa të përgjithshme të strategjisë ekonomike apo sociale, përveç nëse ato janë qartazi pa asnjë bazë të arsyeshme (shih rastin e GJEDNJ-së [Burden dhe Burden kundër Mbretërisë së Bashkuar](#), cituar më lart, paragrafi 60; dhe rastin [KO01/17](#), parashtrues, *Aida Dërguti dhe 23 deputetë të tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës*, cituar më lart, paragrafi 76).
- (ii) *Aplikimi i parimeve të lartcekura në rastin konkret*
217. Gjykata fillimisht thekson se në kohën kur është përcaktuar stazhi kontributpagues prej pesëmbëdhjetë (15) vitesh përmes Ligjit të ish KSAK-së, mund të mos ketë pasur karakter diskriminues. Efekti i mundshëm diskriminues i kësaj dispozite megjithatë duhet të vlerësohet në dritën e rrethanave faktike dhe juridike të viteve të 90-ta në Kosovë, përgjatë të cilave, nuk është kontestuese që ka pasur “[...] *largim diskriminues të zyrtarëve të etnisë shqiptare, nga pozitat profesionale, administrative dhe të zanatit në ndërmarrjet në pronësi të Shtetit dhe institucioneve publike, përfshirë mësimdhënësit nga sistemi shkollor i qeverisur nga Serbia si dhe mbylljen e shkollave të mesme dhe universitetit shqiptar*” (shih, ndër të tjera, Rezolutën A/RES/48/153 të 7 shkurtit 1994, të miratuar Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara, faqe 6, paragrafi 18, pika (b); shih, gjithashtu raportin e Institucionit të Avokatit të Popullit të 6 prillit 2018).
218. Gjykata vlerëson se kushti i të provuarit se janë paguar kontributet për pesëmbëdhjetë (15) vite dhe e kufizuar në aspekt kohor deri më 1 janar 1999, nuk është në përputhje me realitetin e krijuar gjatë viteve të 90-ta për shkak të masave të dhunshme, trazirave dhe luftës së viteve 1998-99. Siç u përmend më lart, kriteri prej pesëmbëdhjetë (15) vitesh për të provuar se janë paguar kontributet pensionale do të ishte kriter i arsyeshëm dhe proporcional sepse, ligjvënësi ka të drejtë dhe prerogativë që të vë kushte për fitimin e të drejtave që ndërlidhen me kategoritë e pensioneve. Mirëpo, duke pasur parasysh ligjet në fuqi diskriminuese përgjatë viteve të 90-ta si rezultat i të cilave pjesa dërmuese e të punësuarve shqiptarë ishin të larguar dhunshëm nga funksionet që mbanin, përvetësimi dhe zbatimi formal i kriterit të dëshmisë së pagesës së kontributeve pesëmbëdhjetë (15) vite deri më 1 janar 1999 nga Ligji i ish KSAK-së përmes Ligjit të kontestuar dhe Udhëzimit të kontestuar Administrativ, në rrethana të viteve të 90-ta, vë barrë joproporcionale ndaj kategorive të qytetarëve që pretendojnë të gëzojnë të drejtën e pensionit kontributpagues.
219. Për më tepër dhe siç është sqaruar më lart, e drejta e stazhit pensional kontributpagues për vitet 1989-1999, u është njohur punëtorëve të “*arsimit, punëtorëve të shëndetësisë dhe të*

tjerëve që punuan në sistemin paralel të Republikës së Kosovës”, për shërbimin e tyre gjatë viteve 1989/90 deri 1998/99, ndërsa të gjitha kategoritë tjera që kanë punuar gjatë viteve të 90-ta, të cilët janë dëbuar nga puna bazuar në ligje diskriminuese të aplikueshme përgjatë viteve të 90-ta dhe rrjedhimisht, u janë nënshtruar pamundësisë objektive për të realizuar dhe dëshmuar pagesën e kontributeve pensionale për pesëmbëdhjetë (15) vite deri në vitin 1999, u kërkohet dëshmia e stazhit të punës përmes pagesës së kontributeve respektive.

220. Për sa i përket krahasimit të dy kategorive të lartcekura, Gjykata vlerëson se bazuar në praktikën gjyqësore të konsoliduar të GJEDNJ-së, kriteri për të demonstruar situatë të krahasueshme nuk kërkon që grupet krahasuese të jenë identike. Ankuesit duhet të provojnë se, duke pasur parasysh natyrën e veçantë të ankesave të tyre, ata kanë qenë në pozitë të krahasueshme në mënyrë relevante me të tjerët që janë trajtuar ndryshe (shih rastin e GJEDNJ-së, [*Fabián kundër Hungarisë*](#), cituar më lart, paragrafi 113; [*Clift kundër Mbretërisë së Bashkuar*](#), nr. 7205/07, Aktgjykim i 13 korrikut 2010, paragrafi 66). Elementet që karakterizojnë situatë të ndryshme, dhe përcaktojnë krahasueshmërinë e tyre, duhet të vlerësohen duke pasur parasysh objektin e kërkesës dhe qëllimin e masës që bën dallimin në fjalë (shih rastin e GJEDNJ-së, [*Fabián kundër Hungarisë*](#), cituar më lart, paragrafi 121). Me fjalë të tjera, analiza e çështjes nëse dy persona ose grupe janë në situatë të krahasueshme për qëllime të analizës të trajtimit të ndryshëm dhe diskriminues është specifike dhe kontekstuale (shih ndër të tjera, Udhëzuesin për nenin 14 të KEDNJ-së dhe nenin 1 të Protokollit Nr. 12, Ndalimi i diskriminimit, përditësuar më 31 gusht 2020, pika A. Dallimi në trajtim, paragrafi 54).
221. Në këtë drejtim, Gjykata vlerëson se: (i) Ligji i kontestuar bën dallimin në mes dy kategorive qytetarësh në kontekst në kategorisë së pensionit kontributpagues, duke përcaktuar, në njërin anë, se stazhi i punës për pension kontributpagues për vitet 1989-1999, njihet për *“punëtorët e arsimit, shëndetësisë dhe të tjerëve që kanë punuar në sistemin e Republikës së Kosovës”*, ndërsa në anën tjetër, duke përcaktuar se për kategoritë e tjera të qytetarëve, kriteret për njohjen e stazhit përkatës kontributpagues duhet të përcaktohen me akt nënligjor; (ii) bazuar në këtë Ligj të kontestuar, akti respektiv nënligjor, përkatësisht, Udhëzimi i kontestuar Administrativ, përvetëson dhe zbaton kriterin për pagesën e kontributeve prej pesëmbëdhjetë (15) vitesh deri më 1 janar 1999 nga Ligji i ish KSAK-së, pa zhvilluar ndonjë analizë të rrethanave diskriminuese përgjatë viteve të 90-ta, në esencë, duke përjashtuar nga kjo e drejtë kategorinë e qytetarëve që janë dëbuar dhunshëm nga vendet përkatëse të punës dhe të cilat nuk kanë *“punuar në sistemin e Republikës së Kosovës”*; (iii) përkundër faktit që Ligji i kontestuar, në paragrafin 2 të nenit 8 të tij, saktëson që kriteret dhe kushtet për fitimin e të drejtës në pension kontributpagues sipas *“kohëzgjatjes së pagesës së kontributit”* përmes një akti nënligjor, ky i fundit, përkatësisht Udhëzimi i kontestuar Administrativ, thjeshtë adapton një kriter prej pesëmbëdhjetë (15) vitesh, duke e aplikuar në rrethana historike dhe politike, në kontekst të të cilave, realizimi i këtij kriteri, ishte pamundësuar në mënyrë diskriminuese për shumicën e qytetarëve; dhe (iv) i njëjti Ligj, siç është sqaruar më lart, përcakton financimin nga buxheti i Republikës së Kosovës, për të gjitha kategoritë e pensioneve, duke përfshirë edhe atë kontributpagues, pa marrë parasysh kontributet e punëtorëve në fondin përkatës pensional bazuar në Ligjin e ish KSAK-së. Rrjedhimisht, Gjykata vëren se megjithëse skema pensionale quhet kontribuuese, shuma e pensionit dhe kategorizimi nuk ka të bëjë me shumën e kontributit të paguar para vitit 1999, pasi që e njëjta është plotësisht e mbuluar nga buxheti i shtetit të Republikës së Kosovës.
222. Gjykata po ashtu rikujton faktin që MPMS-ja në përgjigjen e saj dërguar Gjykatës kishte theksuar se kanë: *“„hartuar një udhëzim administrative të ri me të cilin parashihen disa ndryshime substanciale në kuptim të realizimit të pensionit kontributiv siç janë:-njohja e periudhës 1990 deri 31.12/1998 si stazh kontributiv për të gjithë të dëbuarit nga puna nga administrate e dhunshme serbe; si dhe njohja e diplomave deri në vitin 1998”*. Kjo

përgjigje është reflektim i qartë edhe i vet MPMS-së lidhur me joproportionalitetin e masave të vendosura përmes Ligjit të kontestuar.

223. Bazuar në të lartcekurat, Gjykata vlerëson se kushti i përcaktuar nga Ligji dhe Udhëzimi Administrativ i kontestuar për të ofruar dëshmi se janë paguar kontributet së paku pesëmbëdhjetë (15) vite deri më 1 janar 1999 për kategorinë e qytetarëve të përcaktuar përmes paragrafit 2 të nenit 8 të Ligjit të kontestuar në raport me atë të përcaktuar përmes paragrafit 6 të nenit 8 të Ligjit të kontestuar, nuk është proporcional sepse: (i) nuk merr parasysh aplikimin e ligjeve diskriminuese përgjatë viteve të 90-ta dhe përvetëson dhe zbaton në mënyrë automatike kushtin e dëshmisë për pagesën e kontributeve prej së paku pesëmbëdhjetë (15) vitesh deri më 1 janar 1999 nga Ligji përkatës i ish KSAK-së; (ii) punëtorët e kategorive të tjera që kanë punuar gjatë viteve të 90-ta në ndërmarrjet shoqërore, gjyqësi, polici, administratë, pozita profesionale dhe të zanatit, të cilët ishin larguar nga puna si rezultat i masave të dhunshme, dhe të cilëve iu pamundësua pagimi i kontributeve pensionale, nuk u njihet stazhi i punës për pension kontributpagues në vitet 1989-1999, derisa kategorisë së *“punëtorëve të arsimit, shëndetësisë dhe të tjerëve që punuan në sistemin paralel të Republikës së Kosovës”*, i njihet kjo e drejtë; dhe (iii) megjithëse skema quhet kontribuuese, shuma e pensionit dhe kategorizimi nuk ka të bëjë me shumën e kontributit të paguar para vitit 1999, pasi që e njëjta është plotësisht e mbuluar nga buxheti i Republikës së Kosovës.
224. Mbi këtë bazë, Gjykata konstaton se kushti i ofrimit të dëshmive për pagesë të kontributeve prej së paku pesëmbëdhjetë (15) vitesh para 1 janarit 1999 i përcaktuar me Ligjin dhe Udhëzimin Administrativ të kontestuar, dhe i cili është përvetësuar brenda sistemit juridik të Republikës së Kosovës në mënyrë krejtësisht formaliste dhe duke mos marrë parasysh rrethanat diskriminuese në Kosovën e viteve të 90-ta, nuk mund të konsiderohet i domosdoshëm dhe proporcional.
225. Rrjedhimisht, Gjykata konstaton se paragrafi 2 i nenit 8 të Ligjit të kontestuar në lidhje me nënparagrafin 2.3 paragrafin 2 të nenit 6 të Udhëzimit Administrativ të kontestuar, nuk janë në përputhshmëri me nenin 24 [Barazia para Ligjit] të Kushtetutës në ndërlidhje me nenin 14 të KEDNNJ-së dhe nenin 1 të Protokollit nr. 12 të KEDNJ-së.
226. Gjykata gjithashtu vëren që Gjykata referuese: (i) konteston edhe kushtetutshmërinë e nenit 5 të Udhëzimit të kontestuar Administrativ; dhe (ii) pretendon që nenet e kontestuarat të Ligjit të kontestuar në lidhje me Udhëzimin përkatës Administrativ janë në kundërshtim me nenin 46 të Kushtetutës në lidhje me nenin 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së.
227. Përkritazi me çështjen e parë, përkatësisht kundërkushtetutshmërinë e nenit 5 të Udhëzimit Administrativ, Gjykata fillimisht vëren që aplikueshmëria e këtij neni ndërlidhet me kategorinë e qytetarëve të përcaktuar përmes paragrafit 2 të nenit 8 të Ligjit të kontestuar dhe përcakton kualifikimin e shfrytëzuesve të pensionit kontributpagues, duke saktësuar: (i) kualifikimet përkatëse në katër (4) paragrafët e parë; dhe (ii) detyrimin që të gjitha dëshmitë për kualifikimet përkatëse duhet të jenë para 1 janarit 1991 në paragrafin e pestë të tij. Kontestuese në rrethanat e këtij paragrafi, përkatësisht paragrafit 5 të nenit 5 të Udhëzimit Administrativ të kontestuar është arsyeshmëria e përcaktimit të datës 1 janar 1991, si datë përfundimtare mbi bazën e të cilës duhet të vlejnjë dëshmitë e përcaktuara me katër (4) paragrafët e parë të nenit 5 të Udhëzimit Administrativ të kontestuar. Thënë këtë, as Gjykata referuese, as Opinioni i referuar në këtë Aktgjykim i Avokatit të Popullit i vitit 2018 dhe as përgjigjet e MPMS-së, nuk sqarojnë arsyeshmërinë e kësaj date dhe arsyet mbi bazën e të cilave një e tillë mund të jetë diskriminuese dhe për pasojë në kundërshtim me Kushtetutën. Megjithatë, në plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit të kontestuar në lidhje me Udhëzimin e kontestuar Administrativ, siç është përcaktuar përmes këtij Aktgjykimi, asgjë nuk ndalon autoritet përkatës të Republikës së Kosovës, që të rivlerësojnë arsyeshmërinë e nenit 5 të Udhëzimit Administrativ të kontestuar në kuptim të

proporcionalitetit të nevojshëm të aplikuar për të gjitha kategoritë e qytetarëve që mund të jenë përfitues të pensionit kontributpagues sipas përcaktimeve të Ligjit për Skemat Pensionale të Financuara nga Shteti dhe plotësim/ndryshimeve të tij sipas këtij Aktgjykimi.

228. Ndërsa, përkitazi me çështjen e dytë, përkatësisht pretendimet që nenet e kontestuar të Ligjit të kontestuar në lidhje me Udhëzimin e kontestuar Administrativ janë gjithashtu në kundërshtim me nenin 46 të Kushtetutës në lidhje me ne nenin 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së, Gjykata thekson se duke u bazuar në praktikën e saj gjyqësore, duke marrë parasysh që tashmë ka konstatuar që paragrafi 2 i nenit 8 të Ligjit të kontestuar në lidhje me nënparagrafin 2.3 paragrafin 2 të nenit 6 të Udhëzimit Administrativ të kontestuar, nuk janë në përputhshmëri me nenin 24 [Barazia para Ligjit] të Kushtetutës në ndërlidhje me nenin 14 të KEDNJ-së dhe nenin 1 të Protokollit nr. 12 të KEDNJ-së, nuk është e nevojshme të vlerësohen edhe pretendimet për kundërkushtetutshmërinë e dispozitave të kontestuara me nenin 46 të Kushtetutës në lidhje me ne nenin 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së.
229. Në fund, Gjykata thekson se: (i) vështirësitë e ligjvënësit në miratimin e një kuadri ligjor gjithëpërfshirës në sferën e pensioneve dhe trajtimi i të gjitha çështjeve respektive e komplekse, nuk e lirojnë Shtetin e Kosovës nga obligimet që burojnë nga Kushtetuta (shih rastet e GJEDNJ-së, [Schirmer kundër Polonisë](#), nr. 68880/01, Aktgjykim i 21 shtatorit 2004, paragrafi 38; dhe [Skibiński kundër Polonisë](#), nr. 52589/99, Aktgjykim i 14 nëntorit 2006, paragrafi 96). Thënë kështu, Gjykata thekson se ligjvënësi ka “hapësirë të gjerë të vlerësimit” gjatë nxjerrjes së ligjeve në kontekst të ndryshimit të regjimit politik dhe ekonomik (shih rastin e GJEDNJ-së, [Kopecký kundër Sllovakisë](#), nr. 44912/98, Aktgjykim i 28 shtatorit 2004, paragrafi 35) si dhe në kontekst të tranzicionit të vendit drejt një regjimi demokratik (shih, rastin e GJEDNJ-së, [Broniowski kundër Polonisë](#), nr. 31443/96, Aktgjykim i 28 shtatorit 2005, paragrafi 182).
230. Gjykata thekson se, në pajtim edhe me praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, nuk është brenda fushëveprimit të saj që të zëvendësojë politikat publike të përcaktuara nga ligjvënësi. Gjykata po ashtu thekson se nuk është detyrë e saj që të përcaktojë politikat sociale dhe pensionale, pasi që kjo është detyrë dhe prerogativë e dy pushteteve tjera, përkatësisht atij ekzekutiv dhe legjislativ. Detyrë e Gjykatës në rastin konkret është që të vlerësojë nëse Ligji dhe Udhëzimi Administrativ i kontestuar janë në përputhje me Kushtetutën. Duke qenë se Gjykata ka konstatuar se dispozitat përkatëse të Ligjit të kontestuar në lidhje me Udhëzimin Administrativ përkatës nuk janë në përputhje me Kushtetutën, i takon pushtetit ekzekutiv dhe legjislativ që të përcaktojë kritere proporcionale dhe të arsyeshme lidhur me fitimin e statusit të pensionistit kontributpagues.

Efektet e këtij Aktgjykimi

231. Gjykata fillimisht i referohet nenit 116 [Efekti Juridik i Vendimeve] të Kushtetutës, që përcakton se: (i) Vendimet e Gjykatës Kushtetuese janë të detyrueshme për gjyqësorin dhe të gjithë personat dhe institucionet e Republikës së Kosovës; (ii) përderisa procedura të mos përfundojë para Gjykatës Kushtetuese, ajo mund të suspendojë përkohësisht veprimin ose ligjin e kontestuar, derisa të merret vendimi i Gjykatës, nëse konsideron që aplikimi i ligjit të kontestuar, mund të shkaktojë dëme të pariparueshme; (iii) përveç nëse është caktuar ndryshe me vendim të Gjykatës Kushtetuese, shfuqizimi i ligjit, i aktit ose i veprimit hyn në fuqi në ditën e publikimit të vendimit të Gjykatës; dhe (iv) vendimet e Gjykatës kushtetuese shpallen në Gazetën Zyrtare. Bazuar në këtë dispozitë kushtetuese dhe praktikën së konsoliduar gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese, në rast se kjo e fundit përcakton se akti i kontestuar para Gjykatës është në kundërshtim me Kushtetutën, shfuqizimi i aktit përkatës hyn në fuqi në ditën e publikimit të Aktgjykimit përkatës të

Gjykatës, përpos nëse, siç është përcaktuar me Kushtetutë, Gjykata Kushtetuese përmes Aktgjykimit përkatës, përcakton ndryshe.

232. Gjykata rikujton se efekti juridik i hyrjes në fuqi të vendimeve të Gjykatës Kushtetuese, është trajtuar nga Komisioni i Venedikut në opinionet e tij, lidhur me efektet kohore të, ndër të tjera, vendimeve të Gjykatave Kushtetuese (shih, ndër të tjera, CDL-AD (2018)012 Opinion *Amicus Curia* për Gjykatën Kushtetuese të Gjeorgjisë lidhur me Efektet e Vendimeve në Çështjet Civile dhe Administrative). I njëjti, ndër të tjera, trajton efektet kohore në kuptim të: (i) efekteve të moderuara *ex tunc*; (ii) efekteve strikte *ex nunc*; (iii) efekteve të moderuara *ex nunc*; dhe (iv) rregullit “*të rastit në shqyrtim*”.
233. Në parim, bazuar në raportin e lartcekur dhe për aq as është relevante për rrethanat e rastit konkret: (i) efektet retroaktive të vendimeve gjyqësore duhet të evitohen sepse mund të kenë pasoja në parimin e sigurisë juridike; (ii) vendimet gjyqësore të formës së prerë të bazuar në ligjin/dispozitën përkatëse që më pas është shpallur jokushtetuese, në parim, nuk përfitojnë nga shpallja jokushtetuese e normës përkatëse; (iii) që në shërbim të parimit të sigurisë juridike, në parim, një normë përkundër faktit që është shpallur jokushtetuese, mund të vazhdojë të jetë në fuqi dhe të vazhdojë të aplikohet, derisa ligjvënësi të ketë amendamentuar normën përkatëse në përputhje me Aktgjykimin e një Gjykate dhe përputhje me afatin e dhënë nga ajo; dhe që (iv) megjithatë, Gjykatat Kushtetuese përkatëse duhet të kenë fleksibilitet të mjaftueshëm për të vendosur vet balancin e duhur, në varësi të rrethanave të rasteve konkrete, përkritazi me të drejtat individuale në njërën anë dhe parimin e sigurisë juridike në anën tjetër.
234. Një qasje e tillë është sqaruar para Gjykatës edhe përmes përgjigjeve të shumicës së Gjykatave Kushtetuese anëtare të Komisionit të Venedikut. Siç është sqaruar në këtë Aktgjykim, me qëllim të përcaktimit të saktë të efekteve juridike të këtij Aktgjykimi, Gjykata ka kërkuar edhe mendimin e shteteve anëtarë të Forumit të Komisionit të Venedikut. Përgjigjet e detajuara të këtyre shteteve janë paraqitur në paragrafët 62 deri 130 të këtij Aktgjykimi. Emëruesi i përbashkët i përgjigjeve përkatëse, në parim, reflekton që këto Gjykata Kushtetuese, kanë një fleksibilitet të caktuar përkritazi me përcaktimin e momentit të hyrjes në fuqi të Aktgjykimeve përkatëse dhe efekteve kohore të të njëjtave. Për rrethanat e rastit konkret, është relevante praktika e konsoliduar e Gjykatave Kushtetuese respektive në kontekst të: (i) shmangies së pasojave nga anulimi i menjëhershëm i një dispozitë ligjore duke i lënë mundësinë pushteteve tjera, përkatësisht atij ekzekutiv dhe legjislativ, që të ndërmarrin masat e nevojshme për amendamentimin e normës së shpallur jokushtetuese në përputhje me Kushtetutën edhe Aktgjykimin përkatës të Gjykatës Kushtetuese; (ii) efektit të një Aktgjykimi të një Gjykate që shpallë një normë jokushtetuese në lëndët në pritje para gjykatave të rregullta dhe rregulli i “*rastit në shqyrtim*”; dhe (iii) efekteve prapavepruese ose jo të Aktgjykimeve përkatëse.
235. Përkritazi me hyrjen në fuqi të Aktgjykimit që shpall një ligj/dispozitë në kundërshtim me Kushtetutën, shumica dërmuese e përgjigjeve të dorëzuara nga Forumi i Komisionit të Venedikut, në përputhje edhe me Opinionet relevante të Komisionit të Venedikut, ndër të tjera, saktësojnë që: (i) Kushtetuta ose ligji përkatës i aplikueshëm, i mundësojnë Gjykatës Kushtetuese, që varësisht nga rrethanat e rasteve konkrete, të përcaktojnë vet ditën e hyrjes në fuqi të Aktgjykimit përkatës dhe/ose të anulimit/shfuqizimit të dispozitës përkatëse që është vlerësuar në kundërshtim me Kushtetutën; (ii) në parim, ligjet/dispozitat përkatëse të cilat janë vlerësuar në kundërshtim me Kushtetutën, duhet të shfuqizohen menjëherë dhe të eliminohen nga sistemi përkatës juridik; por që (iii) megjithatë, për të shmangur pasojat e paparashikueshme të një anulimi të menjëhershëm të ligjit/dispozitës së kontestuar, ndonjëherë është e nevojshme të shtyhet zbatimi/hyrja në fuqi i një Aktgjykimi të Gjykatës Kushtetuese.
236. Në rrethana të tilla, Gjykata Kushtetuese, përkundër faktit që ka vlerësuar një ligj/dispozitë përkatëse në kundërshtim me Kushtetutën, të njëjtën e lë në fuqi për një kohë

të caktuar, nëse vlerëson se zbrazëtia ligjore/juridike e shkaktuar nga shfuqizimi i menjëhershëm i ligjit/dispozitës specifike të kontestuar, do të ishte në kundërshtim me parimin e proporcionalitetit, të sigurisë juridike dhe të sundimin e ligjit. Në këtë mënyrë, Gjykata i mundëson pushtetit legjislativ një kohë të caktuar, që mund të shtrihet, bazuar në rrethanat e rasteve konkrete, prej dy (2) deri në tetëmbëdhjetë (18) muaj, në mënyrë që i njëjti të amendamentojë ligjin/dispozitën përkatëse në përputhje me Kushtetutën dhe Aktgjykimin përkatës të Gjykatës Kushtetuese. Bazuar në shumicën dërmuese të përgjigjeve të Gjykatave Kushtetuese anëtare të Forumit të Komisionit të Venedikut, gjatë kësaj periudhe ligji i shpallur jokushtetues mbetet pjesë e rendit juridik dhe është ende i detyrueshëm për të gjitha autoritetet publike.

237. Përkitazi me rastet në pritje/përkatësisht të pazgjidhura para gjykatave të rregullta përgjatë periudhës brenda së cilës Gjykata ka vlerësuar një ligj/dispozitë përkatëse si jokushtetuese por shfuqizimi i të njëjtës ende nuk ka hyrë në fuqi, duke marrë parasysh kohën e nevojshme të akorduar për veprimin përkatës të pushtetit legjislativ, përgjigja e pjesës dërmuese të Gjykatave Kushtetuese anëtare të Forumit të Komisionit të Venedikut, në parim, saktësojë që autoritetet publike dhe/ose gjykatat, duhet të vazhdojnë procedurat dhe nëse është e mundur, të zbatojnë drejtpërdrejt dispozitat përkatëse të ligjeve kushtetuese ose Kushtetutës në vend të dispozitës/ligjit të vlerësuar si kundërkushtetues nga Gjykata Kushtetuese. Nëse një zbatim i tillë i drejtpërdrejtë i normave kushtetuese nuk është i mundur/përshtatshëm, gjykatat nuk kanë zgjidhje tjetër veçse të zbatojnë ligjin jokushtetues për aq sa i njëjti mbetet në fuqi. Thënë këtë, në parim, në raste të kontrollit incidental, bazuar në Opinionet e Komisionit të Venedikut, vlen rregulli i “*rastit në shqyrtim*”, bazuar në të cilin, parashtuesi kërkesa e të cilit ka rezultuar në kërkesën për kontroll incidental, përfiton nga shpallja jokushtetues e ligjit/dispozitës përkatëse, për aq sa është e mundur/aplikueshme/përshtatshme, në rrethanat e rastit konkret (shih, ndër të tjera, pjesën 3. Rregulli i rastit në shqyrtim, paragrafët 53-57, të CDL-AD (2018)012 Opinion *Amicus Curia* për Gjykatën Kushtetuese të Gjeorgjisë lidhur me Efektet e Vendimeve në Çështjet Civile dhe Administrative). Në parim, me hyrjen në fuqi të Aktgjykimit përkatës dhe/ose shfuqizimit të dispozitave përkatëse dhe zbatimit të të njëjtit nga autoritetet publike përmes plotësimit/ndryshimit të ligjit/dispozitës përkatëse, rastet para gjykatave të rregullta dhe të cilat nuk janë përfunduar me vendim të formës së prerë, përfitojnë nga dispozitat e plotësuara/ndryshuara ligjore.
238. Në fund, vlen të theksohet se përkitazi me mundësinë e efektit prapaveprues të një Aktgjykimi, përkundër përjashtimeve, shumica dërmuese e përgjigjeve të dorëzuara nga Gjykatat Kushtetuese anëtare të Komisionit të Venedikut, në harmoni edhe me Opinionet respektive të Komisionit të Venedikut, evitojnë të njëjtin. Në parim, anulimi i një ligji ose i dispozitave të tij individuale nga Gjykata Kushtetuese, nuk mund të përbëjë bazë për rihapjen e një rasti të përfunduar me vendim të formës së prerë. Një vendim i Gjykatës Kushtetuese lidhur me konstatimin e jokushtetutshmërisë të një ligji/dispozite, në parim, nuk do të zbatohet për rastet e zgjidhura me vendim të formës së prerë para datës së publikimit në Gazetën Zyrtare/shfuqizimit të dispozitave përkatëse, pasi gjatë gjithë periudhës së aplikueshmërisë së ligjit/dispozitës përkatëse, ky i fundit gëzon një prezumim të kushtetutshmërisë. Për pasojë, dhe në parim, efektet e Aktgjykimit përkatës të Gjykatës Kushtetuese, do të zbatohen për të gjitha rastet që janë në pritje në gjykata nga hyrja në fuqi e efekteve të Aktgjykimit përkatës sepse në këtë mënyrë respektohet prezumimi i kushtetutshmërisë së rregullit juridik për periudhën para publikimit të Aktgjykimit përkitazi me jokushtetutshmërinë e ligjit/dispozitës përkatëse.
239. Marrë parasysh dispozitat e Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Opinionet relevante të Komisionit të Venedikut, përgjigjet e Gjykatave Kushtetuese anëtare të Komisionit të Venedikut dhe praktikës së saj gjyqësore, Gjykata, në rrethanat e rastit konkret, vlerëson se me qëllim të balancimit të së drejtave individuale dhe parimit të sigurisë juridike, shfuqizimi i normave të vlerësuara si kundërkushtetuese sipas këtij Aktgjykimi të Gjykatës, bazuar në paragrafin 3 të nenit 116 të Kushtetutës, duhet përcaktuar më 15 korrik 2023,

duke i akorduar kështu kohën e nevojshme pushtetit ekzekutiv dhe legjislativ për të ndryshuar/plotësuar Ligjin e kontestuar në lidhje me Udhëzimin Administrativ të kontestuar në përputhje me Kushtetutën dhe Aktgjykimin e kësaj Gjykate. Më 15 korrik 2023, dispozitat e shpallura si jokushtetuese përmes këtij Aktgjykimi, konsiderohen të shfuqizuara.

240. Një qasje e tillë është në përputhje edhe me: (i) praktikën gjyqësore të vet Gjykatës në rastin e Gjykatës KO54/20, me parashtrues Presidenti Republikës së Kosovës, Aktgjykim i 31 marsit 2020; (ii) Opinionet relevante të Komisionit të Venedikut; dhe (iii) praktikën gjyqësore të një pjesë dërmuese të Gjykatave Kushtetuese anëtare të Forumit të Komisionit të Venedikut. Në rrethanat e rastit konkretet, dhe duke i balancuar të drejtat dhe liritë themelore individuale dhe parimin e sigurisë juridike, një qasje e tillë, përjashtimisht, është e domosdoshme për të: (i) evituar zbrazëtinë ligjore/juridike në Republikën e Kosovës përkthazi me të kategorinë e pensionit kontributpagues; (ii) për të mbrojtur të drejtat e të gjithë atyre individëve që në ndërkohë do të mund të përfitonin nga e drejta në pension kontributpagues dhe të drejtat e të cilëve potencialisht do të mund të cenoheshin nga shfuqizimi i menjëhershëm i dispozitave përkatëse të Ligjit në lidhje me Udhëzimin Administrativ të kontestuar; dhe (iii) për të mbrojtur të drejtat procedurale të palëve, përfshirë afatet e kërkesave dhe ankesave, siç janë të përcaktuar në Ligjin e kontestuar në lidhje me Udhëzimin e kontestuar Administrativ.
241. Brenda periudhës së akorduar nga Gjykata, institucionet relevante të Republikës së Kosovës, në radhë të parë Kuvendi dhe MPMS, duhet të ndërmarrin masat e duhura për t'u siguruar që dispozitat e përkatëse të Ligjit dhe Udhëzimit Administrativ të kontestuar t'i zëvendësojë me dispozita që janë në pajtim me këtë Aktgjykim dhe me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, në mënyrë që të kategorizojnë personat që mund të përfitojnë nga skema e pensionit kontributpagues për punën e kryer para vitit 1999, e të cilët ishin përjashtuar nga puna si rezultat i masave diskriminuese.
242. Për më tepër, në përputhje me Opinionet e lartpërmendura të Komisionit të Venedikut, Gjykata duhet të tregohet e kujdesshme ashtu që ky Aktgjykim të mos ketë efekt nga zanafilla (*ex tunc*), por vetëm në të ardhmen (*ex nunc*), në mënyrë që buxheti i shtetit të mos ngarkohet në mënyrë të paarsyeshme dhe të shmanget një situatë kundërkushtetuese më e madhe sesa ajo që është krijuar me Ligjin dhe Udhëzimin Administrativ të kontestuar. Prandaj, Gjykata thekson se ky Aktgjykim i Gjykatës do të ketë efekt vetëm në të ardhmen (*ex nunc*), si të vetmen mundësi për ta korrigjuar mospërputhjen me Kushtetutë të Ligjit dhe Udhëzimit Administrativ të kontestuar, duke marrë parasysh balancin në mes të drejtave individuale dhe parimit të sigurisë juridike.
243. Përfundimisht, Gjykata vlerëson se në rastin konkret siguria juridike mbrohet në mënyrë më efektive duke: (i) përcaktuar efektet e këtij Aktgjykimi pas një periudhe gjashtë (6) mujore, përkatësisht me 15 korrik 2023, në mënyrë që evitohet zbrazëtia juridike/ligjore dhe e cila mund të afektojë negativisht edhe qytetarë të cilët mund të përfitojnë nga dispozitat përkatëse të Ligjit të kontestuar në lidhje me Udhëzimin përkatës Administrativ; (ii) duke pasur parasysh implikimet legjislative dhe financiare të ndryshimeve që duhet të bëhen për zëvendësimin e dispozitave përkatëse të Ligjit dhe Udhëzimit Administrativ të kontestuar, Gjykata në pajtim me praktikën kushtetuese ndërkombëtare, i akordon ligjvënësit gjashtë (6) muaj brenda të cilëve dispozitat e konstatuara si jokushtetuese të Ligjit të kontestuar dhe Udhëzimit Administrativ të kontestuar, duhet t'i zëvendësojë me dispozita që janë në pajtim me këtë Aktgjykim dhe me Kushtetutën e Republikës së Kosovës; dhe (iii) që për shkaqe të sigurisë juridike, efekti kohor i këtij Aktgjykimi do të jetë vetëm në të ardhmen (*ex nunc*).


PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, në pajtim me nenet 113.8 dhe 116 të Kushtetutës, nenet 51 dhe 52 të Ligjit dhe në bazë të rregullave 66 (4), 77 dhe 59 (1) të Rregullores së punës, më 30 dhjetor 2022, njëzëri:

VENDOS

- I. TË DEKLAROJË kërkesën të pranueshme;
- II. TË KONSTATOJË se paragrafi 2 i nenit 8 të Ligjit nr.04/L-131 për Skemat Pensionale të Financuara nga Shteti në lidhje me nënparagrafin 2.3 të paragrafit 2 të nenit 6 të Udhëzimit Administrativ nr.09/2015 për Kategorizimin e Shfrytëzuesve të Pensionit Kontributpagues sipas Strukturës Kualifikuese dhe Kohëzgjatjes së Pagesës së Kontributeve-Stazhit Pensional, nuk janë në përputhshmëri me nenin 24 [Barazia para Ligjit] të Kushtetutës në lidhje me nenin 14 (Ndalimi i diskriminimit) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe nenin 1 (Ndalimi i Përgjithshëm i Diskriminimit) të Protokollit nr. 12 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut;
- III. TË KONSTATOJË në pajtim me paragrafin 3 të nenit 116 të Kushtetutës, paragrafin 5 të nenit 20 të Ligjit dhe paragrafin 5 të rregullit 60 të Rregullores së punës, se paragrafi 2 i nenit 8 të Ligjit nr.04/L-131 për Skemat Pensionale të Financuara nga Shteti në lidhje me nënparagrafin 2.3 të paragrafit 2 të nenit 6 të Udhëzimit Administrativ nr.09/2015 për Kategorizimin e Shfrytëzuesve të Pensionit Kontributpagues sipas Strukturës Kualifikuese dhe Kohëzgjatjes së Pagesës së Kontributeve-Stazhit Pensional, shfuqizohen më 15 korrik 2023;
- IV. TË URDHËROJË në pajtim me paragrafin 1 të nenit 116 të Kushtetutës, Kuvendin dhe Qeverinë e Republikës së Kosovës, që jo më larg se deri më 15 korrik 2023, të ndërmarrin veprimet e nevojshme për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr.04/L-131 për Skemat Pensionale të Financuara nga Shteti në pajtim me Kushtetutën dhe këtë Aktgjykim;
- V. TË KËRKOJË nga Kuvendi dhe Qeveria e Republikës së Kosovës, që në pajtim me paragrafin (5) të rregullit 66 të Rregullores së punës, të njoftojnë Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës në lidhje me masat e ndërmarra për zbatimin e këtij Aktgjykimi;
- VI. T'UA KUMTOJË këtë Aktgjykim palëve;
- VII. TË KONSTATOJË që Aktgjykimi hyn në fuqi në ditën e shpalljes në Gazetën Zyrtare, në pajtim me paragrafin 5 të nenit 20 të Ligjit.

Gjyqtari raportues



Nexhmi Rexhepi



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese



Gresa Caka-Nimani